



ALBANIAN UNIVERSITY
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË SË PËRGJITHSHME

TEMË PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

***PROTOTIPI PSIKODINAMIK I STILEVE TË LIDERSHIPIT PËRMES TABELËS SË
ORGANIZIMIT TË PERSONALITETIT, PERSPEKTIVA E RE E Q-sort.***

Punoi:

Silva IBRAHIMI

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Vera OSTRENI

TIRANË, 2020

KONSULENTË SHKENCORË:

Robert M.GORDON PhD, A.P.B.B.

Visar MALAJ PhD

Prof.Peter SCHMOLCK PhD

DEKLARATË STATUORE

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Silva Ibrahim.

2020

Prof. Dr. Vera Ostreni (udhëheqës i tezës)

DIZERTACIONI APROVOHET

Kryetari i komisionit

Anëtar komisioni

Anëtar komisioni

Anëtar komisioni

Oponent i tezës

Oponent i tezës

Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale

MIRËNJOHJE

Për realizimin e punimit “ *Prototipi Psikodinamik i Stileve të Lidershipit përmes tabelës së Organizmit të Personalitetit,perspektiva e re e Q-sort*” janë angazhuar dhe kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar shumë persona, kërkues shkencorë, kolegë, specialistë, mësues e drejtues bashkëudhëtarë të këtij kërkimi.

Mirënjohja ime e madhe i shkon udhëheqjes sime shkencore, doktoreshë Prof.Dr.Vera Ostreni për mbështetjen, inkurajimin dhe udhëheqjen e saj shkencore. Një kontribut po kaq i rëndësishëm dhe tërësor është ai i Profesor Robert M.Gordon, bashkëudhëheqës shkencor, bashkëautor i mjaft publikimeve shkencore të lidhura me këtë temë dhe një mbështetës po kaq i vyer në krijimin fillestar dhe formësimin e këtij studimi.

Falenderimet e mia të veçanta për Dr.Visar Malaj për mbështetjen shkencore statistikore dhe kontributin e tij në këtë kërkim. Gjithashtu mirënjohëse të gjithë pjesëmarrësve të këtij studimi,respondentëve, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të Shqipërisë, Drejtorive Arsimore dhe Drejtorive të Shkollave të të gjitha qyteteve pjesëmarrësve për angazhimin serioz, bashkëndarjet e opinionëve dhe mendimeve për arritjen e një standardi të lartë dhe incentivën që i atribuon këtij studimi.

Mirënjohje të përzemërt *Familjes dhe Nënës* sime, së cilës i kushtohet tërësisht kjo temë.

Përzemërsisht,

Silva

ABSTRAKT

Qëllimi: Studimi shkencor me temë “*Prototipi Psikodinamik i Stileve të Lidershipit përmes tabelës së Organizmit të Personalitetit, perspektiva e re e Q-sort*” ka për qëllim të eksplorojë situatën problemore të Organizimit të Personalitetit dhe Tendencës së Sjelljes për liderët e shkollës, të evidentojë nevojën e ndryshimit cilësor dhe organizimit të strukturave vlerësuese e parandaluese të shëndetit mendor në shkollë.

Metoda: Kërkimi është realizuar përmes gërshetimit të hulumtimeve të literaturës me operacionalizimin në kontekst. U shqyrtuan të dhëna të literaturës burimore nga më shumë se 250 artikuj shkencorë, monografi, tekste akademike dhe 8 instrumenta matës e mbështetës me një gamë shumëpërfshirëse në një linjë kohore nga vitet 1923 deri më 2019 në studime kërkimore vendase dhe të huaja. Janë shqyrtuar gjithashtu veprat dhe shkrimet e plota të modeleve kryesore si Zigmund Frojd, Ronald Fairbairn dhe Robert M. Gordon për këtë argument. Është synuar që përmes një metodologjie sasimore dhe cilësore si metodologjia Q, të jipet një formësim i të gjitha këtyre pikësnyimeve. Përzgjedhja e Q-sort si metodë psikodiagnostike është edhe një përgjigje ndaj nevojës për të përballuar vështërsitë e metodave shkencore në psikopatologjinë e deritashme. Pas përzgjedhjes dhe filtrimit të literaturës, u krijua një databazë e artikujve shkencorë, punimeve e monografive, kërkimeve, teorive, modeleve, teksteve akademike dhe zhvillimeve të reja shkencore në fokusin qendror të temës.

Procedurat: Operacionalizimi i metodës së studimit lidhet me administrimin sasior dhe cilësor të metodës Q. Metodologjia në vetvete është metodë e përzier dhe forma kryesore e matjes së saj është shkalla *Likert*, me pohime dikotomike që variojnë nga më karakteristikja (+5) në më pak karakteristikën (-5). Instrumenta të tjerë që mbështetën operacionalizimin e metodës të përdorur në këtë studim janë:

Tabela Diagnostike Psikodinamike (PDC), Pyetësi i Besimeve Patogjene Bërthamë, Pyetësi i Nivelit Funkcional Mendor(QFM-27), Inventari i Marrëdhënieve me Objektin (ORI) dhe Vlerësimi Funkcional i Egos (EFA).

Rezultatet: Nga tërësia e studimit rezultoi se ekziston jo vetëm një marrëdhënie e fortë pozitive mes Besimeve Patogjene dhe Organizimit të Personalitetit por, edhe se mësuesit e drejtuesit e shkollave në vendin tonë shfaqin simptoma në rritje të “*sjelljes me tendencë keqpërshtatëse*”. Të dhënat treguan se ekziston një marrëdhënie e fortë pozitive mes përgjigjeve të liderëve në qytetin e Shkodrës për pohimin nr.67 “me Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .883$ çka do të thotë se ekziston një lidhje e qendrueshme, e fortë dhe pozitive mes liderëve në qytetin e Shkodrës me ndikimin nga të tjerët. Të dhënat e korrelacioneve tregojnë një lidhje të fortë pozitive për Beratin (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .956$), lidhje mesatarisht pozitive për Korçën (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .496$) dhe të dobët për Tiranën (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .261$) në pohimin nr.17. Po kështu një pjesë e madhe e respondentëve të këtij studimi (56 %) reflektuan një mbivendosje të niveleve të organizimit të personalitetit Neurotik, Kufitar dhe të Shëndetshëm

Konkluzione: Si përfundim, mbështetur në të dhënat statistikore të korrelacioneve, analizës faktoriale dhe algoritmike të studimit, mund të propozojmë përdorimin e metodës Q-Sort si mundësi alternative në psikodiagnostikë.

Mund të rekomandohet kështu formësimi i një strukture me bazë vlerësuese e mbështetëse të problematikave psikologjike të liderëve në shkolla dhe ndryshimin zinxhir të rolit e funksionit të liderit në shkollë dhe stilit të lidërshiptit në funksion të mbështetjes të edukimit dhe shëndetit.

Fjalë kyçe: *Prototipi Psikodinamik, Tabela Psikodiagnostike, Metodologjia Q, Stil i Lidërshiptit, Sistem Edukimi.*

ABSTRACT

Purpose: The scientific study "Psychodynamic Prototype of Leadership Styles through the Table of Personality Organization, the new Q-sort project" aims to explore the problematic situation of Personality Organization and Behavioral Tendency for school leaders, to identify the need for qualitative change and the organization of assessment and prevention structures of mental health in school.

Method: The research was conducted by a combination of literature research with the implementation of the method in context. Data from the source literature were examined from more than 250 scientific articles, monographs, academic texts and 8 measuring and supporting instruments with a comprehensive range over a period of time from 1923 to 2019 in domestic and foreign research studies. The works and complete writings of leading figures such as Sigmund Freud, Ronald Fairbairn and Robert M. Gordon on this argument have also been examined. It is aimed that through a quantitative and qualitative methodology such as Q methodology, to give a complete shaping of all the above objectives. Q-sort selection as a psychodiagnostic method is also a response to the today's need to cope with the difficulties of scientific methods in current psychopathology. After selecting and filtering the literature, a database of scientific articles, works and monographs, research, theories, models, academic texts and new scientific developments in the central focus of the topic was developed.

Procedures: Operationalization of the study method is related to the quantitative and qualitative administration of the Q method. The methodology itself is a mixed method and the main mode of its measurement is the Likert scale, with dichotomous statements ranging from the most characteristic (+5) to the least characteristic (-5). Other instruments that supported the operationalization of the method used in this study are: Psychodynamic Diagnostic Table (PDC), Pathogenic Nuclear Belief Questionnaire, Functional Mental Level Questionnaire (QFM-27), Object Relationship Inventory (ORI) and Functional Ego Assessment (EFA).

Results: The study concluded that there is not only a strong positive relationship between Pathogenic Beliefs and Personality Organization but also that teachers and

school leaders in our country revealed increasing symptoms of "maladaptive behavior". The data showed that there is a strong positive relationship between the responses of leaders in the city of Shkodra to the statement no. 67 with Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .883$, which means that there is a stable, strong and positive correlation between the leaders and the influence of others in the city of Shkodra. The correlation data also show a strong positive correlation for Berat.(Sig2. $P = 0.01 < 0.05$, $r = .956$), moderately positive correlation for Korça (Sig2. $P = 0.01 < 0.05$, $r = .496$) and weak for Tirana (Sig2. $P = 0.01 < 0.05$, $r = .261$) in statement no.17. Also, a large part of the respondents of this study (56%) reflected an overlap of the levels of organization of Neurotic, Borderline and Healthy personality.

Conclusions: In conclusion, based on statistical data of correlations, factorial and algorithmic analysis of the study, we can propose the use of the Q-Sort method as an alternative option in psychodiagnostics. It may thus be advisable to formulate a structure based on the assessment and support of the psychological problems of school leaders and to change the chain of role and function of the school leader and leadership style in support of education and health.

Keywords: *Psychodynamic Prototype, Psychodiagnostic Chart, Q methodology, Leadership Style, Education System.*

TABELA E PËRMBAJTJES

ABSTRAKT.....	v
ABSTRACT.....	vii
HYRJE I	1
1. Parashtrimi i problemit	1
1.1. Qëllimi i studimit	4
1.2. Pyetjet kërkimore	5
1.3. Instrumentalizimi i metodës	7
1.4. Përcaktimi i termave	9
1.5. Kufizimet e kërkim studimit	10
1.6. Rëndësia dhe risia e studimit	11
1.7 Organizimi i Studimit.....	13
2) KREU II SHQYRTIMI I LITERATURËS	14
2. Teoria e marrëdhënieve me objektet sipas Zigmund Frojd.....	14
2.1. Teoria e Ronald Fairbairn për Marrëdhëniet me Objektin.....	28
2.2. Zhvillimi i Stileve të karakterit	54
2.3. Organizimi strukturor i personalitetit.....	55
2.4. Pikëpamjet historike,bashkëkohore dhe psikodinamike mbi stilet e lidërshpit të mësuesit dhe drejtuesit të institucioneve arsimore	68
2.4.1. Parashtrimi i stileve të lidërshpit shkollor	775
2.5. Klasifikimi i çrregullimeve mendore përmes pdm versioni për të rritur	86
2.5.1. Përcaktimi i strukturave të personalitetit dhe funksionimit mendor (Aksi P dhe M)....	95
2.5.2. Funksionimi Mendor-Aksi M.....	95
2.5.3. Struktura e simptomës dhe përvoja subjektive (Aksi S)	95
2.7. Sjellja keqpërshtatëse dhe tendenca bihejvorale	100
3) KREU III METODOLOGJIA	99
3.1. Aspektet historike të zhvillimit dhe standardizimit të metodologjisë Q.....	100
3.2. Krijimi dhe implementimi i konkursit	110
3.2.1 Instrumentat mbështetëse të metodës: tabela e organizimit të personalitetit(PDC)	113
3.3. Kampionimi dhe P-set.....	117
3.3.1 Çështje të Etikës.....	121
3.4. Zhvillimi dhe skicimi i kërkimit	122
3.4.1. Përcaktimi i variableve ortogonale	123
3.4.2. Faza e shpërndarjes dhe administrimit së Q-SORT	123
3.5. Implementimi i studimit.....	123
3.5.1. Përzgjedhja e shkollave	125
3.5.2. Organizimi i testit pilot (pre-testi)	125
4) KREU IV ANALIZA, REZULTATET DHE INTERPRETIMI I TË DHËNAVE.....	129
4.1. Përshkrimi i pjesëmarrësve	129
4.2. Analiza dhe rezultatet e fazës së parë dhe të dytë.....	130
4.3. Përgjigja ndaj analizës faktoriale	132
KREU V DISKUTIME DHE PËRMbledhje.....	168
KREU VI PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	183
6.1. Përmbledhje e studimit.....	183
6.2. Fushat dhe qasjet e ardhme për kërkime	189
BURIME BIBLIOGRAFIKE DHE WEBLOGRAFIKE	190
SHTOJCA	

LISTA E TABELAVE

Tabela 1.1 Tabelë përmbledhëse për indekset kryesore të vlerësuara në studim.	
Tabela 2.1 Shkalla e Nivelit Konceptual për Përshkrimet e Vetes dhe Përfaqësimet e Objektivit <i>Burimi: Blatt et al., 1988</i>	
Tabela 2.2: 12 Shkallët e Përmbajtjes Tematike për Përshkrimin e Tjetrit të Rëndësishëm	
Tabela 2.3 Plan trajtesë për zhvillimin e nivelit neurotik të egos.	
Tabela 2.4 Plan trajtesë për faktorët ndikues në zhvillimin e egos borderline.	
Tabela 2.5 Plan trajtesë për zhvillimin e nivelit psikotik të egos	
Tabela 2.6 Përcaktimi i niveleve të Organizimit të Personalitetit.....	
Tabela 2.7 Përmbledhje e stileve të lidershit sipas White dhe Goleman	
Tabela 2.8 Përmbledhje mbi Karakteristikat e Personalitetit, Sjelljet dhe Efektet e ndjekësit të liderit Karizmatik.....	
Tabela 2.9 Faktorët e Lidershit Transformues, Transaksional dhe Laissez-Faire.....	
Tab. 3.1 Përmbledhje e Korrelancave të Test-ritestit, Mesataret dhe Deviancat Standarde për 7 Elementët e Shkallës të Organizimit të Personalitetit të Përgjithshëm.....	
Tab. 3.2 Përmbledhje e Korelancave Test-Ritest, Mesataret, dhe Devimiet e Standardit për 9 Shkallët e Funkcionimit Mendor.....	
Tab.3.3 Tabelë përmbledhëse e shkollave pjesëmarrëse në studim sipas ndarjes zonale.....	
Tab.3.4. Të dhënat tabelare për Variablet e fazës paraprake të Q	
Tab.4.1. <i>Tabela e të dhënave demografike dhe P-set</i>	
Tab.4.2 Analiza e vlefshmërisë dhe Peshës së variableve ortogonale në Rrotacion Varimax për të dhënat totale të studimit.	
Tab.4.3. Tabelë përmbledhëse për shpërndarjen e pohimeve Q sipas elementëve përbërës për mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve arsimore.....	
Tab.4.4. <i>Tabelë përmbledhëse për shpërndarjen e pohimeve Q sipas elementëve përbërës për drejtuesit e institucioneve arsimore.</i>	
Tab. 4.5. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Tiranë	
Tab.4.6. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Elbasan	
Tab 4.7. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Berat	
Tab.4.8. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Shkodër.....	
Tab.4.9. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Korçë	
Tab. 4.10. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Vlorë.....	

LISTA E FIGURAVE

Figura 1.1 Faktorët kryesorë ndikues të lidershit në Edukim.	
Figura 2.1 Përshkrimi i Modelit Topografik sipas shkrimeve të hershme dhe të vonshme të Z.Frojd..	
Figura 2.2 Tipologjitë e trajtesës dhe trajtimit psikanalitik.	
Figura 2.3 Përshkrimi i Fairbairn mbi Teorinë e Personalitetit të Marrëdhënieve me Objektivin.	
Figura 2.4 Modeli i Fairbairn mbi Organizimin Psikik.	
Figura 2.5. Narcizimi fillestar sipas Fairbairn dhe Kernberg	
Figura 2.6 Përmbledhje e Sistemit Endopsikik të Fairbairn.	
Figura 2.7 Brendësimi i objektivit të mirë dhe të keq sipas Fairbairn dhe Kernberg (1976-1980)	
Figura 2.8 Skema e lidershit sipas Tannenbaum dhe Schmidt, 1958	
Figura 2.9 Skemë përmbledhëse e dimensioneve më të rëndësishme të lidershit efektiv Edukativ	
Fig 3.1. Grafiku i shpërndarjes së Q për fazën paraprake të studimit.....	
Fig.3.2. Grafiku i Rrotullimit Varimax në Q, për dy faktorët e parë sinjifikantë në pretest	

LISTA GRAFIKËVE

Grafiku 4-1. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Tiranë.....	
Grafiku 4-2. Grafiku i OP të Shëndetshëm Tiranë.....	
Grafiku 4-3. Grafiku i OP Neurotik Tiranë.....	
Grafiku 4-4. Grafiku i OP Borderline Tiranë.....	
Grafiku 4-5. Grafiku i OP Psikotik Tiranë.....	
Grafiku 4-6. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë”Tiranë	
Grafiku 4-7. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”Tiranë	
Grafiku 4-8. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit”Tiranë	
Grafiku 4-9. Shpërndarja Piramidale e Q-sortit për Qytetin e Tiranës	
Grafiku 4-10. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Elbasan	
Grafiku 4-11. Grafiku i OP të Shëndetshëm Elbasan	
Grafiku 4-12. Grafiku i OP Neurotik Elbasan	
Grafiku 4-13. Grafiku i OP Borderline Elbasan	
Grafiku 4-14. Grafiku i OP Psikotik Elbasan	
Grafiku 4-15. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë” Elbasan	
Grafiku 4-16. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”Elbasan	
Grafiku 4-17. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit” Elbasan	
Grafiku 4-18. Shpërndarja piramidale Q-sort për Qytetin e Elbasanit	
Grafiku 4-19. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Berat	
Grafiku 4-20. Grafiku i OP të Shëndetshëm Berat	
Grafiku 4-21. Grafiku i OP Neurotik Berat	
Grafiku 4-22. Grafiku i OP Borderline Berat	
Grafiku 4-23. Grafiku i OP Psikotik Berat	
Grafiku 4-24. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë”Berat	
Grafiku 4-25. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”Berat	
Grafiku 4-26. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit” Berat	
Grafiku 4-27. Shpërndarja piramidale Q-sort për qytetin e Beratit	
Grafiku 4-28. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Shkodër	
Grafiku 4-29. Grafiku i OP të Shëndetshëm Shkodër.....	
Grafiku 4-30. Grafiku i OP Neurotik Shkodër.....	
Grafiku 4-31. Grafiku i OP Borderline Shkodër.....	
Grafiku 4-32. Grafiku i OP Psikotik Shkodër.....	
Grafiku 4-33. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë” Shkodër	
Grafiku 4-34. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti” Shkodër	
Grafiku 4-35. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit” Shkodër	
Grafiku 4-36. Shpërndarja piramidale e Q-sort për Qytetin e Shkodrës.....	
Grafiku 4-37. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Korçë.....	
Grafiku 4-38. Grafiku i OP të Shëndetshëm Korçë	
Grafiku 4-39. Grafiku i OP Neurotik Korçë	
Grafiku 4-40. Grafiku i OP Borderline Korçë	
Grafiku 4-41. Grafiku i OP Psikotik Korçë	
Grafiku 4-42. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë” Korçë.....	
Grafiku 4-43. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”Korçë.....	
Grafiku 4-44. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit” Korçë.....	
Grafiku 4-45. Shpërndarja piramidale Q-sort për qytetin e Korçës.....	
Grafiku 4-46. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Vlorë.....	
Grafiku 4-47. Grafiku i OP të Shëndetshëm Vlorë.....	
Grafiku 4-48. Grafiku i OP Neurotik Vlorë.....	
Grafiku 4-49. Grafiku i OP Borderline Vlorë.....	
Grafiku 4-50. Grafiku i OP Psikotik Vlorë.....	

Grafiku 4-51. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë” Vlorë.....	
Grafiku 4-52. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti” Vlorë.....	
Grafiku 4-53. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit” Vlorë.....	
Grafiku 4-54. Shpërndarja piramidale Q-sort për qytetin e Vlorës.....	

Kjo faqe është lënë qëllimisht bosh!

HYRJE

1. Parashtrimi i problemit

Psikanaliza është ndoshta një nga metodat më të rëndësishme të hulumtimit, kuptimit dhe analizës së zhvillimit dhe funksioneve emocionale, të motivacionit dhe impulsit në psikologjisë njerëzore. Përpjekjet shkencore për të përcaktuar një personalitet normal dhe anormal nuk kanë mundur të formulojnë një dallim mes tendencës së një gjendjeje të sëmundjes të personalitetit dhe një sëmundjeje të qartë mendore.

Për realizimin e këtij studimi jemi mbështetur në një hulumtim të gjerë metanalitik mes të dhënave të literaturës klasike, zhvillimeve dhe drejtimeve më bashkëkohore të shkencës së psikodinamizmit dhe të dhënave empirike të marra nga nevoja kontekstuale për një rivlerësim të potencialit të liderit në pikëvështrimin e thelluar analitik për liderin shkollor.

Përqasja e psikanalizës me shkollën si nevojë e zgjidhjes së problemeve dhe konflikteve të vetes dhe të tjetrit është përcaktuar qysh herët në literaturë. Anna Frojd e përmend për herë të parë ndërvarësinë e marrëdhënies “Psikanalizë në shkollë” më shkrimin e saj “*Katër leksione mbi psikanalizën për prindërit dhe mësuesit*” (1930) e pas saj kjo ndërvatësi është shqyrtuar edhe nga Melanie Klein (1958) dhe Ronald W. Fairbairn(1958). Përmes të gjithë këtyre trajtesave mund të argumentojmë se për psikanalizën si prindi dhe mësuesi duhet të kenë dijeni mbi rëndësinë e dinamikave të marrëdhënieve afektive dhe emocionale të fëmijës, nxënësit dhe studentit. Forcat dinamike në situatat ku kërkohet një angazhim më i madh psikik janë më tepër të pavetëdijshme sesa të dijshme. Kështu psikanaliza është mjaft e dobishme për të ndihmuar prindërit, mësuesit dhe edukatorët të vendosin marrëdhënie prindërore, mësimore dhe shkollore sipas të njëjtit parim të *marrëdhënieve të mira objektuale* ose të ashtuquajturat “marrëdhënie mjaftueshmërisht të mira” të Winnicott(1953, fq.285).

Dobia e vlerësimit të një niveli të përshtatshëm të personalitetit (të shëndetshëm) të një lideri mësues a drejtues në institucionet e arsimore është padyshim një nga “kambanat që bien më fort” në kushtet e përshtatshmërisë së vazhdueshme tranzicionale të shoqërisë sonë.

Pasja e një sistemi edukues me nivele sa më të pakta të stresit dhe burnout¹ krijon përfitime të mëdha dhe të qëndrueshme shoqërore . Monitorimi i këtyre parametrave të sjelljes dhe personalitetit është natyrisht një burim i jashtëzakonshëm për depistimin klinik dhe parandalimin e situatave ku sjellja keqpërshtatëse si dhuna, përndjekja dhe abuzimi mund të kthehen në mbizotëruese dhe me pasoja shumë të vështira për të ardhmen.

Vjen në ndihmë në këtë kontekst mbështetja e dhënë nga një shumësi e literaturës psikodinamike mbi “Marrëdhënien me Objektin”, “Strukturën dhe Organizimin e Personalitetit” dhe “Prototipin e Personalitetit” të cilat do të trajtohen me detaje në vazhdimësinë e këtij punimi.

Autorët dhe studiuesit amerikanë të Shoqatës të Psikologjisë Amerikane (APA) kanë parashtruar fillimisht projektin e krijimit të një Prototipi² dhe Nivelit të Personalitetit pas publikimit të “Manualit Diagnostik Psikodinamik” (PDM) në vitin 2008 për sjelljen me tendencë keqpërshtatëse apo të çrregulluar. Si një manual diagnostikues i ri, PDM është një taksonomi që vë në qendër strukturën e personalitetit dhe aftësive të individit dhe jo një trajtim të thjeshtë të simptomave.

Pritshmëritë e larta dhe aplikimi i Akseve të këtij Manuali, i ndryshëm si nga qasja dhe struktura me manualet diagnostikues të njohura deri më sot (DSM, ICD, OPD), krijoi kushtet e përpunimit dhe publikimit të PDM-Versioni 2, botimi i së cilës është kryer në Qershor të vitit 2016 nga Ekipi i Task Force i APA³-s.

¹ Burnout, një çrregullim i stresit akut ose reagim ndaj stresit i karakterizuar nga lodhje e tejskajshme si rrjedhojë e mbingarkesës shoqërore me ankth, lodhje, pagjumësi dhe dëmtim në marrëdhëniet e punës (Colman, A. (2009). Fjalori i Psikologjisë së Oxfordit/Oxford Dictionary of Psychology, fq.123)

² Në mjedisin psikanalitik prototipi përfaqëson një strukturë a model të caktuar personaliteti i karakterizuar nga modele dhe nivele të caktuara sjellore, konjitive dhe emocionaliteti për secilin individ

³ Manuali i Prototipit Diagnostik Psikodinamik; manual i krijuar nga Lingiardi, Del Corno dhe McWilliams në Universitetin e “La Sapienza” (2013) që integron elementë diagnostikë të ICD-10, DSM-IV R dhe vlerëson subjektet fëmijë dhe të rritur. Për qëllime të këtij punimi janë përdorur të dhëna me lejen e plotë të autorëve referentë. Sipas krijimit të PDM, dr. R. Gordon et al. (2013-2014) krijuan Tabelën e Organizimit Psikodiagnostik të personalitetit dhe Prototipin të individit qëllimet e së cilave do të referohen përgjatë këtij punimi. Të gjitha të drejtat e rezervuara autorëve të këtij punimi.

Q-sort është metodologjia bazë e formulimit, administrimit dhe përpunimit e interpretimit të të dhënave në këtë studim. Ajo përfaqëson një metodë algoritmike që vendos elementin në një funksion dikotomik. Një instrument i rëndësishëm mbështetës mbi Akset e PDM është PDC⁴ për të cilin ky studim mbart një trajtesë të veçantë (Gordon et al.2013).

Studiues dhe klinikistë nga e gjithë bota kanë kontribuar në mbledhjen e të dhënave të mjaftueshme për vlefshmërinë e instrumentit dhe përshtypjet e tyre ishin mjaft të rëndësishme për krijimin e një databaze për versionin e ri të PDC-2.

Pjesë e këtij Ekipi ndërkombëtar është edhe Shqipëria, ku më 2013 ne u bëmë pjesëmarrës të kërimit studimit të prof. Gordon mbi vlefshmërinë e PDC dhe më pas përmes leksioneve interaktive të formatit e-learning bashkëndamë me studentët dhe studiues të tjerë risitë, rëndësinë dhe dobinë e përdorimit të këtij instrumenti në mjedisin klinik dhe fushat e tjera të psikologjisë.

Të dhënat sasiore të këtij studimi janë vjelë nga përdorimi i metodës Q, faza paraprake dhe testuese e të cilës krijoi besueshmërinë dhe vlefshmërinë e përdorimit të saj në kontekstin arsimor në Shqipëri.

Përdorimi i metodës Q-sort në tërësinë e këtij studimi ka synuar vëzhgimin dhe analizën e lidhjes së perceptimeve të individit për tendencat e sjelljes së personalitetit dhe ashpërsisë së simptomave sipas aksit P në PDM. Rezultatet paraprake të testimit, për të cilat do të shtjellojmë në vijim, na treguan se tendenca e të pyeturve ndaj vlerësimit të sjelljes është në konsensus të konkursit dhe kufirit të faktorit të parë për elementët e sjelljes së shëndetshme, neurotike, kufitar, psikotike dhe tendencës së sjelljes keqpërshtatëse.

⁴ Në punimin e tyre “Towards the validation of three assessment instrument derived from PDM Axis P: The Psychodiagnostic Diagnostic Prototype, The Core Preoccupations Questionnaire and The Pathogenic Beliefs Questionnaire” F. Gazillo, V. Lingardi dhe F. Del Corno në Universitetin “La Sapienza” të Romës më 2013 krijuan bazën tabelare të të dhënave të vlefshmërisë për PDC dhe PDM.

1.1. Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është të kryejë një eksplorim mbi situatën problemore të Organizimit të strukturës së Personalitetit dhe tendencës së sjelljes së Mësuesve dhe Drejtuesve të Institucioneve Arsimore përmes Stilit të tyre të Lidershipit si brenda mjedisit shkollor ashtu edhe në funksionalitetin e shkollës si njësi komunitare.

Për përmbushjen e këtij qëllimi, janë vendosur disa synime specifike si:

- 1) Të eksplorohej lidhja mes Organizimit të Personalitetit, Tendencës së sjelljes keqpërshtatëse dhe Nivelit të problematikave psikopatologjike për Liderët e institucioneve arsimore përmes këndvështrimit sasior dhe cilësor në Qytetet e Tiranës, Elbasanit, Shkodrës, Beratit, Vlorës e Korçës;
- 2) Të paraqitet një panoramë e këndvështrimit mbi Organizimin e Personalitetit dhe Prototipin e Personalitetit të mësuesve dhe drejtuesve në institucionet arsimore;
- 3) Të pasqyrohet përmes stileve të lidershipit marrëdhënia mes strukturave psikodinamike të zhvillimit dhe Nivelit të tendencës për sjellje keqpërshtatëse;
- 4) Të paraqitet një formë alternative e psikodiagnostikës dhe parandalimit përmes “Manualit Psikodinamik Diagnostikues (PDM)” dhe “Tabelës Psikodiagnostike (PDC)” për kontekstin e Shqipërisë;
- 5) Të qartësohen Akset e Strukturës dhe Funksioneve Mendore të Personalitetit të individit;
- 6) Të pasqyrohen ndikimet e mundshme, marrëdhëniet dhe korrelacionet mes strukturave të ndryshme të funksioneve mendore dhe behaviorale;
- 7) Të evidentohet dimensionin cilësor i përfaqësuesit të liderit individ me stilin e lidershipit edukacional që ofron;
- 8) Të ofrohet një formë alternative e depistimit dhe monitorimit të situatave psikopatogjene përmes teknikës Q;
- 9) Të parashtrahet nevoja e krijimit të një databaze kombëtare për nivelet e akumulimit mendor, sjelljes me tendencë keqpërshtatëse dhe lidershipit të mbartur nga liderët në institucionet arsimore.

1.2. Pyetjet kërkimore

Për realizimin e këtij studimi janë ngritur disa pyetje kërkimore të cilat synojnë të thellojnë kuptimin mbi ndërveprimin e elementëve psikologjikë dhe formës së stilit të lidërsipit në shkollë si :

1. Cili është orientimi i sjelljes dhe niveli i organizimit të personalitetit të Liderit Shkollor në Shqipëri?
2. Cili është ndikimi i faktorëve të përfshirë në Akset P, M, S të PDM-së dhe PDC-së në krijimin e pikvështrimeve dhe vetë-vlerësimin e liderëve shkollorë? (Faye, 1992)
3. Cila është dobë e përdorimit të metodës Q për vlerësimin e vetë perceptimit të liderit në institucionet arsimore?
4. Cili është niveli i relacionit mes Nivelit të OP dhe Fortësisë së Egos dhe Funksionalitetit Mendor të liderëve?
5. Cili është niveli i korrelacionit ndërmjet Besimeve Patogjeneve dhe Nivelit të Organizimit të Personalitetit të liderit në institucionet arsimore?
6. Cilët tregues të tjerë psikologjikë mund të ndikojnë perceptimin e Identitetit dhe Autenticitetit të liderëve shkollorë?
7. Në çfarë mënyre ndikojnë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm psikologjikë në perceptimin e Vetes, Identitetit dhe Tjetrit të Lideri Shkollor?
8. Cilat janë perceptimet e mësuesve dhe të drejtuesve të institucioneve arsimore mbi Stilin e tyre të Lidërsipit?

1.3. Instrumentalizimi i metodës

Testimi i vlefshmërisë së këtij instrumenti si në fazën paraprake ashtu edhe në testimin na ka lejuar të përcaktojmë këtë metodë si formë të standardizuar për këtë target-grup. Pas një hulumtimi në procesin e përgatitjes së këtij studimi, intervistat gjysmë të strukturuar për paraqitjen e objektivave, përfitimeve dhe thjeshtësisë së përdorimit të kësaj teknike me subjektet e fazës paraprake, vjeljes së të dhënave burimore, empirike e etnografike në mjedisin Shqiptar, ne krijuam një tabelë me faktorët ndikues të Lidërsipit në Edukim:




Figura 0.1 Faktorët kryesorë ndikues të lidershipit në Edukim.

Për secilin nga faktorët ndikues janë përcaktuar pohimet Q përfaqëuese dhe janë llogaritur indekset përshkruese e të rrotacionit të Q.

Në fillimin e këtij studimi kërkimor, në Mars të vitit 2014 u ndërtua një instrument vlerësues paraprak pilot me 50 pohime për Mësuesit dhe Drejtuesit e Institucioneve Arsimore.

Për të testuar vlefshmërinë, besueshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të instrumentit paraprak Q u përzgjodhën shkolla të Njesisë Administrative Elbasan dhe Tiranë. Subjektet u ritestuan përsëri pas gjashtë muajsh me testin paraprak. Koha e plotësimit të testit ishte mesatarisht 50 minuta ndërsa administrimi i tij u krye në kushtet e lejes dhe monitorimit nga strukturat shkollore, jashtë orarit zyrtar të mësimdhënies.

Sikundër argumenton Brown (1980) vlefshmëria e testit Q përlllogaritet në $\rho < 0.80$.

Në artikullin e tij mbi “Vlefshmërinë e Metodologjisë Q-Studim Rasti” (2011) Nicholas jep argumentimet sesi Metodologjia Q është efektive për kuptimin e plotë e të dhënave të grumbulluara. Argumentet e këtyre dy autorëve ishin pikënisje mbështetëse e metodologjisë së përdorur Q.

Në kapitullin e tretë pika 3.1, do të shqyrtohet një zhvillim historik dhe evolucion të Metodologjisë Q përmes kërkimit metanalitik të integruar. Të dhënat e para të grumbulluara u volën në Mars, ndërsa të dhënat e dyta u siguruan në Shtator të 2014 nga të cilat të dhënat e sinjifikancës alfa $\rho = .835$ na lejuan të përdornim instrumentin Q edhe në fazën pasardhëse të testimit. Pas plotësimit të pyetësorit vetë-raportues Q, subjekteve iu kërkua marrja e një përshtypjeje mbi teknikën.

Nga vëzhgimet në kontekst të respondentëve (subjekteve) u vërejt një angazhim dhe entuziazëm i tyre për vetë plotësimin e Q. Fjalitë e qarta, stili i kuptueshëm, shprehjet e komunikimit dhe pohimet që nxisin të menduarin kritik por, edhe identifikimin e subjekteve ishin disa nga pikat e forta të referuara për këtë instrument që në fazën e testimit paraparak. Ndër pikat e dobëta të këtij konstrukti paraparak u raportua shtimi i pohimeve për gjendjen psikologjike dhe vjelja e të dhënave në të njëjtin format për të dy pozicionet e liderit si për mësuesin edhe për drejtuesin e institucionit arsimor.

Vëzhgimi dhe mbajtja shënim e këtyre përshtypjeve ishin shumë të rëndësishme për konstruktin e testit përfundimtar të Q me 77 pohime të ndara për të dy kategoritë e liderit në shkollë (shtojca e parë dhe e dytë e këtij punimi). Pas aplikimit të plotë të metodës në Mars 2015 deri më Prill 2017 të dhënat e grumbulluara iu nënshtruan përpunimit fillestar me programin Pqm dhe më pas Analizës Përshkuese dhe Faktoriale të të dhënave me programin SPSS versioni 21. Indekset e vjela dhe të detajura në Kapitullin e katërt mund të përmbledhen në tabelën më poshtë (shih “Analiza e të dhënave për fazën e testit”).

Tabela 0.1 Tabelë përmbledhëse për indekset kryesore të vlerësuara në studim.

Indekset e Vlerësuara:

- 1. Të dhënat Deskriptive (Mesatare, Deviacion Standard, Variancë)
Të dhënat e Korrelacionit Pearson “r”**
- 2. Analizë Faktoriale;**
- 3. Matricë e Komponentëve dhe Matricë e Korrelacioneve Ndër -Pohimeve
Rotacion Varimax për variabellet ortogonale**

Metoda e përzgjedhur për tu aplikuar në kontekstin e Lidershipit në shkollë në Shqipëri është e thjeshtë, e kuptueshme, e strukturuar, e ndërtuar në përputhje me synimet e studimit dhe pa kosto.

1.4. Përcaktimi i termave

Manuali Psikodinamik Diagnostik (PDM) - Manual i diagnozës psikologjike krijuar nga pesë organizatat kryesore psikanalitike dhe kërkues shkencorë nën udhëheqjen e Stanley I. Greenëan, Nancy McWilliams dhe Robert Wallerstein më 2006. Ky sistem klasifikues psikodinamik trajton individin në të gjithë pikëvështrimet psikologjike e klinike që nga strukturat e thella të personalitetit deri në integrimin bihejvioral, emocional, konjitiv dhe psikosocial të simptomave (Gordon, R.M. 2009, *The Corsini Encyclopedia of Psychology dhe "Psychodynamic Diagnostic Manual"*).

Tabela Psikodiagnostike (PDC) -Instrument kërkimor dhe metodë e vlerësimit psikodiagnostik i krijuar për vjeljen e të dhënave cilësore mbi akset e Manualit Psikodinamik Diagnostik (PDM).

Nivel i Organizimit të Personalitetit- Shkallëzimi i nivelit sipas të cilit pasqyrohet Organizimi Psikodinamik i Personalitetit dhe tendenca për Normalitet a Patologji te individët.

Prototip-Krijimi i një strukture me funksionalitet unik te secili individ në të cilin vendoset Niveli i Organizimit të Personalitetit.

Prototipi Diagnostik Psikodinamik (PDP) -Kategori të Prototipit dhe Nivelit të Organizimit të Personalitetit të krijuara nga studiuesit e Universitetit "La Sapienza"si instrumente mbështetëse e PDM-së. Këto kategori të nivelit të organizimit synojnë të krijojnë personalitete-tip (prototipe)në varësi të analizës së strukturës psikodinamike të individit në studim.

Lidership -udhëheqja e individëve brenda konteksteve të organizuara, strukturimi dhe dimensionimi i marrëdhënieve ndërmjet subjekteve që ndërveprojnë për arritjen e rezultateve të kërkuara (Mujis dhe Harris, 2002). Në mjediset shkollore, roli i liderit përfshin si drejtuesit dhe mësuesit, të cilët edhe pse me detyra të ndryshme, i përgjigjen qëllimeve të përbashkët, menaxhimit dhe rritjes së efikasitetit në shkollë (MacBeath dhe Dempster, 2009).

Metodologjia Q - metodë e kërkimit shkencor algoritmik e përzier, sasiore dhe cilësore që i lejon pjesmarrëseve të shprehen për veten përmes shkallës matëse Likert(Stephenson,1953). Ndryshe nga instrumentat e tjera matëse vetë-raportuese ku

vlefshmëria dhe besueshmëria e të dhënave mund të jetë e paplotë për shkak të vështërsisë së matjes objektive të përgjigjeve subjektive, metoda Q grumbullon pikëpamjet dhe vetë-vlerësimin e subjekteve përmes matjeve specifike matematikore të mbledhura në një hapësirë kohore për të paktën 6-muaj dhe i analizon ato në programe algoritmike të krijuara posaçërisht për të.

Pikvështrimet dhe Pikpamjet -mendimet, opinionet, pikëpamjet personale, kuptimi dhe njohja e elementëve ndikues në sjelljen dhe marrëdhënien me të tjerët. Element i rëndësishëm i metodës Q me të cilat analizohen korrelacionet ndërmjet subjekteve dhe pohimeve (ndryshorëve)të tyre.

Pohimet Q -fjali a pohime të vjela nga bashkësia (konkursi) P-set për studimin.

Konkurs i Q-set – terminologjia teknike e përdorur në metodën Q për krijimin e pohimeve Q gjatë ndërtimit të instrumentit përmes shqyrtimit të literaturës,intervistave a burimeve të tjera të mbledhjes së të dhënave. Konkursi është një seri e lidhur pohimesh me fokus te kuptimi dhe jo te faktet e thjeshta (Broën,1993,2004).

Kushtet e udhëzimit -procesi i udhëzimit të pjesëmarrësve për pohimet Q që përfshijnë një shkallë dikotomike të vlerësimit. Këto forma udhëzuese komunikohen me pjesëmarrësit para administrimit të testit Q si pjesë e Miratimit të Informuar.

Faktor i analizës Q -formë e analizës së rregullt faktoriale sipas Stephenson (1953) ku të gjitha pohimet Q vendosen në korrelancë me njëra-tjetrën. Variablet e vjela faktoriale i nënshtrohen më pas një procesi statistikor të rrotullimit faktorial Varimax sipas të cilit faktorët me peshën më të lartë specifike qendrojnë më lart në pikavarazhet z (z -scores).

1.5. Kufizimet e kërkim studimit

1. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim nuk përfaqësojnë të gjithë mësuesit dhe drejtuesit arsimorë të Republikës së Shqipërisë. Përzgjedhja e shkollave është kryer sipas të dhënave të IZHA për shpërndarjen e popullatës dhe të shkollave në njësi të ndryshme administrative të territorit shqiptar por,gjithsesi, nuk përfshinë zona të

tjera të qytezave a fshatrave që mund të kishin dhënë dallime të tjera.

2. Puna me parametrat e metodës psikometrike Q kërkon një disiplinë specifike të vlerësimit dhe ndjekjes të ëecializuar.

3. Përzgjedhja e kampionit nuk është rastësore por e zgjedhur sipas kritereve të kërkuara nga vetë metoda. Si instrument vetë-vlerësues, hulumtuesit mund të shfaqin një tendencë për të dhënë gjykime a argument të qendërzuar në vlerat e tyre personale.

4. Përpunimi i të dhënave grafike në programin Pqm është kryer në gjuhën Angleze pasi nuk ekziston një përditësim i tij në gjuhën Shqipe. Interpretimet përshkruese dhe analizat grafike janë shoqëruar me ekuivalentët e tyre në gjuhën Shqipe.

4. Është shumë e rëndësishme të vëmë në pah nevojën e studimeve të tjera mbështetëse për implementimin e metodës në shkencat sociale dhe të aplikuara por edhe në fusha më të gjera të kërkimit (van Exel, 2005).

1.6. Rëndësia dhe risia e studimit

Rëndësia e shkollës si institucion mësimdhënës dhe komunitar ka rritur cilësisht nevojën për një ridimensionin të rolit të saj për shoqërinë. Zhvillimet kontekstuale nga ana e tyre kanë rritur nevojën për hulumtimin më të gjerë të strukturave, roleve dhe funksioneve që ndodhin te liderët në shkollë dhe impaktin e tyre në të gjithë komunitetin. Kuptimi i pikpamjeve dhe pikvështrimeve të liderërve të shkollës për rolin dhe rëndësinë e tyre në komunitetin brenda shkollës dhe jashtë saj mbart një motivim edhe për hulumtimin e thelluar psikanalitik të Marrëdhënies së liderit me veten dhe tjetrin e Rëndësishëm por edhe të Organizimit dhe Nivelit të Personalitetit të tyre. Përpjekje të rëndësishme janë kryer edhe në kontekstin shqiptar për lidhjen e psikanalizës me shkollën, gjetjet e të cilave kanë incentivuar padyshim edhe në këtë studim (Hoxha, 2009).

Rëndësia e këtij studimi është shumëplanëshe qoftë në aëektet teorike qoftë në aëektet praktike.

Së pari, është synuar dhe arritur ndërgjegjësimi i pjesmarrësve përmes testimeve dhe intervistave në këtë kërkim mbi nevojën e hulumtimeve psikologjike për

kuptimin e tendencës së sjelljes dhe të rrezikut për psikopatologji në liderët arsimor. Ky hulumtim ndihmon edhe në krijimin e një tabloje të plotë vlerësuese për strukturat politikbërëse dhe shoqërore.

Së dyti, shqyrtimi i literaturës në këtë studim ofron një ndërthurje ndërmjet pikpamjeve të psikanalizës klasike dhe studimeve më të reja të zhvilluara dhe implementuara në SHBA dhe vendet perëndimore. Mund të cilësojmë në këtë moment rëndësinë e bashkëveprimit të Shqipërisë përmes ekipit multidisiplinar të këtij kërkimi në vendet e tjera pararojë.

Së treti, ofrohet një mundësi alternative për kontekstin Shqiptar të vjeljes dhe përpunimit psikometrik përmes Metodologjisë Q në disiplinën e Psikologjisë Klinike dhe disiplinave të përngjashme me të.

Së katërti, risia që ky studim përcjell lidhet jo vetëm me tërësinë shkencore të aplikuar por, edhe me gjetjet e vlerësuara në qytetet me shpërndarjen më të lartë të shkollave e popullatës. Cilësojmë këtu përfituesit e këtij studimi që përfshijnë mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve arsimore, nxënësit e studentët, prindërit dhe komunitetin por edhe të sistemit politikbërës e shoqërisë në tërësi.

1.7 Organizimi i Studimit

Organizimi i këtij punimi është strukturuar nga gjashtë kapituj:

Në kapitullin e I-rë Hyrje ofrohet një panoramë e përgjithshme e studimit dhe trajtohen specifikisht disa argumente si: Përcaktimi i koncepteve bazë, qëllimi i studimit, pyetjet kërkimore, instrumentalizimi i metodës Q, kufizimet e kërkim-studimit dhe rëndësia e risia e studimit. Për arritjen e qëllimit të këtij kërkimi u krye një punë voluminoze studimore si në spektrin e shqyrtimit në literaturë, empirik dhe situacional ashtu edhe në përcaktimin e ndryshorëve që do të jenë objekt i analizës.

Kapitulli i II-të lidhet me shqyrtimin e literaturës. Këtu janë trajtuar pikvështrime të ndryshme të literaturës së shkruar dhe kërkimeve shkencore e studimeve të lidhura me studimin. Veçanërisht vëmendje në trajtim i është kushtuar :

1. *Teorisë së Marrëdhënieve me Objektet e Sigmund Frojd*; 2. *Teorisë së Marrëdhënieve me objektet e Ronald W. Fairbairn*; 3. *Zhvillimit të Stilit të karakterit*;

4. *Organizimit strukturor të niveleve të personalitetit dhe pikëpamjeve historike, bashkëkohore e psikodinamike mbi stilet e lidërshpit në institucionet arsimore.* Në këtë kapitull shqyrtohen edhe dy nën çështje të rëndësishme të studimit si: a) parashtrimi i stileve të lidërshpit shkollor, b) klasifikimi i problematikave mendore përmes PDM-së, versioni për të rritur.

Kapitulli i III-të përshkruan metodologjinë e kërkimit. Këtu përfshihet një trajtim i plotë i metodës së përzier të përdorur për qëllimet e këtij studimi, krijimi dhe implementimi i konkursit, Instrumentat mbështetëse të metodës (Tabela psikodiagnostike e Organizimit të Personalitetit (PDC), Pyetësi i besimeve patogjene (QPC), Pyetësi i nivelit të funksionimit mendor (QFM-27), Inventari i marrëdhënieve me objektin (ORI) dhe Vlerësimi Funkcional i Egos (EFA), Kampioni dhe P-set, Zhvillimi dhe skicimi i kërkimit me dy nënçështje: a) përcaktimi i variabëlve ortogonale dhe b) faza e shpërndarjes dhe administrimit të Q-sort. Në përfundim të kapitullit të metodologjisë shqyrtohet procesi i *implementimit të studimit* përmes tre nën çështjeve kryesore: a) përzgjedhja e shkollave, b) organizimi i testit paraprak dhe c) procedurat e administrimit dhe aplikimit të testit Q.

Vlerësimi dhe testimi i plotë i Q-sort u krye për një kampion prej 200 subjektesh nga të cilët 175 mësues dhe 25 drejtues. Përzgjedhja e shkollave në studim u krye sipas të dhënave të MAS, IZHA dhe INSTAT mbi shtrirjen demografike dhe të popullatës. Kjo ndarje u kategorizua në gjashtë njësi administrative kryesore: 1) Tirana, 2) Elbasani, 3) Berati; 4) Shkodra 5) Korça dhe Vlora nga të cilat u grumbulluan të dhëna për statistikat e korrelacionet Pearson, peshimin faktorial dhe analizën faktoriale.

Kapitulli i IV-të: *Analiza ,Rezultatet dhe Interpretimi i të dhënave.* Ky kapitull trajton në mënyrë të detajuar të dhënat sasiore të përpunuara nga programi kompjuterik dhe të dhënat cilësore në analizë psikanalitike. Këtu paraqiten gjithashtu shqyrtimet e analizës së korrelacioneve dhe analizës faktoriale për të gjitha subjektet pjesëmarrësve në secilin qark :Tiranë, Elbasan, Berat, Shkodër, Korçë dhe Vlorë. Janë argumentuar në mënyrë të detajuar analizat përshkruese, korrelacionet, vendosjen në pikavarazhe z, të dhënat e vlefshmërisë për instrumentat

mbështetëse dhe trajtimi me shpërndarjen piramidale Q. **Kapitulli i V-të** i dedikohet *Diskutimeve dhe Përmbledhjes* mbi panoramën e arritur. Janë evidentuar të dhëna mbështetëse mbi dobinë e përdorimit të metodës-Q dhe avantazhet që ajo sjell si formë alternative e vlerësimit psikodiagnostik.

Kapitulli i VI-të paraqet disa Rekomandime dhe sugjerime për strukturat arsimore, qeveritare dhe politikbërëse. Parashtrihen gjithashtu në këtë kapitull edhe disa sugjerime në lidhje me fushat dhe interesat e ardhshme të kërkimit në këtë fushë të klinikës.

Vijohet më pas me listën e Burimeve Bibliografike dhe Weblografike si dhe Shtojcat e atashuara këtij punimi.

KREU II

SHQYRTIMI I LITERATURËS

2. Teoria e marrëdhënieve me objektet sipas Zigmund Frojd

Në qendër të konceptit të Frojd për organizimin e psikes është ekzistenca e një parimi energjik, thelbësor, idi, në të cilin kërkohet shkarkimi i menjëhershëm për kënaqësinë e brendshme dhe evoluimin e një egoje të mirë strukturuar. Kjo ego në mënyrë të përshtatshme është zhvilluar si rrjedhojë e kontaktit mes energjisë së psikes së Idit dhe realiteteve të botës së jashtme (Frojd, 1900, 1923, 1933). Në këtë mënyrë, Frojd bëri një ndarje mes strukturës për arritjen e shprehjes së vetes nga ajo energji brenda vetes që përpiqet të shprehet. Në teorinë klasike të Frojd argumentohet se të gjitha proceset mendore janë të shpjegueshme sipas parimit të forcave të fuqishme psikike ndërvepruese në mënyrë dinamike përtej kontrollit të individit. Vetë egoja sillet në këtë dinamizëm dhe ndërvepron me forcat psikike pa i kontrolluar ato. Në teorinë klasike psikanalitike të gjitha proceset janë të përcaktuara nga forcat psikike me drejtim vektorial dhe fortësi të ndryshme. Ato mund të ndërveprojnë, eliminojnë ose përforcojnë njëra-tjetrën. Nga ky ndërveprim rrjedh sjellja dhe individi shihet si i motivuar në mënyrë të pavetëdijshme për kërkimin e kënaqësisë përmes sjelljes së shfaqur ose të pashfaqur (Frojd, 1926).

Në shkrimet e hershme Frojd parashtroi se motivi i parë i pavetëdijshëm i individit është t'i rezistojë terapisë dhe të marrë më shumë kënaqësi nga simptomat e tij. Individi nuk mund të vërë në jetë plane të pavetëdijshme. Ai vetëm mund të marrë kënaqësi nga simptomat. E pavetëdijshmja është një gjendje fluide ndërsa dëshirat, qëllimet, planet dhe besimet e pavetëdijshme të individit për të zgjidhur problemet lidhen me rezistencën ndaj procesit terapeutik.

Mendja e pavetëdijshme është e thjeshtë në tre elemente:

a) në përmbajtje;

- b) në kriteret e rregullimit;
- c) mënyrën e rregullimit.

Përmbajtja përfshin impulsset që kërkojnë kënaqësitë fëmijërore dhe mbrojtjet (forcat e represionit) që i mbajnë këto impulse të pavetëdijshme dhe të lidhura me njëra-tjetrën. Impulset ndërveprojnë në mënyrë dinamike me njëra-tjetrën ndërsa mekanizmat mbrojtës si represioni qëndrojnë për të mbrojtur kënaqësitë fëmijërore që këto impulse i mbartin padijshmërisht.

Mendja e pavetëdijshme rregullohet në mënyrë automatike nga parimi i kënaqësisë dhe dhimbjes përtej kontrollit të Egos dhe jashtë kornizës së mendimit, besimit dhe realitetit .

Në shkrimet e vonshme të Frojdit mendja shihet si një strukturë më komplekse; ajo përfshin përmbajtje të tjera të rregullimit automatik të pavetëdijshëm. Mendja përmban motive të prejardhura nga pjesët e pavetëdijshme të Egos, derivate të identifikimit me prindërit dhe dëshirave për t'i përmbushur ato. Ajo përmban disa qëllime afatgjata dhe dëshira të pavetëdijshme për kontroll dhe zotërim. Mendja e pavetëdijshme përmban gjithashtu motive nga Superego; dëshirën për të vuajtur ose për të qenë sëmure, motive këto vetë ndëshkuese, për të sakrifikuar apo të rregulluar një objekt të caktuar. Në këtë rezervuar të madh përfshihen motive dhe besime të pavetëdijshme që vijnë nga traumat e fëmijërisë, *kastrimi si ndëshkim* dhe nga frikërat, ankthet dhe ndjesitë e fajit që vijnë prej tyre. Shtypja (represioni) drejtohet jo vetëm ndaj kënaqësive fëmijërore por edhe ndaj motiveve të ndryshme të përshkruara, besimeve të pavetëdijshme dhe përvojave traumtaike të fëmijërisë. Pjesë të mendjes së pavetëdijshme veçanërisht *ego –represioni* mund të rregullohen nga vlerësimet e rrezikut dhe sigurisë. Ky rregullim nuk është automatik por realizohet nga përdorimi i funksioneve të larta mendore (mendimet, parandjenjat dhe gjykimet).

Në teorinë e vonshme të Frojdit disa besime të pavetëdijshme sikundër besimet e kastrimit si formë e ndëshkimit për seksualitetin luajnë një rol kryesor në jetën mendore të pavetëdijshme.

Besimet e pavetëdijshme kthehen në fantazi dëshiruese ndërsa ndërveprimi i impulseve dhe mekanizmave mbrojtës nuk janë më vendimtarë për sjelljen.

Në teorinë e mëvonshme besimi i kastrimit si ndëshkim është ai që përcakton sjelljen. Shfaqen këtu gjithashtu edhe ndjenjat e fuqishme të frikës, ankthit ose fajit.

Përvojat nga të cilat një fëmijë merr besimet e pavetëdijshme janë traumatike. Këto përvoja mund të jenë objektivisht jo të rëndësishme (si rasti i Hansit të vogël) por subjektivisht traumatizuese. Në teorinë e mëvonshme të Frojdit, psikopatologjia është rrjedhojë e besimeve të pavetëdijshme ndaj përvojave traumatike të fëmijërisë. Kështu, fëmija mund të represojë impulset seksuale dhe më pas t'i fiksojë ato.

Në artikullin e tij “*Mbi Afazinë*”(1891-1893) Frojdi ka argumentuar se përfaqësimi i objekteve *Objektvorstellu*, ekziston në mënyrë racionale mbi një sërë perceptimesh dhe qendrojnë në botën reale. Një vit më vonë, te “*Studime mbi Histerinë*” (Breuer dhe Freud, 1892-1895) Frojdi na shtjellon reflektimet e tij mbi transferencën si një “marrëdhënie e pavërtetë” mes dikujt që ka qenë objekt i dëshirave të hershme të individit dhe vetë individit. Në këtë marrëdhënie mes të shkuarës dhe të tashmes, objekti i dëshirave të hershme është brendësuar. Nëse në teorinë e hershme fiksimi varet nga përvoja⁵, në teorinë e vonshme pasi fiksohet, automatikisht ai represohet dhe udhëhiqet nga parimi i kënaqësisë.

Më konkretisht Frojdi shkruan : “*Momenti traumatik i tashëm pra, është ai në të cilin forcat e papajtueshme mbi egon dhe ndaj të cilës këto të fundit vendosin mbi hedhjen tej të kësaj ideje të papajtueshme. Ideja nuk zvetënohet nga përçmimi i kësaj forme, por thjesht është represuar në të pavetëdijshmen. Kur ky proces ndodh për herë të parë, vjen në pah një bërthamë dhe qendër kristalizuese ose formohet një grup psikik i ndarë nga egoja-një grup rreth të cilit do të përshihej pranimi i idesë së papajtueshme që rrjedhin prej saj. Ndarja e ndërgjegjes në këto raste e histerisë së fituar është e qëllimshme dhe me synime të qarta...*”⁶

Në teorinë e tij të hershme Frojdi arsyeton se simptomat janë shprehje të shëmtuara të impulseve të pavetëdijshme që kërkojnë kënaqësi. Ndërsa më vonë ai shtoi se simptomat e personit mund të shprehin përpjekjet e tij për të shkëputur veten nga një situatë e rrezikshme ose ndaj përjetimeve të ankthit. Në teorinë e hershme të

⁵ Një impuls bëhet i fiksuar ndaj një objekti të caktuar pasi gjen te ky i fundit ose kënaqësinë maksimale ose nuk është i kënaqur mjaftueshëm.

⁶ Sigmund Freud , “*Studime mbi Histerinë*” Rasti 3, fq. 222

Frojditi individi nuk ka ndonjë dëshirë të pavetëdijshme për të kaluar simptomat e tij por i mban ato nga efekti i kënaqësisë që provon. Individi mund të përsërisë përvojat traumatike për t'i kontrolluar ato. Ndërsa në analizën e mëvonshme ideja që individi do të donte të kontrollonte problemet e tij rrjedh nga prania e besimeve të pavetëdijshme traumatike.

Nëse simptomat e një personi në mënyrë të pavetëdijshme janë për të marrë kënaqësi individi, në të njëjtin cikël të pavetëdijes, mund të përpiqet t'i tejkalojë ato duke ndryshuar besimet patogjene. Pacienti, për shembull, mund të përdorë transferencën për të testuar analistin në rastin e një marrëdhënie psikoterapeutike ose individi mund të kërkojë të testojë përmbushjen e qëllimeve të veta të pavetëdijshme te një tjetër i rëndësishëm për të përmes identifikimit projektiv.

Në të dyja rastet individi do të provojë se klinikisti ose tjetri i rëndësishëm nuk do ta refuzojnë dhe kundërshtojnë atë sikundër prindërit në të shkuarën.

Pas kalimit “*me sukses*” të këtij testi, krijohet dinamika e nevojshme për thellimin e ekëlorimit të brendshëm.

Në shkrimet e hershme po kështu, sjellja keqpërshtatëse shihet si faktor shumë i rëndësishëm që ndikon mbi stilin e karakterit të individit. Frojdi ka argumentuar se ajo mund të përcaktohet edhe si derivat i impulseve fëmijërore të përshtatura pavetëdijshmërisht që kërkojnë marrjen e kënaqësisë pa marrë parasysh realitetin.

Në teorinë e vonshme sjellja keqpërshtatëse shkaktohet nga impulse të fuqishme të pavetëdijshme si dhe nga disa *besime patogjene të pavetëdijshme* e ndjesi të frikës, ankthit, fajit e kërimit të vazhdueshëm për kënaqësi. Në teorinë e vonshme sjellja mendohet të shërbejë si ego ose superego për një qëllim të caktuar. Energjia psikike⁷ në Id është e panjohur dhe egoja është rezervuar i madh i libidos ku sjellje të ndryshme (impulse) që organizohen nga egoja rregullohen nga mendimi.

⁷ Termi i përdorur në këtë studim do të jetë *Libido*. Paravendosja e këtij përdorimi teknik psikanalitik lidhet me një sërë ndryshorësh dinamike e psikike që ruajnë balancat e forcave energjitike dhe kuptimore.




Figura 0.1 Përshkrimi i Modelit Topografik sipas shkimeve të hershme dhe të vonshme të Z.Frojd

Te “*Hyrje në Psikanalizë*”(1932-1940) Frojdi i trajton përmbajtjet mendore të represuara si të rregulluara nga dëshirat e dhimbjes dhe kënaqësisë. Ky rregullim është automatik. Më vonë këto përmbajtje mund të rregullohen nga vlerësimet e rrezikut dhe sigurisë sipas mendimeve, parandjenjave, gjykimeve dhe vendimmarrjeve të individit. Sipas teorisë së Frojdit individi ushtron kontroll në mënyrë të pavetëdijshme në represionet e veta përmes kriterit të rrezikut dhe sigurisë.

Ai vë në jetë veprime provë për të testuar mjedisin dhe në rrjedhojë të provave zhvillon një plan apo veprim të pavetëdijshëm me pritshmërinë se analisti dhe të tjerët nuk do të reagojnë sikundër parashikohet nga besimet e tij patogjene. Në këtë formë individi do të ndërmarrë një hap përpara dhe do të lejojë veten të përjetojë këto përmbajtje dhe të veprojë sipas tyre.

Më tej Frojdi shkruan se: “*në rregullimin e përmbajtjeve të veta mendore të pavetëdijshme personi fokusohet në siguri dhe rrezik. Kur në mënyrë të pavetëdijshme personi vendos që ai mund të kryejë një veprim, të mendojë, të vlerësojë realitetin dhe të zhvillojë besimet e përvojave të shkuara në mënyrë të sigurt, ai është i lirë nga represionet dhe njëkohësisht fiton zotësi në të vetëdijshmen e vet*” (1940).

Neuroza sipas Frojdit nuk shfaq shkaqe specifike por lidhet me efektet traumatike të fëmijërisë së hershme dhe edukimit të një egoje që është ende e pamaturuar në dy fazat e seksualitetit njerëzor dhe impulseve pjesërisht të represuara. Objekti i parë është nëna, “joshja e parë” ose prototipi i të gjitha marrëdhënieve të mëtejshme të dashurisë dhe përkujdesjes. Ky objekt do të shndërrohet më pas në të “gjitha objektet e Tjetrit të Rëndësishëm” të cilat do të mbartin me vete po të njëjtën energji si objekti fillestar.

Ndryshe nga idi që i përgjigjet kënaqësisë, egoja mban kontaktet me botën reale dhe kupton parimin e realitetit e të vetëmbrojtjes duke prodhuar *ankth*.

Individi me një ego të pamaturuar represon dëshirat e veta dhe kompleksin e Edipit nga frika se do të humbë dashurinë e prindërve (objektet e sigurisë si Tjetri i rëndësishëm).

Me kohën kjo frikë e hershme fëmijërore transformohet në disa veçori të personalitetit të njeriut që mund të krijojnë *laguna* të nivelit Neurotik ose Kufitar (Borderline) si frika nga vetmia, dëshira për vëmendje dhe kënaqësi etj. Edhe në psikozë një pjesë e aparatit psikik mund të mbajë të paprekur marrëdhënien me realitetin dhe të pasqyrohet vetëm me një “çarje të egos”. Kjo çarje e lindur nga mohimi mund të shihet me rritjen e individit teksa duhet të përballet me realitetin.

Individët mund të përjetojnë mërzitje të represuar me intensitet pasi ndihen më pak të rrezikuar dhe vendosin ta përjetojnë atë lirshëm duke zhbërë mekanizmat mbrojtëse. Në teorinë e hershme një përmbajtje mendore e represuar që nuk interpretohet në mënyrë të natyrshme mbetet e pavetëdijshme derisa të forcohet. Një përmbajtje e forcuar shtyhet fuqimisht drejt vetëdijes dhe nxjerr në sipërfaqe përpjekjet e mbartura të mekanizmave mbrojtëse për ta transformuar apo përforcuar atë. Nëse përmbajtja e represuar është shumë e fuqishme, ajo mund të vijë në vetëdije në një formë të paqartë dhe individ do të hyjë në konflikt, do të ndjejë ankth dhe do mundohet të represojë këtë dinamizëm psikik⁸.

Nëse përmbajtja e represuar bëhet e vetëdijshme edhe pse nën trysinë e një frustrimi pa konflikt të menjëhershëm, individ do të mund të kuptojë rëndësinë e kësaj përmbajtjeje të re dhe nuk do të mund ta përdorë atë drejt derisa të mund ta interpretojë. Teoria e hershme e koncepton konfliktin e pavetëdijshëm si diçka mes impulseve të vetëdijshme të fuqishme që nuk janë të organizuara nga ndonjë plan. Asnjë impuls që vepron i vetëm nuk mund të jetë më i rëndësishëm se të tjerët për progresin e individit. Konflikti i pavetëdijshëm qëndron mes disa qëllimeve normale

⁸ Shohim këtu paraprijësin e ciklit të sjelljes tendencë keqpërshtatëse

të personit dhe besimeve patogjene se duke u sjellë në një formë të caktuar individ do të jetë në rrezik. Klinikisti e ndihmon të kuptojë se këto besime nuk janë të vërteta dhe se mund të zhbëhen. Sipas qasjes së dytë të Frojdit në *Psikologjinë e Egos (Egoja dhe Idi dhe Shkrime të tjera, 1920-1940)* individ mund të ushtrojë kontroll mbi materialet e pavetëdijshme mendore (represionet). Në zhvillimin e psikologjisë së egos Frojdi kufizoi rolin e rregullimit të pavetëdijshëm automatik të proceseve mendore dhe ndërftoi rolin e motiveve të pavetëdijshme që kërkojnë plotësimin e qëllimeve afatgjata sipas funksioneve të larta mendore.

Represioni rregullohet në mënyrë të pavetëdijshme nga kriteret e rrezikut dhe sigurisë ndaj personi vendos nëse mund të përjetojë lirisht një përvojë nga përmbajtja e mendimit të represuar e më pas ta rregullojë atë duke e sjellë në vetëdije.

Censori Ego rregullon shprehjen e impulseve nga kriteret e sigurisë, rrezikut dhe impulseve të treguara në ëndrra pasi fuqia e ëndërrtarit është e mbyllur kur ai ka rënë në gjumë. Sipas Frojdit psikopatologjia vjen nga besimet patogjene dhe ankthi i kastrimit në kateksis⁹. Besimet patogjene ndryshojnë nga fantazitë pasi këto të fundit rregullohen nga parimi i kënaqësisë. Besimet patogjene në vetvete nuk shkojnë përkundrajt realitetit, ato përfaqësojnë realitetin dhe janë pjesë e Egos së pavetëdijshme. Idi nuk mund të krijojë besime pasi ato kthehen automatikisht kundër realiteteve të dhimbshme.

Për Frojdit besimi i kastrimit është besim për realitetin¹⁰.

Te *“Interpretimi i Ëndrrave”* (1899) Frojdi parashtroi se një person “pa kapacitet” në mënyrë të pavetëdijshme mund të mendojë e të përdorë funksionet e larta mendore si pasojë e ndërveprimit të forcave psikike, mekanizmave mbrojtës dhe impulseve. Vetë mendja funksionon automatikisht dhe impulset kërkojnë kënaqësi të

⁹ Termi i “kateksis” si përshtatje e termit gjerman “Besetzung” përmes të cilës shprehet ideja e energjisë psikike që është e atashuar me strukturat mendore dhe proceset

¹⁰ Në psikanalizë termi “kasttrim” lidhet me një sërë gjendjesh dhe asosacionesh të tjera si: “ankth”, “kërcënues”, “simbolik”, “frikë”, “terror” dhe “kompleks”. Sipas përcaktimit psikanalitik, termi lidhet me kompleksin e Edipit si problematika kryesore në zhvillimin psikoseksual dhe jetën mendore në përgjithësi. Kompleksi i Edipit a frika e individëve meshkuj nga heqja e penisit, si rasti i “Hansit të Vogël” (1909) është zhvilluar gjerësisht nga Frojdi më 1915 1920 në veprat më të rëndësishme si “Interpretimi i Ëndrrave” (1900), “Psikopatologjia e Jetës së Përditshme” (1901) dhe “Tre ese mbi Teoritë e Seksualitetit” (1905). Pjesë dhe referate të këtyre veprave dhe gjithë shkrimeve të Frojdit janë mbështetëse të rëndësishme në tërësinë e këtij punimi. (Marrë nga “International Dictionary of Psychoanalysis”, fq.251)

menjëhershme që kundërshtohen nga mekanizmat mbrojtës. Impulset dhe mekanizmat mbrojtës ndërveprojnë në mënyrë dinamike dhe nga këto ndërveprime rrjedhojnë gati të gjitha dukuritë e jetës mendore.

Te *“Frenime, Simptoma dhe Ankhth”*(1959) Frojdi shkruan se Ego mund të rregullojë sjelljen në mënyrë të pavetëdijshme nga mendimi dhe jo nga proceset e pavetëdijshme. Ndaj, egoja vendos nëse marrja e kënaqësisë duhet marrë menjëherë, duhet shtyrë apo nëse kërkesa e bërë nga instinkti duhet të shtypet si e rrezikshme (Parim i realitetit). Ashtu siç Idi drejtohet për marrje të kënaqësisë, Ego udhëhiqet nga siguria dhe ka për detyrë vetëmbrojtjen që idi e anashkalon (Frojd, 1940). Individi mund të jetë i motivuar në mënyrë të pavetëdijshme për të vlerësuar realitetin dhe përcaktuar rreziqet e realitetit. Egoja e personit në këtë vendimmarrje mendon në mënyrë të pavetëdijshme rreth veprimeve që bën.

Teksa konsideron situatën e tashme krahasimisht me përvojat e shkuara dhe veprimet eksperimentale, Egoja ka për qëllim testimin e mjedisit dhe të përcaktojë nëse mund të kryejë ndonjë veprim.

Për këtë arsye te *“Egoja dhe Idi”* (1923) një strukturë e re e personalitetit tonë, Superego, ndahet në dy elementë përbërëse: Ego Real dhe Ego Ideal dhe mund të represohet e të operojë në funksionet e larta mendore duke karakterizuar motive që nuk janë as të kënaqshme as të dhimbshme. Të dy këto elemente janë pjesë e strukturës së organizimit të personalitetit të cilat analizohen në këtë punim. Frojdi përshkruan dy procese të tjera mendore që shkojnë ndesh me atë që ai e quajti *“Hipoteza e Rregullimit Automatik”* për të kuptuar mënyrën e sjelljes së Egos në kushtet e tronditjeve të befasishme (traumave). Procesi i parë (në *“Përtej Parimit të Kënaqësisë”*) është një dëshirë e pavetëdijshme për kontroll që mund të përsërisë përvojat traumatike jo vetëm për kënaqësi por për të fituar kontroll mbi përvojat.

Më tej te *“Terminologjia dhe Ndër terminologjia e Analizës”*(1937) koncepti u zgjerua duke marrë parasysh se individi bashkpunon në mënyrë të pavetëdijshme me analistin për të zgjidhur problemet dhe duke i dhënë Egos *“detyrën e vetëmbrojtjes”* për të marrë kontroll ndaj instinktit dhe rregullimit të sjelljes sipas kriterit të vet të rrezikut dhe sigurisë.

Procesi tjetër është ai i *Identifikimit* të pavetëdijshtëm që sipas Frojdit është i rëndësishëm për zhvillimin e Egos dhe Superegos. Koncepti i identifikimit përqendrohet në rëndësinë e përvojave dhe në zhvillimin e motivacionit. Koncepti i Superegos i trajton motivet si të qëndrueshme edhe pse mund të jenë të dhimshme. Një individ mund të mendojë, vendosë dhe planifikojë në mënyrë të pavetëdijshtë.

Në përpilimin e planeve ai mund të vlerësojë realitetin e tij *mund të mësojë duke u identifikuar me të tjerët* dhe mund të motivohet për të zgjidhur problemet e pavetëdijshtë në procesin e marrëdhënies psikanalitike. Në krijimin dhe zhvillimin e psikopatologjisë, psikanaliza supozon se shfaqet klinike e simptomave neurotike, patologjive apo tipologjive të ndryshme të sëmundjeve psikotike dhe psikosomatike pasqyrojnë konflikte intrapsikike të pavetëdijshtë mes pjesëzave të brendshme. Ato gjithashtu pasqyrojnë veprime mbrojtëse që reflektojnë realitetin e parimit dhe motivin e pavetëdijshtëm të Superegos.

Konfliktet e pavetëdijshtë mes impulseve dhe mekanizmave mbrojtëse shprehen në formën e konflikteve të strukturara ndërmjet këtyre strukturave tripalëshe. Kështu mund të shquajmë mekanizma mbrojtëse të Egos ndaj impulseve të Idit, Superego nxit frenimet e Egos dhe përsëritjen e impulseve të Idit (Kompulsioni i përsëritur). Të gjitha këto struktura ndërtojnë një mekanizëm mbrojtës të tretë të Idit ndaj shtypjeve të Superegos.

Rrjedhojat e konflikteve të pavetëdijshtë kërkojnë analizën e të tërës bashkë me pjesët e veçanta .

Kjo tërësi konfliktuale shprehet klinikisht në tre dukuri:

- Frenime të funksioneve normale të Egos rreth marrëdhënieve sociale, intimitetit, dhe ndjenjave.
- Formësimin e impulseve të represuara dhe mekanizmave mbrojtëse ndaj tyre.

- Shfaqjen disociative të impulseve dhe mekanizme mbrojtëse¹¹

Në lehtësimin e rishfaqjes së konflikteve patogjene të pavetëdijshme dhe trajtimin e situatave përmes analizës sistematike të mekanizme mbrojtëse, psikanaliza sjell në sipërfaqe impulset e represuara përmes përpunimit dhe integritit përshtatës të materialeve të hershme të individit me Egon e të rriturit.



Figura 0.2 Tipologjitë e trajtesës dhe trajtimit psikanalitik.

Frojdi ka përshkruar konceptin e “*sublimimit*” si një transformim përshtatës të së pavetëdijshme që duhet kthyer në forma më të vetëdijshme për të kërkuar kënaqësi. Rezultati i këtij procesi është kompromisi përshtatës mes impulsit dhe mekanizmit mbrojtës. Në procesin e analizës integrimi gradual në vetëdije i dëshirave të pavetëdijshme të së shkuarës dhe kuptimi i kërcënimeve e rreziqeve të lidhura me to, zhbën konfliktet tri-palëshe dhe kthen individin në gjendjen e vet fillestare.

Termi i marrëdhënies me objektet lidhet me përfaqësimet e brendshme të vetes në marrëdhënie me të tjerët. Frojd e përdori termin objekt për të përshkruar përfaqësimin e brendshëm mendor të fëmijës mbi gjërat që e kënaqin atë. Marrëdhëniet me objektin vënë në dukje se foshnjat veprojnë ndaj njerëzve për të plotësuar nevojat e tyre përfshirë pjesët e objektit.

Në teorinë e Marrëdhënieve me Objektin formulimi mbi teorinë strukturore (zhbërja e konflikteve të së pavetëdijshme mes impulseve dhe mekanizme mbrojtëse) ka ndryshuar pasi konfliktet e pavetëdijshme janë të brendësuar te

¹¹ Mjaft individë që kalojnë përvoja traumatike mund të kalojnë gjithashtu periudha të ripërjetimit të traumës dhe deatashimit. Kjo formë e psikotraumatologjisë e quajtur “traumë disociative” mund të jetë karakteristike e stresit posttraumatik (APA, 1994) çrregullim i stresit ekstrem dhe të çrregullimeve disociative psikopatologjike.

marrëdhëniet me objektin. Këto marrëdhënie përcaktojnë natyrën e veprimeve mbrojtëse dhe impulseve ndaj objekteve a marrëdhënieve që u drejtohen. Marrëdhëniet e brendësuar me objektin përbëjnë blloqet bazë të strukturës tre-palëshe të idit, egos dhe superegos. Marrëdhëniet me objektin janë të rishfaqura në situatat e trajtimit të marrëdhënieve të pavetëdijshme mes vetes dhe tjetrit që në marrëdhënien analitike është procesi i “transferencës”.¹² Transferenca është një përsëritje e pavetëdijshme “këtu dhe tani” marrëdhënie patogjene konfliktuale nga e shkuara. Transferenca pasqyron rishfaqen e konflikteve të së shkuarës në formën e përsëritjes. Përsëritja jep të dhëna rreth së shkuarës por strukturën edhe mbrojtjen pasi individit përsërit dhe nuk kujton nëpërmjet mekanizmave mbrojtëse.

Interpretimi i rezistencës së individit (subjekt-objektit) lejon gjithashtu edhe përdorimin e asociacioneve të lira për të kthjelluar individin mbi dëshirat dhe frikërat e pavetëdijshme, fantazitë, situatat traumatike dhe konfliktet e pazgjidhura. Veprimet mbrojtëse klasifikohen si mekanizma mbrojtëse të vetë egos, mekanizmat mbrojtëse të superegos shfaqen në formën e ndjesive të fajit (tendencë e individit me nivel organizimi borderline) ndërsa rezistencat e idit janë të dallueshme në formën e kompulsioneve të përsëritura.¹³ Frojdi e shihte libidon e egos si kundërthënës me libidon e objektit.

Objekti kuptohej sipas teorisë metapsikologjike të Frojdit thjesht si objekt i jashtëm që nuk përmban ego. Kështu objekti kërkonte vetëm mundësinë e vet për vazhdimësi, këtu, është fëmija që “është përgjegjës” sipas kënaqësisë së nevojave të trupit për të zhvilluar auto erotizmin dhe përgatitur për seksualitetin e ardhshëm.

Në shkrimin e tij “*Egoja dhe Idi*” Frojdi shkruan: “Efektet e identifikimeve të para të shfaqura në fëmijërinë e hershme do të jenë të përgjithshme dhe jetëgjata. Shkojmë kështu në origjinën e ego idealit; pasi përtej saj fshihen identifikimet e para dhe të rëndësishme të individit identifikimi me Atin në parahistorinë e vetë. Kjo nuk është në pamje të parë pasoja a rezultati i një kateksi të objektit; është një identifikimin i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm dhe është vendosur aty shumë më parë sesa çdo kateks objekti” (1923b, fq. 31).

¹² Termi “transferencë” nga gjermanishtja “*Übertragung*” mbart kuptimin “të çosh përtej”. Ky term shfaqet për herë të parë në veprën “Studime mbi Histerinë” nga Breuer dhe Frojdi (1895) dhe është zhvilluar me kohën deri në zhvillimin e tij të plotë për shpjegimin e dukurive transferenciale në praktikën analitike në vitin 2005. Termi nënkupton procesin sipas të cilit ndodh zhvendosja e dëshirave a ndjesive të lidhura me të shkuarën shumë të rëndësishme të individit, te personi tjetër ballë tij (analisti). (International Dict. of Psychoanalysis, fq. 176)

¹³ Që në patologjinë e jetës së përditshme janë burimi parësor i tendencës së sjelljes keqpërshtatëse.

Ndryshe nga ky konceptim i Frojdi mbi dy strukturat e para subjekt-objekt të organizimit të personalitetit, Fairbairn na shtjellon termin objekt si *përvoja mendore të brendshme me një strukturë dhe përkatësi dinamike të pastër*. Këto objekte mund të veprojnë si elemente të pavarura brenda mendjes (Fairbairn,1944). Fairbairn nuk i konsideron objektet thjesht si figura të brendshme a përfaqësime mendore por elemente të strukturuar që mund të krijojnë aktivitet psikologjik. Modeli i tij teorik hulumtoi ndërveprimet e pjesëve të egos ndaj objekteve të ndryshme të brendësuar.

Ai gjithashtu vëzhgoi sesi këto marrëdhënie intrapsikike funksionojnë dhe shfaqen në lidhje me objektet e jashtme. Rrjedhojat e ndërveprimit të kësaj “situate endopsikike” shfaqen në krijimin të ashtuquajturit “*objekt simbolik*”. Objekti simbolik përfaqëson zhvillimin e një konteksti që vjen në jetë a zhbëhet brenda situatës analitike, ashtu siç ka ardhur në jetë ose është zhbërë mes nënës dhe të voglit.

Kjo situatë zhvillimi degëzohet brenda botës intrapsikike të marrëdhënieve me objektet.

Një dallim i qenësishëm mes objektit simbolik¹⁴ dhe analitik është natyra e mjedisit të tyre të brendshëm. Në krijimin e vet identifikimi projektiv është gjendja e parë dhe e origjinës nga e cila i vogli përjeton dhe i jep kuptim botës. Jeta foshnjërore fillon me një sërë gjendjesh neurologjike të fluksit, tensionit psikologjik dhe fizik, stimulimeve somatike dhe konjitive dhe ballafaqimit të tyre me përvojat e ardhura nga mjedisi.

Që nga fillesat e tij të para, organizmi i të voglit kërkon objektin dhe fantazitë e lidhura me të që të shkaktojnë një formë primitive të kuptimit dhe një shkarkesë të gjendjeve impulsive.

Gjendje të tilla të nevojave trupore dhe mendore janë të lindura dhe nëse nuk plotësohen në mënyrë të vazhdueshme, ato mund të shpien në problematika serioze të jetës së të rriturit më ekstremja e të cilave mund të konsiderohet vetëvrasja (Witz,1965).

Nëse nevojat e brendshme të vetes mbeten të paplotësuara, ato fillojnë të

¹⁴ Objekti simbolik është rrjedhojë e aëekteve të nirvanës mbi identifikimin projektiv, një gjendje mes nevojave më të menjëhershme libidinale dhe agresive të subjektit dhe objektit

zhvendosen në gjendje të brendshme të ankthit që nga ana e tyre zhvillojnë përvoja të fragmentarizuara e shkatërruese për organizmin. Identifikimi projektiv ¹⁵është kështu një shtrirje e idesë Frojdiane për instinkti e vdekjes (Thanatos) (Frojd,1920).

Identifikimi nuk është vetëm një mekanizëm mbrojtës i individit ndaj zemëratës të humbjes, braktisjes por, edhe një dualizëm ndaj objekteve dhe vetes. Zhvillimi i egos ndodh në stadi të ndryshme të vetëdijes dhe të diferencimit e më pas të integritetit të vetes si përfaqësi të objekteve. Kështu për shembull, Frojdi argumenton në trajtesën e tij të zhvillimit të “Egos dhe të Idit” se marrëdhëniet objektuale melankolike të individit vijnë nga gjendja e pa maturuar e vetes dhe tjetrit. Ndërsa në mendimin dialektik të Fairbairn kemi të bëjmë me një strukturë të marrëdhënieve individuale që vijnë nga marrëdhëniet me të tjerët.

Andaj, ne krijojmë modele origjinë, modele strukturore dhe impulsi si dhe modele alternative.¹⁶ Fëmija, pra, është i prirur për të kërkuar marrëdhënien para se të kërkojë kënaqësinë.

Për analogji i rrituri priret të plotësojë marrëdhënien para se të plotësojë libidon(kënaqësinë). Objekti simbolik përfaqëson aëktet më thelbësore të përpjekjeve mendore për të organizuar dhe strukturuar përvojat e brendshme dhe të jashtme jashtë fushës së fantazive të gjendjes “lufto ose ik”. Identifikimi projektiv komunikon nevojat e foshnjërisë të cilat mbeten një formë e komunikimit primitiv përgjatë gjithë jetës qoftë për nevojat bazë, qoftë për gjendjet normale, qoftë për marrëdhënien e pavetëdijshme patologjike.

Në këtë kuptim objekti simbolik është rezultatja e dukurive intrapsikike dhe interpersonale që bashkë ndodhin në mënyrë të natyrshme brenda një entiteti. Teoritë bashkëkohore të psikanalizës vendosin në qendër të tyre sekuenca të parashikueshme të zhvillimit në të cilat përvojat e hershme të vetes zhvendosen në lidhje me një vetëdijen të gjerë të të tjerëve dhe krijojnë marrëdhëniet e mëvonta me ta.

Porsa të vendosen modelet e vetes dhe të tjerëve, supozohet se këto modele do të

¹⁵ Marrëdhëniet intrapsikike dhe interpersonale mes përfaqësimit objektual dhe objektit të jashtëm, krijohet në një gjendje të ngatërruar të vetes dhe të tjetrit por, individizimi dhe diferencimi real i vetes nga mjedisi i jashtëm mbetet në linjën e shëndetit normal

¹⁶ Zhvillimi i Personalitetit, fq.20

ndikojnë në marrëdhëniet e mëvonshme ndërpersonale.

Njerëzit kërkojnë të krijojnë marrëdhënie që do të jenë të përshtatshme me modelet që ata kanë vendosur në përvojat e tyre të hershme.

Kështu për shembull individët që janë ose të varur ose të de-atashuar, mund të përsërisin modelet e lidhjes që ata kanë vendosur me nënën kur kanë qenë të vegjël (Hedges,1983). Teori të tilla japin insight¹⁷ në mënyrën sesi bota e brendshme e individit mund të shkaktojë vështirësi në marrëdhëniet dhe njerëzit e jetesës e tyre të tashme (St. Clair,2003). Në shqyrtimet e bëra në teorinë e Frojdit, shkrimet e hershme të Frojdit na referojnë mbi nocionet e objekteve të brendshme dhe përfaqësitë e tyre.

Në punimin e tij “*Mbi Afazinë*”(1981-1953) Frojdi propozoi një model të ri të të folurit e rrjedhimisht të krijimit të marrëdhënieve duke u interesuar se në çfarë mënyre trupi riprodhohet në korteksin cerebral. Në këtë punim ai trajtoi mënyrën sesi *Objektvorstellung*¹⁸ ekziston si entitet i veçantë. Ai argumentoi se përfaqësimi i objekteve ndërtohet në procesin e perceptimit dhe qëndrimit në botën reale. Një vit më vonë, në shkrimin “*Studime mbi Histerinë*”¹⁹ Frojdi reflektoi mbi termin e transferencës si një “lidhje e rremë”mes dikujt që ka qenë objekt i dëshirave të hershme të pacientit dhe terapistit që po trajton tanimë pacientin. Ai besonte se pasja e një lidhjeje të tillë mes të shkuarës dhe të tashmes duhet të ketë qenë e brendësuar dhe e përfaqësuar racionalisht te njeriu. Në veprën e tij “*Interpretimi i Ëndrrave*”(1900) Frojdi fillon t'i referohet gjurmëve të pavetëdijshme të kujtesës duke vënë në dukje se janë ato që kanë një fuqi të tillë bindëse te ndjesitë e përvojave të hershme të harruara saqë mund të tërheqin vëmendjen ndaj vetes në ëndërr. Në ëndrra shpesh individi sheh formësimin e simptomave të tij të shtypura nga vetëdija.

¹⁷ Kuptimi i burimit të vështërsive emocionale,forcave emocionale që të ardhura në sipërfaqe përtej mendimit dhe veprimit,zgjidhin problemet. Insight është një nga termat më ndikues në teorinë e zhvillimit të psikoanalizës.Termi është përdorur për herë të parë nga Breuer dhe Frojd (1895) dhe mori kuptimin e mirëfilltë të procesit në studimet e Serba dhe Stachey për strukturat e psikologjisë së egos.Insighti është një proces ku integrohen disa funksione të egos.Në zhvillime teorike të tjera nga Kriss(1956)insight kërkon përdorimin e mirë e regresionit të egos,kontrollin e afektit dhe ndërlidhjen e tyre me ego realin dhe ego idealin që krijojnë patologjitë e tyre.(Insight and Self-Observation;Robert L.Hatcher,1972)

¹⁸ Termi gjerman për përfaqësimin mendor të objekteve

¹⁹ Breuer dhe Frojd, 1895

Këto simptoma shfaqen në përfaqësime simbolike që i japin kuptim karakterit të patologjisë. Në të njëjtin vëllim Frojdi gjithashtu diskuton për “identifikimet histerike” duke parafrazuar se “mjaft nga simptomat e pacientëve të tij ishin një përngjasim i pavetëdijshëm i tyre ndaj personave të rëndësishëm në jetë, shpesh për shkak të trasgersioneve të tashme”. Më 1914, Frojd parashtroi idenë se fantazitë e pavetëdijshme për objektet në disa kushte të caktuara mund të marrin vendin e marrëdhënieve të tashme po kaq të turbulluara.

Tri vite më vonë në veprën “*Mërmëritje dhe Melankolia*” (1917-1957) vepra e tij më e madhe në lidhje me marrëdhëniet me objektet, identifikimi kthehet në mjetin me të cilin individi jo vetëm kujton por edhe zëvendëson emocionalisht një objekt të jashtëm të humbur me një aspekt të vetes që është modeluar sipas objektit të jashtëm. Frojdi ka përshkruar mënyrën sesi në melankoli një marrëdhënie me objektin e jashtëm “*transformohet në një copëtim mes veprimtarive kritike të egos dhe vetë egos si të ndryshuar nga identifikimi*”²⁰ Pra, një marrëdhënie e jashtme zëvendësohet me një tjetër të brendshme dhe zhvillon një lidhje të dy aspekteve aktive të personit që janë rezultat i egos së copëtuar. Modeli endopsikik i Fairbairn kohë më vonë përfaqëson këtë gërshëtim të identifikimit Frojdian. Identifikimi sipas kësaj teorie, nuk kuptohej më si një mbrojtje ndaj zemëratës së personit ose agresion ndaj humbjes, braktisjes dhe ambivalencës së objektit porse si një antitezë e përfaqësimit libidinal të Egos.

2.1. Teoria e Ronald Fairbairn për Marrëdhëniet me Objektin.

Shkrimet e Fairbairn²¹ dhe Sullivan mbështetën zhvillimin e mëtejshëm të strukturës së marrëdhënieve të individit me njerëzit e tjerë. Sipas këtyre autorëve,

²⁰ fq.249

²¹ Fairbairn (1889-1964) është një nga themeluesit e lëvizjes së marrëdhënieve me objektet. Ai besonte se egoja e të voglit është e plotë në fillësë dhe lidhet me objektin e plotë; më pas të dyja ndahen sipas përvojës së tyre me traumën. Ai ndërtoi një strukturë topografike mbi botën e brendshme (endopsikike) që përbëhet nga nivele me tre ego dhe tre objekte. Së pari gjendet Objekti Origjinal (OO) dhe Egoja Origjinale (OE) ku përmes brendësimit të objektit (prindit) refuzues, ai e ndan marrëdhënien në dy kahe: objekti refuzues (RO) dhe “objekti eksitues” (EO). Së dyti, Egoja antilibidiale (AE) e krijuar nga kjo bashkësi, atashohet dhe identifikohet me RO, ndërsa egoja libidinale (LE) atashohet me EO. Së treti, operacionet e ndarjes së egove dhe objekteve kthejnë OO në një Objekt Ideal (IO) dhe OE në Ego Qendrore. Në thelb in e vet, modeli i propozuar nga Fairbairn dhe i trajtuar gjerësisht në këtë punim, janë një argument i fuqishëm për linjën e zhvillimit të personaliteti patologjik dhe personalitetit me tendencë patologjike

njerëzit krijojnë modelin e tyre të origjinës, modelin e strukturës dhe impulsit dhe modelin alternativ të marrëdhënieve²². Sipas Fairbairn, fëmija kërkon marrëdhënien përpara kënaqësisë. Në teorinë e tij Fairbairn i shihte njerëzit si qenie të lidhura me objektet si natyrë. Bashkësia themelore sipas tij ishte vetja në lidhje me një tjetër dhe natyra e marrëdhënies ndërmjet tyre. Bashkësia njerëzore në botën e jashtme përfshin para së gjithash marrëdhëniet me të tjerët.

Në psikologjinë e dinamikave të brendshme vetja duhet të kuptohet si me eksistencë të përhershme dhe sipas marrëdhënieve që ka, mban mend, dëshiron ose krijon.

Në modelin strukturor dhe të marrëdhënieve të Fairbairn, forma e vetes rritet dhe ndryshon nga përvojat në marrëdhëniet e tyre, ndërsa natyra e këtyre marrëdhënieve është krijuar dhe ndryshuar nga vetja. Teoria e Fairbairn jep një rëndësi të veçantë funksionimit brenda psikik (intrapsikik).

Modeli strukturor dhe i marrëdhënieve na jep mundësinë e krijimit të nocioneve më të gjera dhe të pasura për botën e brendshme. Fairbairn e shihte veten jo thjesht si rezultat i përvojës por edhe si një parakusht për të.

Vetja është pikënisja para ekzistuese për të gjitha përvojat dhe siguron vazhdimësinë në zhvillim, në ngjyrim dhe formimin e të gjithë përvojës të mbledhur.

Fairbairn ka argumentuar se është pikërisht në këtë marrëdhënie me të tjerët që vetja shprehet dhe formësohet në kursin e zhvillimit. Kjo pjesë e teorisë së vetes është pra “relacionale” në mënyrën e përshkruar nga Mitchell (1999) i cili na argumenton se “mbretëria ndërpersonale dhe intrapsikike krijon, penetron dhe transformon vetveten në një mënyrë komplekse dhe të lehtë” (fq.9).

Kjo bashkësi e vetes, tjetrit dhe e marrëdhënies kthehet në model për kuptimin e formës për të gjitha nënsistemet brenda vetes.

Teoria e Marrëdhënieve me Objektet e Fairbairn dallon nga ajo e Frojd pasi ajo fokusohet në të kuptuarin subjektiv të botës së brendshme të individit mbi marrëdhëniet objektuale të brendësuar që u kundërvihen dëshirave dhe

²² Studimet Psikanatike mbi Personalitetin, "Psychoanalytic Studies on Personality" fq.20

mekanizmave mbrojtëse të pavetëdijshme.

Për Fairbairn “*libido është objekt kërkues, jo kërkues i kënaqësisë*” (fq.82).

Sjellja orjentohej ndaj pikëtakimit njerëzor dhe jo ndaj marrjes së kënaqësisë seksuale ose dëshirave agresive. Kjo teori gjithashtu vë në pah se çrregullimet e personalitetit pasqyrojnë problemet e atashimit mes të voglit dhe kujdestarit gjatë 2 apo 3 viteve të para të jetës. Neurozat shihen si të lidhura me zgjidhjen jo të përshtatshme të Kompleksit të Edipit.

Frojd (1917-1957) argumentoi se marrëdhëniet me objektet janë një mënyrë e vazhdimësisë së marrjes së kënaqësisë duke brendësuar imazhet e dashurisë pas humbjes. Teoria e Fairbairn mori zhvillimin e saj përmes hulumtimeve të Melanie Klein (1935-1975; 1957-1975) e cila arsyetoi se marrëdhëniet me objektet ekzistojnë që nga lindja kënaqësisë së vërtetë në gjendjet e patologjive të rënda ku ego “thyeret”.

Fairbairn argumenton se fëmijët, madje edhe të rriturit, preferojnë më shumë të kenë një marrëdhënie të dhimbshme sesa asnjë marrëdhënie.

Një pjesë e të dhënave e studimeve të Fairbairn vijnë nga mjedisi dhe sjellja e fëmijëve të abuzuar. Sipas parimit të kënaqësisë fëmijët nuk duhet të atashohen me abuzuesit e tyre.

Në fakt, sikundër vëzhguan Fairbairn dhe autorë të tjerë në punën e tyre me këta fëmijë, ata lidhen edhe më fort me abuzuesit e tyre sesa fëmijët e tjerë. Kjo ishte e dhëna e parë për shpjegimin e dominancës së atashimit të objektit mbi kënaqësinë në motivacionin njerëzor.

Marrëdhëniet me objekte të këtuja duke mos arritur të reduktojnë kënaqësinë e impulsit dhe motiveve të tjera, brendësohen si objekte.

Fëmijët krijojnë një pjesë të psikes me imazhet e figurave përkujdesëse dhe këto imazhe janë gurët e themelit për të gjitha marrëdhëniet e tjera të ardhme.

Ndryshim thelbësor mes teorisë së Frojdit dhe asaj të Fairbairn për marrëdhëniet me objektet është se kjo e fundit nuk sheh motivacionin si pjesë e brendësimit të marrëdhënieve të hershme që mund të reduktohen në motive. Për Frojdin, fëmija brendëson imazhin e prindit në një përpjekje për të mjeshtëruar ndrydhjet e dëshirave

të tij/të saj. Kur fëmija e kupton që kjo dëshirë e madhe nuk do të plotësohet, e lë atë për prindin dhe brendëson objektin për të menaxhuar humbjen.

Në artikullin e tyre di Giuseppe et al.(2014) studime të ndryshme të trajtuara kanë treguar se diagnoza e çdo forme të çrregullimeve të personalitetit (ÇP) shoqërohet me një funksionalitet të ulët mbrojtës (Hilsenroth, Callahan, dhe Eudell, 2003; Lingiardi, Lonati, Fossati, Vanzulli dhe Maffei, 1999; Perry, 2001; Perry dhe Hoglend, 1998; Perry, Presniak, dhe Olson, 2013).

Në ÇP e rënda, si çrregullimi Kufitar(Borderline), Antisocial dhe Skizotipal mekanizmat mbrojtëse ndaj distorcionit dhe Funksionet e Përgjithshme Mbrojtëse²³ kanë parashikuar një ndryshim në episodet depresive, simptomat vetë shkatërruese dhe idetë e rikthyeshme të vetëvrasjes. Andaj, sa më i ashpër të jetë një shqetësim mendor aq më e pakët është fuqia dhe fortësia e Egos. Lidhur me natyrën e këtij studimi, argumentet e Fairbairn mbi zhvillimin e Libdos janë mbështetëse mbi zhvillimin e Vetes dhe Mekanizmave Ego-Mbrojtëse. Këtu do të trajtojmë dy polet e rëndësishme të zhvillimit të njeriut sipas qasjes psikanalitike të Fairbairn: Vetën Libidinale dhe Antilibidinale.

Fairbairn argumenton se brendësimi është i motivuar nga nevojat për vetë zhvillim dhe udhëheqje drejt botës ndërpersonale. Nëna dhe fëmija kërkojnë të formojnë një marrëdhënie të bazuar në modelet e ndërveprimit që nga nisja e jetës. Marrëdhënia objektuale e brendësuar në të cilën agresioni është kërcënim ndaj objektit mund të krijojë një burim frenimi.

Me një nënë reaguese në mënyrë perfekte fëmija nuk ka nevojë të mendojë ose zhvillojë botën e brendshme. Kur kjo skemë e perfeksionit fillon të njohë frustacionin, fëmija fillon të ndërtojë një imazh për objektin, që ndahet në tre pjesë: *objekti ideal* (ai që nuk do të mund të shkaktonte ndonjëherë frustacione); *objekti libidinal* (që mund të kënaqë nevojat e lidhura me nxitjen e fëmijës) dhe *objekti antilibidinal* (objekti që frustron).

Vetja pra, ndahet në tri pjesë –vete ideale, vete libidiale dhe vete antilibidiale.

²³ Këtu funksioni i përgjithshëm i mekanizmave mbrojtëse

Modeli i Fairbairn na jep një qartësi më të madhe edhe në shpjegimin e besimeve patogjene në format e lidërshiptit dhe ndarjes së mëtejshme të tyre sipas kategorive të PDC.

Ndërthurja mes idealizimit dhe çintegritit të një strukture të caktuar e kthen liderin në gjetjen e modeleve të reja alternative për t'u shmangur rrezikut. Energjia e investuar është kështu kah objektit antilibidial a shkatërrimit në një kohë tjetër të kësaj veteje antilibidiale nga modelet patogjene të brendshme. Ajo gjithashtu shpie në ndarjen përfundimtare të antilibidos për kërkimin e kënaqësisë në format të tjera të modelit të liderit çka në thelb e kthen atë në parim kënaqësie me objektin alternativ model. Në modelet e Ronald Britton dhe Wilfred Bion të cilët kanë argumentuar se mendimet krijuese “konceptohen” përkundër besimeve patogjene që krijojnë ankth, individit rikrijon kuptime të tjera alternative për të mbajtur bazat e besimit patogjen dhe për të toleruar rritjen e rrezikut.

Ndërsa në arsyetimet e tij për mbështetjen e marrëdhënieve objektuale Fairbairn citon... “*libido është kërkues i objektit dhe jo i kënaqësisë*” (1952, fq.82).

E gjithë sjellja njerëzore ndikohet dhe motivohet nga dëshira për të pasur marrëdhënie ndërpersonale dhe lidhje sociale me të tjerët.

Wolitzky dhe Eagle²⁴ më tej argumentojnë se: “*Përndryshe nga bota psikike e Frojdit që është e populluar nga dëshira e pavetëdijshme dhe mbrojtjet ndaj këtyre dëshirave, bota psikike e propozuar nga Fairbairn popullohet nga objektet e brendësuar dhe marrëdhëniet e brendësuar të objekteve*” (fq.56). Synimi kryesor i marrëdhënieve me objektin të Fairbairn është të dallohen tendencat sjellore keqpërshtatëse të brendësuar të individit dhe zëvendësimi i tyre me përfaqësime më të shëndetshme, zëvendësimi i “objektit të keq” me “objektin e mirë”²⁵

²⁴ Wolitzky dhe Eagle (1997) *Psychoanalytic Theories of Psychotherapy*. Gjendur në P.L. Wachtel dhe S.B. Messer (Eds.) *Theories of Psychotherapy: Origins and Evolution*. ëash, D.C.: American Psychological Association

²⁵ Wolitzky dhe Eagle, 1997, fq. 59




Figura 0.3 Përshkrimi i Fairbairn mbi Teorinë e Personalitetit të Marrëdhënieve me Objektivin.

Burimi : Studimet Psikanalitike të Personalitetit, Fairbairn (1952) me lejitim të Routledge Press

Siç mund të vërejmë nga paraqitja grafike e mësipërme, vetja në teorinë Fairbairniane ndahet në tre pjesë: vetja ideale, vetja libidinale dhe vetja antilibidinale. Modeli i tij ka hedhur dritë mbi kuptimin e disa dukurive tipike të gjendura në problematikat e ashpra të personalitetit: zhvendosja mes idealizimit dhe denigrimi i tjetrit (që përfaqëson objektin antilibidinal), vetë shkatërrimi i vetes antilibido dhe kërkimi për kënaqësi libidinale të palidhur me personin.

Le të kujtojmë këtu shumë dukuri të abuzimit verbal, fizik, emocional a psikologjik të raportuar në media përgjatë kësaj kohe në Shqipëri. Mjedisi shkollor por edhe komunitar është ndeshur shpesh me dukurinë e abuzimit të nxënësve.

Në një plan më të gjerë mund të themi se roli i shkollës si institucion edukues dhe organizues është ndryshuar me kohën qoftë nga përfaqësimi mendor që i është ofruar fëmijëve në këto vite tranzicioni, qoftë nga brendësimi i roleve të liderit mësues e drejtues.

Në këtë pikë pra, nxënësi shfaq antilibidon e vet në marrëdhënien me mësuesin, mësuesi tërheq energjinë antilibidinale e në bazë të strukturave të personalitetit e përçon atë te lideri drejtues e më pas në komunitet duke formuar një sjellje ciklike tendencë.

Nëse kjo sjellje tendencë vendoset për shembull në parametrat e një organizmi të personalitetit të ndikuar nga stresi a neurotik, rezultatja do të krijojë një personalitet lideri me nivel neurotik që në ndikimin qoftë edhe të një ngacmuesi të vogël, do të krijojë dhunë a shpërthime disforike.

Është e rëndësishme kësajsoj të kuptohet, monitorohet e parandalohet sjellja me tendencë keqpërshtatëse që në zanafillën e saj.

Energjia e kthyer është antilibidiale ndaj “shkatërrimit” në një kohë tjetër të kësaj veteje antilibidiale nga modelet patogjene të brendshme dhe ndarjen përfundimtare të antilibidos për kërkimin e kënaqësisë në format e tjera të modelit të liderit, çka në thelb e kthen atë në parim kënaqësie me modelin e objektit alternativ (identifikim projektiv).




Figura 0.4 Modeli i Fairbairn mbi Organizimin Psikik. Burimi: David Scharff (1982) me leje nga Roëman dhe Littlefield Publishers.

Në organizimin e Marrëdhënieve me Objektiv, hapi i parë është të përcaktohet niveli i organizimit të egos së individit: neurotik, kufitar ose psikotik.

Nancy McWilliams²⁶ argumenton se individët me një organizim neurotik kanë “.....përvojë të brendshme të vazhdimësisë së vetes në kohë” (1994, fq.54). Një identitet i mirë integruar e ndihmon individin neurotik të sublimojnë dhe zgjidhë impulset instiktive kundërthënëse.

Këta individë përdorin gjithashtu represionin që të mbajnë të paprekur aftësinë e tyre të testimit të realitetit dhe të mbrohen ndaj ndjesive të fajit ose turpit.

Individët me organizim personaliteti kufitar kanë një kuptim paksa të shpërndarë dhe të ngatërruar të vetes me disa kanale që mund të orientojnë sublimimin. Ata përdorin “çarjen” për t'u mbrojtur ndaj frikës që mund ti shpjerë në “refuzim ose

²⁶ 1994, fq.54 Gjendur në McWilliams (2011) *La diagnosi psicoanalitica*. Astrolabio, Roma

braktisje nga të tjerët”.

Kernberg (1986) arsyeton se në këto kushte, individët mund të përjetojnë ankth dhe të veprojnë në mënyra jo empatike. Individët me OP borderline ose psikotik kanë vështërsi të integrohen nëse dikush Tjetër i rëndësishëm për ta “*sillet keq*”.

Kështu, përjetimi i kësaj çarje të vetes dhe “*botës së mirë ose të keqe*” te këta individë i bën ata që të sillen në të njëjtën formë impulsive dhe rixhide në të gjitha situatat.

Individët me OP psikotik që kanë të mbartur një formë të dëmtuar të vetes dhe tjetrit shfaqin gjithashtu edhe një dëmtim të dukshëm në nivelet e tyre të testitmit të realitetit me kufij të çorganizuar mes mendimeve dhe perceptimeve për veten dhe për të tjerët.

Mekanizmi mbrotjtës i sublimimit të instiktit zëvendësohet nga mekanizmat bazë të kënaqësisë të impulsit në mendime, fantazi (ëndërrime të jetës së përditshme) e në veprime.

Në psikologjinë e dinamikave të brendshme vetja duhet të kuptohet si me eksistencë të përhershme dhe sipas marrëdhënieve që ka, mban mend, dëshiron ose krijon.

Në modelin strukturor dhe të marrëdhënieve të Fairbairn forma e vetes rritet dhe ndryshon nga përvojat në marrëdhëniet e tyre, ndërsa natyra e këtyre marrëdhënieve mund të krijohet dhe ndryshohet nga vetja.

Teoria e Fairbairn jep një rëndësi të veçantë funksionimit intrapsikik. Modeli i tij strukturor dhe i marrëdhënieve na jep mundësinë e krijimit të nocioneve më të gjera dhe të pasura për botën e brendshme.

Fairbairn e shihte veten jo thjesht si rezultat i përvojës por, edhe si një parakusht për të.

Vetja është pikënisja para ekzistuese për të gjitha përvojat dhe siguron vazhdimësinë në zhvillim, në ngjyrim dhe formimin e të gjithë përvojës. Ai ka argumentuar se është pikërisht në këtë marrëdhënie me të tjerët që “vetja shpreh veten” dhe formësohet në kursin e zhvillimit .

Kjo pjesë e teorisë së vetes është, pra, “relacionale” në mënyrën e përshkruar

nga Mitchell (1988) i cili na argumenton se “mbretëria ndërpersonale dhe intrapsikike krijon, përshkruan dhe trasformon njëra-tjetrën në një mënyrë komplekse dhe të lehtë”²⁷.

Edhe në shkrimet e vonëta të Frojdit për idin (1933) rezervuari i energjisë brenda psikes shihej sikur kërkonte në çdo kohë reduktimin e tensionit përmes shkarkimit të menjëhershëm të energjisë.

Ky model u quajt nga Frojdi “parimi i kënaqësisë” në të cilën nuk ka një vëmendje të vecantë të objekteve ndaj të cilëve ndodh ky shkarkim. Parimi i kënaqësisë shihej nga Frojdi si në zhvillim ndaj operacioneve me bazë parimin e realitetit.

Kjo formë e bashkëpunimit me natyrën specifike të botës së objekteve të jashtme shtyn kohën e marrjes së kënaqësisë, planifikimit dhe dijenisë për shkaqet dhe pasojat e tyre të ardhme.

Fairbairn²⁸ e vëzhgoi pozicionin e mbajtur nga Frojdi si një pasojë direkte e ndarjes që ai bënte mes energjisë dhe strukturës. Ai pasi krijoi një postulat për pandarshmërinë e energjisë nga struktura, e shoqërizoi atë me qëllimin e vetë-shprehjes që nuk mund të shihej ndryshe përveçse si një reduktim i thjeshtë tensioni pa u lidhur me një objekt ku mund të plotësohet shkarkimi.²⁹

Për Fairbairn, mbajtja e marrëdhënies me objektin ishte qëllimi i vetes dhe se kënaqësia e përfshirë në të ishte thjesht një pasojë dytësore.

Ndaj ai shkruan se: “*Funksioni i kënaqësisë libidiale është në thelb sigurimi i drejtimi për objektin*” (1952, fq.33). Më tej ai argumenton: “*Qëllimi i vërtetë libidinal është vendosja e marrëdhënies së kënaqësisë me objektet*” (fq.138).

Parimi i kënaqësisë më tepër sesa parimi i vetë shprehjes “përfaqëson një shkatërrim të sjelljes” (1952, fq. 139). Mënyra e duhur e shprehjes libidiale në të gjitha nivelet e zhvillimit është më shumë e lidhur me atë që ka përshkruar Frojd si “parim i realitetit” pasi parimi i realitetit shkon ndaj objekteve në mënyrën realiste të

²⁷ fq. 9

²⁸ 1952, fq. 149

²⁹ Shkarkimi i energjisë me qëllim zhbërjen e “pakënaqësisë” së eksitimeve që do të sjellin kënaqësinë e mëvonshme për individin element

vetes.

“Kërkimi i qartë i kënaqësisë ka si synim të tij të parë lehtësimin e tensionit e nevojës libidiale për këtë lehtësim. Një proces i tillë, ndodh zakonisht por, pasi nevoja libidiale është nevojë për objekte, lehtësimi i thjeshtë i tensionit përfshin disa mosarritje në krijimin e marrëdhënieve me objektet”.³⁰

Në qendër të kësaj teorie është koncepti se qeniet njerëzore nuk operojnë me qëllimin e reduktimit të tensionit por me qëllimin e vetë shprehjes në marrëdhënie me qeniet e tjera njerëzore. Kjo pikëpamje e motivacionit njerëzor është një nga kontributet më të mëdha që ka dhënë Fairbairn në teorinë bashkëkohore psikoanalitike.

Në qendër të teorisë së Frojdit për organizimin e psikës është ekzistenca e një parimi energjik, kaotik, thelbësor -idi- në të cilin kërkohet shkarkimi i menjëhershëm për kënaqësinë e tij të brendshme dhe evoluimin e një egoje të mirë strukturuar. Kjo ego në mënyrë të përshtatshme ka ardhur si pasojë e kontaktit mes energjisë së psikes së idit dhe realiteteve të botës së jashtme (Frojd, 1900, 1923, 1933).

Në këtë mënyrë Frojdi krijoi një ndarje mes strukturës për arritjen e shprehjes së vetes nga ajo energji brenda vetes që përpiket të shprehet.

Fairbarin përshtati këtë nocion për të paracaktuar se struktura dhe energjia ishin të pandashme: “si struktura e ndarë nga energjia dhe energjia e ndarë nga struktura janë koncepte të pakuptimta”³¹

Struktura është ajo që i jep formë energjisë dhe energjia nuk ekziston pa një formë të veçantë strukture. Fairnbairn i përshkruan më tej “impulset”³² si të pandashme nga strukturat endopsikike që u japin atyre energji dhe marrëdhëniet me objektet që angazhojnë këto struktura. Në të njëjtën formë “instiktet” nuk mund të konsiderohen si asgjë tjetër përveçse forma të energjisë që përbëjnë dinamikën e këtyre strukturave endopsikike (fq.85). Në sistemin e krijuar nga Fairbairn struktura e

³⁰ fq.140

³¹ Fairbairn, 1952, fq. 149

³² Termi i “impulseve” është përdorur qëllimisht nga Fairnbairn në thonjëza si mënyrë e tregimit të paretatisë me këtë formë të energjisë të trajtuar sikur të kishte një ekistencë të pavarur. Këto forma të mendimeve të pjesëzave të pandashme nga marrëdhëniet e ndërsjellta janë në bazën e mendimit të shkencës së fizikës kuantike dhe psikologjisë së sotme.

kërkuar për të arritur vetë shprehjen është e ndërlidhur pashmangëshmërisht me përpjekjet për shprehje. Vetja është njëkohësisht strukturë dhe energji e pandashme dhe përcaktuese e pjesëve të ndërsjellta.

Për Fairbairn mbajtja e marrëdhënies me objektin ishte qëllimi i vetes dhe kënaqësia e përfshirë në të ishte thjesht një pasojë dytësore. Ai shkruan se: *“Funkcioni i kënaqësisë libidiale është në thelb sigurimi i drejtimi për objektin. Qëllimi i vërtetë libidinal është vendosja e marrëdhënies së kënaqësisë me objektet”. Parimi i kënaqësisë më tepër sesa parimi i vetë-shprehjes “përfaqëson një shkatërrim të sjelljes”*.³³

Mënyra e duhur e shprehjes libidinale në të gjitha nivelet e zhvillimit është më shumë e lidhur me atë që ka përshkruar Frojd si “parim i realitetit” pasi parimi i realitetit shkon ndaj objekteve në mënyrën realiste të vetes.

“Kërkimi i qartë i kënaqësisë ka si synim të tij të parë lehtësimin e tensionit e nevojës libidiale për këtë lehtësim. Një proces i tillë ndodh zakonisht pasi nevoja libidiale është nevojë për objekte dhe lehtësimi i thjeshtë i tensionit përfshin disa mosarritje në krijimin e marrëdhënieve me objektet”.³⁴

Në qendër të kësaj teorie është koncepti se qeniet njerëzore nuk operojnë me qëllimin e reduktimit të tensionit por me qëllimin e vetë shprehjes në marrëdhënie me qeniet e tjera njerëzore.

Kjo pikëpamje e motivacionit njerëzor është një kontributet më të mëdha që ka dhënë Fairbairn në teorinë bashkëkohore psikanalitike. Fairbairn argumentoi se gjeneza endopsikike e psikes njerëzore qendron në “një strukturë origjinale dhe dinamike të egos prezente që në fillimin e saj” ose ashtu sikundër shkruan më tej “Personaliteti i paprishur i fëmijës konsiston në një ego dinamike unike”.³⁵

Elementët individual të këtyre pohimeve janë aq të rëndësishme sa të meritojnë qartësime. Përdorimi i termit “ego” nga Fairbairn nuk është e njëjtë me përdorimin strukturor të termit që ka dhënë Frojd. Ky term i referohet entitetit të vetes psikike. Fairbairn në këtë përdorim të “egos” vendos një paralele mes përdorimit të Frojdit për Egon dhe Idin. Në këtë kohë Frojdi i përdori këto terma si të lidhura me tërësinë e vetes së personit (Strachey, 1961). Fairbairn e pasqyron këtë gjendje si “strukturë

³³ 1952, fq. 33 ; fq.138 dhe fq.139

³⁴ fq.140

³⁵ 1952, fq. 148 dhe 1958, 107

dinamike-e-egos” apo “*ego dinamike*”, si struktura të lindura integrale të vetes. Vetja ishte një tërësi “e vetme” dhe “unike”. Kjo vete ishte sipas tij kushti apriorik i ekzistencës së jetës ajo qendronte pavarësisht të tjerave dhe nuk kishte varësi nga përvoja.

Në kombinimin e këtyre nocioneve të Fairbairn me idenë se energjia psikike është kërkuese e objekteve ... “koncepti përfundimtar i psikes është se ajo është vetë-prodhuese, unike në përcaktim dhe energji ,me potenciale dhe impulse për vetë-shprehje jashtë botës së objektit, për përjetimin e botës për vetë-shprehjen dhe ndërveprimin mes këtyre të dyjave. Vetja nuk kërkon një zhvillim strukturor të mëtejshëm”.

Energjia psikike fillon në një gjendje tërësie, të aftë dhe të përfshirë në procese vetë përcaktuese, vetë shprehëse dhe vetë përjetuese.

Fairbairn kishte dijeni që diferencimi strukturor ndodh në fakt brenda psikikës si e pashmangshme dhe universale.³⁶

Nënstrukturat që vijnë nga këto diferencime u panë si të modeluara sipas tërësisë së vetes: çdo element i vetes është në një marrëdhënie energjike dhe afektive me një element tjetër të botës objektuale. Këto nënstruktura të vetes u quajtën “struktura endopsikike”.

Fairbairn (1952) ka shkruar se “...disa tipare të pashmangshme të përvojave të hershme njerëzore kanë shpënë në vendosjen e dy prej këtyre strukturave endopsikike: e para e krijuar rreth përvojës së vetes në një marrëdhënie kënaqësie dhe e dyta e krijuar për refuzimin e marrëdhënies”. Secili nga këto nënsisteme të vetes përfaqëson një kristalizim të procesit rritës dhe vetë-përcaktues të vetes si tërësi.

Teksa vetja origjinë është në një marrëdhënie të pakufinjtë me botën e jashtme si tërësi si strukturë endopsikike ekziston një aspekt i veçantë i saj për marrëdhëniet ëecifike me botën objektuale. Fairbairn³⁷ arriti në përfundimin se ishte tërësia e këtij nënsistemi që përbënte strukturën endopsikike brenda vetes.

Dy strukturat e para endopsikike u quajtën si Vete Libidiale (sikundër do të shihet edhe më tej në këtë punim) që janë në marrëdhënie specifike me Objektin Eksitues.

³⁶ 1958, fq. 107

³⁷ 1952, fq.158

Nënsistemi i dytë u quajt Vete Antilibidiale apo Objekt Refuzues. Elementi i tretë në panoramën e Fairbairn të psikes së diferencuar është quajtur *Vete Qendrore*. Ky nocion është i njëjtë me atë që Fairbairn e përcaktoi si Ego Qendrore në marrëdhënie me Objektin e Idealizuar. Entiteti është ai që mbetet nga vetja origjinë pasi dy pjesët janë ndarë nga njëra-tjetra. Nga këto karakteristika Vetja Qendrore nuk është një “strukturë endopsikike” sikundër dy entitetet e tjera. Mund të shohim një formë njehsimi mes modelit të strukturës endopsikike të Fairbairn dhe modelit strukturor të Frojdit pasi modelet metapsikologjike kërkojnë të përshkruajnë të njëjtat fenomene klinike. Egoja e Frojdit i korrespondonte elementit “ego” në Veten Qendrore të Fairbairn pasi egoja është organizimi i vetë shprehjes dhe përvojës në marrëdhëniet me botën e jashtme³⁸.

Sikundër ka përcaktuar dhe Kernberg³⁹ nocioni i psikologëve të egos për një matricë të padiferencuar mes egos dhe idit e zhvillon më tej modelin Frojdian.

Pikëpamja ego-psikologjike vë në qendër nevojat për një zhvillim të diferencimit të strukturave të egos nga idi.

Kështu mund të dallohet qartë nocioni metapsikologjik i Fairbairn për nevojën e vetë shprehjes në marrëdhënie si qëllim kryesor i arritjes së kënaqësisë. Egoja Libidiale e sjellë si id në mjaft aspekte të funksionit të saj shihet nga Fairbairn si eksistuese në marrëdhëniet dinamike me objektin “e mirë”. Vetja Libidiale që përbëhet nga kjo marrëdhënie është një nënsistem i Vetes pasi është e lidhur me objektet në një formë të panjohur për idin.

Vetja Libidiale përfaqëson një lidhje të vecantë të specifikave të vetes në lidhje me disa veçanti të botës së objektit, të zëvendësueshme dhe me energji reciproke që mbart vetë idi. Superego lidhet pak a shumë me Objektin Refuzues të Vetes Antilibidiale edhe pse jo sinome me të.

Objekti refuzues përmban elementët më arkarikë të superegos edhe pse aspektet morale të funksionimit të saj lidhen më tepër me marrëdhënien me Objektin e

³⁸1952, fq. 106-148

³⁹ 1981, fq. 81

Idealizuar në Ego Ideal.

Kjo lidhje ndodh në Vetën Qendrore dhe në atë pjesë që Fairbairn e trajton si mekanizëm të mbrojtjes morale.

Koncepti i superegos vë në dukje elementin *objekt* të Vetës Antilibidiale dhe jo elementët e Egos Antilibidiniale. Duhet në këtë kuptim një analizë për mënyrën e funksionimit të marrëdhënies së të këtyre dy strukturave, egos dhe superegos për një studim të zhvillimeve të personalitetit nga fëmija te i rrituri i mëvonshëm. Disiplina psikologjike e teorisë së marrëdhënieve me objektin, me përfaqësimin e Jacobson dhe Kernberg, është përpjekur të transformojë metapsikologjinë e Frojdit në një vektor me isightin e Fairbairn (Kernberg, 1980).

Si modeli strukturor i Frojd ashtu edhe modifikimet e ndërmarra nga Psikologjia e Egos nuk mjaftojnë për të bërë një përcaktim apriorik të sistemeve të Vetës Qendrore, Libidiale dhe Antilibidiale të Fairbairn. Këtë argument e mbështes në literaturën shteruese të Otto Kernberg mbi strukturën dinamike të personalitetit tonë dhe modelet e personaliteteve patogjene (Kernberg, 1980). Elementi i vetes në strukturat endopsikike nuk është i njëjtë me vetë- përfaqësimin. E para lidhet krejtësisht me evolucionin e elementëve dinamikë të psikes që më së shumti janë të ndërtuara brenda aparatit tonë psikik ndërsa e dyta shpreh përfaqësimin e këtyre konstrukteve psikike të brendshme edhe në sjelljen e jashtme. Kështu për shembull, kur ne mendojmë për veten si objekt-subjekt e gjithë energjia jonë psikike përqëndrohet në proceset konjitive të brendshme që duhet të krijojnë mbështetje për mendimin. Por, kur përveç mendimit shfaqim edhe afekte dhe si rrjedhojë edhe veprime, atëherë energjia e shprehur fillimisht vetëm për një strukturë psikike do të shpërhapet edhe për dy struktura të tjera (afekti dhe sjellja) si energji e përgjithshme Libidiniale. Nëse kjo energji e shprehur “ngec” në përvojat e hershme të subjektit që mund të kenë qenë frenuese, mohuese apo penguese për të (inhibitore) atëherë energjia që në thelb do të duhej të ishte pozitive (Libidiniale) kthehet në negative-fiksuese (Antilibidiniale). Kështu subjekti i rritur lidh eksperiencat e hershme “traumatike” me atë që në situatën aktuale do të ishte “trauma në vazhdim”. Kësisoj ai frenohet nga mendimi pozitiv për veten dhe krijon pritshmëri të ulëta me frikën se

një ndryshim i çfarëdoshëm mund të sjellë “shfryrjen e antilibidos” në marrëdhëniet me të tjerët socialë në përgjithësi dhe tjetrin e rëndësishëm për të në veçanti. Shihet në këtë stad krijimi i një cikli të shtypjeve (represioneve) të individit nga marrëdhënia me të tjerët (objektet) që në varësi të ndryshimit të faktorëve të jashtëm mund të shpjerë në “shpërthime të sjelljes” me tendencë patogjene. Mos mbajtja e një ekuilibri ndërmjet strukturave të personalitetit endopsikik dhe energjisë libidiniale me energjinë antilibidiniale shpie pashmangshmërisht në vulnerabilitet dhe rritje të tendencës për psikopatologji. Kështu për shembull, në rastin e liderve shkollorë si popullatë e analizuar në këtë studim, përjetimi i stresit nga ndryshimet e politikave të befta të lidhura me shkollën, nxit prapë e mbajtjes së energjisë Antilibidiniale brenda vetë individit si strukturë endopsikike. Por nëse ky prag stimulohet në mënyrë të vazhduar nga ndryshimet e papritura që shkaktojnë prishje të ekuilibrave endopsikikë, atëherë e gjithë struktura mbajtëse e sjelljes do të minohet nga shfaqja e kufinjve (border), neurotizmit apo psikotizmit, çka do të lidhej pashmangshmërisht me marrëdhënien me të tjerët në shkollë. Një nga argumentet e parashtruara nga Fairbairn është se vetja ka si funksion të saj të lindur shprehjen aktive në formën e marrëdhënies me botën e objektit. Në një shqyrtim të interpretimeve të mëposhme të dhëna nga Winnicott dhe Khan (1953) për marrëdhënien mes vetes dhe objektit të padiferencuar (këtu pjesa e marrëdhënies së përditshme mes liderit shkollor dhe të tjerëve) Kernberg citon:

“Nëse objekti nuk është i diferencuar ai nuk mund të operojë si një objekt. Ajo që Fairbairn na referohen është kështu një fëmijë i vogël me nevojë por pa “asnjë mekanizëm” për t’i implementua ato, një fëmijë i vogël që nuk kërkon një objekt por çtension, një libido në kërkim të kënaqësisë, tension instiktual që kërkon kthimin në gjendje të qetësisë apo jo-eksitimit, proces që na rikthen edhe një herë te Frojd” (fq.332).

Vetja në teorinë e Fairbairn është një qendër përcaktuese e entitetit që ai e shihte si pikën e origjinë të proceseve psikike njerëzore dhe është kështu në mundësinë e pasjes së marrëdhënieve me qeniet e tjera njerëzore.

Kjo marrëdhënie krijohet edhe pse vetja ime dhe vetja e tjetrit nuk janë

diferencuar ende si objekte nga subjekti⁴⁰. Fillimisht kjo vete lidhet me botën me një bazë të pakët në përvojë për një diferencim të mirë të vetes-objekt.

Ajo e shpreh veten dhe përjeton botën në një mënyrë që është prototip për të gjitha veprimtaritë e ardhme të vetes. Është një fragment i vetes dhe jo tërësia e përfaqësisë së saj që vë në kompromis thelbin e një strukture endopsikike.

Si nënsistem i vetes një strukturë e tillë është një entitet i qëllimtë me energjinë e vet. Vetja Libidiale dhe Antilibidiale dallojnë nga vetja origjinë në dy mënyra.

Dallimi i parë është se çdo njëra prej tyre është një kristalizim i asaj që te vetja origjinë ishte një potencial më i zhvilluar. Teksa vetja origjinë ishte e lirë ndaj përvojës së botës dhe shprehte veten në marrëdhënie me atë botë, vetja poshtë saj mbart brenda një bazë para-eksistenciale për marrëdhëniet me aspekte specifike me botën. Vetet Libidiale dhe Antilibidiale vazhdojnë të kërkojnë përvojën dhe vetë shprehjen përmes marrëdhënieve me botën. Ky proces gjithsesi është i kufizuar nga fakti se kristalizimi i përfshirë në formimin e çdo strukture lejon vetëm atë përvojë dhe shprehje që është konsonante me bazën. Ky kufizim në sistemet e mëvetësishme të vetes në rritjen dhe ndryshimin e Veteve Libidiale dhe Antilibidiale është i forcuar nga diferencimi i tyre nga vetja origjinë.

Ndarja nga qendra e vetes i ka krijuar këto struktura si një akt represioni në të cilin vazhdojnë të përtërihen gjatë kohë.

Studiuesit argumentojnë që diferencimi vete-objekt përfshin diferencimin strukturor brenda psikes dhe se procesi i vetes dhe përfaqësimit të objektit është strukturor.

Për Fairbairn diferencimi strukturor ishte një proces mbrojtës dhe patologjik në zhvillimin e njeriut. Ai dha argumenta të shumtë për të shpjeguar linjën përmes të cilës psikja e një të vogli për shkak të paaftësisë për tu përballur me aspektet e pakënaqura të përvojës, e ka brendësuar këtë përvojë në një mënyrë të caktuar dhe e

⁴⁰ Ky parim është indryshëm nga parimi i Frojdit mbi introjeksionin subjekt-objekt ku përfaqësia mund ti përkasë të njëjtin individ ose qenie; kemi të bëjmë këtu me një ontologji të re të vetes së individit subjekt dhe vetes të objektit në marrëdhënie me të. Në moshën e rritur ky diferencim në marrëdhënie mund të sjellë tendencën për sjellje të shëndetshme ose patogjene (shën.aut.)

ka vendosur atë në disa struktura endopsikike.

Krijimi i këtyre strukturave përfshin ndarjen e vetes dhe represionin e asaj pjese të vetes që zhbëhet nga e tëra. Represioni është elementi kryesor në krijimin e strukturës endopsikike sepse është mekanizmi sipas të cilit vetja ndahet. Përvoja e integruar të vetja mund të ketë shfaqje në kujtesë ose në ndryshimin gradual të vetes si e tërë. Vetëm kur kjo përvojë mbetet e pintegruar kur është aq jo e tolerueshme sa të mos shkojë në vetëdije, ajo mund të bëhet subjekt i represionit.

Kur kjo pjesë e represuar është në një marrëdhënie kaq të brendshme me jetën e vetes sa ta përcaktojë atë, atëherë, represioni duhet të kuptohet si një proces i ndarjes së vetes. Represioni dhe ndarja në këtë kuptim janë perspektiva të ndryshme të një operacioni identik.

Një aspekt i veçantë i vetes me plotësim të marrëdhënieve afektive, të qëllimta dhe reflektuese me një objekt të dhënë brenda psikes, është brendësia dhe fuqia e vetes në integrimin me të tërën.

Ky nënsistem funksional, i kristalizuar i vetes është ai që kthehet në një strukturë endopsikike nga represioni. Nëse veprimi nuk do të represohet ai do të vazhdonte të eksistonte brenda matricës të vetëdijshme, të integruar të vetes të pandarë nga forma dhe struktura endopsikike. Fairbairn na jep gjithashtu disa stadi të kalimit në këtë integrim: Së pari, diferencimi nga ajo që ai e dallonte nga nocioni i rremë i Frojdit që që mund të jenë subjekt i represionit si kujtime të pakënaqshme të patolerueshme ose impulse të fajit. Rreth këtij nocioni Fairbairn (1952) parashtroi idenë se ishin objektet e “këqija të patolerueshme” që ishin subjekt i represionit.

Më tej ai shkruan: *“Është e nevojshme të përshtasim idenë se represioni ushtrohet jo thjesht ndaj objekteve të brendësuar por, edhe ndaj strukturave të egos që kërkojnë marrëdhënie me këto objekte të brendshme. Duhet pra një ndarje e egos për të marrë represion”*⁴¹ (1952, fq.168). Fairbairn nënkuptonte një lidhje të brendshme mes represionit të objekteve dhe ndarjes së vetes në mënyrë që të përfshinte krejt nënsistemin e vetes, objektit dhe egos që shfaqen në çdo veprim të strukturës endopsikike.

⁴¹ 1952, fq.168

Ai e quajti procesin e vendosjes së këtyre strukturave si “skizoide” sepse ndarja dhe represionin me të cilat ato ndërtohen zvogëlon aftësinë e vetes për rritje dhe shprehje duke i bërë kësisoj patologjike⁴².

Vetja Libidiale dhe Antilibidiale kufizojnë diapazonin dhe thellësinë e funksionimit të vetëdijshëm ndaj Vetes Qendrore. Këto struktura endopsikike nxisin gjithnjë presionin e krijimit të përvojës të rastësishme.

Përvoja mbart dy karakteristika paracaktuese: është e përjetuar si “i/e keqe” ose e pakënaqshme dhe është përvojë e kërkuar nga vetja për mbijetesën e saj. Në këtë mënyrë Fairbairn argumentoi nocionin e kompulsionit të përsëritur.

Në çdo themel strukturor të vetes ekziston një ndërlidhje me disa aspekte negative që është jetësore për përcaktimin e vetes në nënsisteme. Ekzistenca e strukturave endopsikike është të vazhdojnë të jetojnë këto marrëdhënie “të këqija” duke kërkuar të shprehin dhe përjetuar veten sipas formësimeve të këtyre përvojave. Kështu, çdo strukturë endopsikike shpie në kërkimin e marrëdhënieve që do të shkojnë përkrah qasjeve neurotike të përvojave të hershme dhe distorcionit të marrëdhënieve të tashme që të mund të përjetohen sipas këtyre qasjeve dhe modeleve të shprehura të veprimit në marrëdhënie.

Teoria e Fairbairn përpos shpjegimeve frejdiane për zotërimin e instiktit të vdekjes na siguron edhe një qasje për ndjesinë e humbjes që ka përfshirë individin.

Humbja përfshin jo vetëm humbjen e elementit të objektit por edhe një ndjenjë të humbjes së vetes kësisoj të kënaqësisë Libidiale. Ekzistenca e Vetes Libidiale dhe Antilibidiale nën represione të vazhdueshme krijon më vonë natyrën e tyre patologjike.

Në qendër të këtij represioni dhe rezistencës që e pason është nocioni i atashimit.

Vetja zgjedh që t’i kristalizojë këto aspekte të sajat dhe ti mbajë ato nën kontroll për marrëdhëniet e ardhme. Kjo mbajtje e botës së brendshme si një sistem i mbyllur

⁴² Fillimisht nocioni është përdorur nga M.Klein për të përfaqësuar “pozicionin paranoid-skizoid”, kostelacionin e ndjesive të ankthit, mbrotjeve dhe marrëdhënieve të brendshme dhe të jashtme me objektet që janë karakteristike e jetës së të voglit dhe mund të vazhdojnë edhe në jetën e rritur. Ndarja nga objekti i dashurisë “nëna” dhe refuzimi i instiktive të vdekjes, krijojnë te i vogli një mungesë të ekuilibrit mes faktorëve mjedisore (që përfaqësohen nga nëna) dhe faktorëve konstitucionalë të vetë fëmijës. Është ky perceptim i Klein që u zgjerua më vonë në teorinë e Fairbairn. (M.Klein: “Envy and Gratitude and Other Works 1946-1963 -The writings of Melanie Klein” Vol. 3; “Notes on some Schizoid Mechanisms” 1946).

është ajo çka Fairbairn e përshkruan “*burimi më i madh i rezistencës*”⁴³ (1958).

Një marrëdhënie e vërtetë me një objekt të jashtëm është një marrëdhënie në sistem të hapur. Duke qenë në një sistem të mbyllur marrëdhëniet mund të formohet vetëm si transferencë e objektit brenda realitetit të brendshëm të vetvetes.

Ndarjet që krijojnë strukturat endopsikike janë të variueshme sipas shtrirjes dhe thellësisë, natyrës së marrëdhënies apo zhvillimit që kanë. Sa më të thella në jetën e individit të jenë ndarjet, aq më të shtrira dhe të represuara do të jenë vet-et e nëndhshme. Këto vete të nëndhshme të mbajtura përmes rezistencave krijojnë besimet patogjenet që paralajmërojnë individin për një rrezik potencial.

Efektet e tyre patologjike në Vetën Qendrore do të jenë shkatërrimtare; përvojat dhe shprehjet e kësaj veteje do të zvogëlohen si pasojë e veteve të nëndhshme në çdo sistem përfaqësues. Sa më e madhe të jetë pjesa e represuar e vetes, aq më pak do të jetë ajo e hapur dhe në ndërvëprim me botën. Jo vetëm sasia e përvojës dhe shprehjes së Vetës Qendrore zvogëlohet nga vetja e nëndhshme por, edhe cilësia e lidhjes me botën zvogëlohet.

Sa më e ashpër të jetë tendenca e përjetimit të botës së jashtme me vetet e nëndhshme aq më shumë idealizohet natyra e objekteve në lidhje me Vetën Qendrore.

Në këtë pikpamje objekti i Vetës Qendrore bëhet Objekti i Idealizuar pra, i gjithë kompleksiteti duhet të vihet në raport me përvojën e veteve të nëndhshme.

Në aspektin klinik të gjitha idealizimet janë të bazuara në mohimin e disa papërshtatshmërive të përjetuara.

Zhvillimi i shëndetshëm sipas Fairbairn nuk varet nga vendosja e këtyre strukturave endopsikike por nga diferencimi strukturor i brendshëm që si fenomen skizoid zvogëlon funksionimin e të gjithë qenieve njerëzore. Sikundër vetë Fairbairn (1952) na argumenton: “*Psikologjia mendohet se zgjidh veten në një studim të marrëdhënies të individit me objektet e tij, ndërsa, psikopatologjia mendohet se zgjidh veten ëëcifikisht në studimin e marrëdhënies të egos me objektet e vetë-brendësuar*” (fq.60)

⁴³ 1958

Tabela 0.1 Shkalla e Nivelit Konceptual për Përshkrimet e Vetes dhe Përfaqësimet e Objektivit *Burimi:Blatt et al.,1988*

1.Sensorimotor-Preoperacional (Pikavarazhi 1).	Personi përshkruhet parimisht në sajë të kënaqësisë ose frustacionit që përjeton. Individidi përcaktohet si një entitet i ndarë dhe i pavarur nga efekti i drejtpërdrejtë mbi kënaqësinë e subjektivit-objekt.
2. Konkret-Perceptual (Pikavarazhi 3)	Personi përshkruhet parimisht në terma konkrete dhe të atributeteve fizike. Fokusimi vendoset në aspektet e karakteristikave të jashtme fizike.
3. Ikonik (Pikavarazhi 5–7). a. Ikonik i Jashtëm (Pikavarazhi 5). b. Ikonik i Brendshëm (Pikavarazhi 7).	Përshkruhet parimisht veprimtaritë dhe funksionet e personit. Personi përshkruhet sipas attributeve të asaj që mendon, ndjen dhe vlerëson dhe jo në bazë të asaj që kryen. Ky përshkrim bazohet më tepër në dimensionet e brendshme psikologjike.
4. Konceptual (8-9)	Përshkrimi i personit përfshin një sërë nivelesh ku veprimtaritë dhe shfaqjet e jashtme integrohen me dimensionet e brendshme. Konfliktet zgjidhen në një sintezë të integruar, komplekse dhe koherente.

Tabela 0.2: 12 Shkallët e Përmbajtjes Tematike për Përshkrimin e Tjetrit të Rëndësishëm
Burimi: Blatt et al.,1988

Shkalla Përshkrimi

Afeksion	Shkalla ku personi përshkruhet si me shfaqje të ngrohtësisë dhe dashamirësisë.
Ambiciozi	Shkalla në të cilën përshkruhet personi si i frymëzuar ndaj fushave instrumentale dhe okupacionale për veten dhe të tjerët; me një dëshirë të madhe për arritje; si frymëzues, i motivuar ose trysnues ndaj vetes dhe të tjerëve.
Keqdashës–Dashamirës	Shkalla në të cilën qëllimet e një personi ndaj të tjerëve përshkruhen si me një dëshirë të sëmure e të rrezikshme dhe jo të mirësisë.
I ftohtë–I ngrohtë	Shkalla në të cilën stili afektiv i individit përshkruhet si jo emocionale dhe jo personale më tepër sesa dashamirëse dhe e ngrohtë.
Shkalla e përfshirjes konstruktive	Shkalla në të cilën ndërveprimet e personit me të tjerët përshkruhen si distante dhe të rezervuara.
Intelektuale	Shkalla në të cilën përpjekjet e personit mbi refleksionet,interesat,përdorimin e ineteresave dhe aftësive për mendime pozitive dhe vlerësim.

Gjykues	Shkalla në të cilën personi përshkruhet si me standarde shumë të lartë dhe jo një individ pranues dhe tolerant.
Ideali Negativ–Pozitiv	Shkalla në të cilën mund të përshkruhet dikush që adhurohet për cilësitë e individit.
Ushqyes	Shkalla në të cilën përshkruhet personi që jep përkujdesje dhe vëmendje pa vendosur kërkesa emocionale.
Ndëshkues	Shkalla në të cilën përshkruhet personi i abuzuar fizikisht ose emocionalisht dhe që shkakton dhimbje dhe vuajtje.
I suksesshëm	Shkalla në të cilën përshkruhet individi i kënaqur me arritjet e veta.
Fortësia (i fortë – i dobët)	Shkalla në të cilën përshkruhet individi efektiv,eficient dhe i aftë për t'i rezistuar trysnisë me një ndjenjë të ekuilibruar dhe konsistente të vetes.

Qëllimi kryesor i trajtimit psikoanalitik është të përmirësojë sintezën sa më të mirë të strukturave ku egoja origjinë është ndarë (Fairbairn, 1958; fq. 380). Ekziston ende një paqartësi në lidhje me brendësimin dhe përfaqësimin mendor në shkrimet e Fairbairn, paqartësi që ai e ka ndaj përdorimit të brendësimit në forma të ndryshme. Termi që Fairbairn e përkufizoi si tip të brendësimit përfundon me formimin e strukturave endopsikike të represuara të quajtura *brendësim strukturor*⁴⁴.

Objektet e mira nuk mund të brendësohen strukturalisht pasi nuk mund të represohen në strukturat endopsikike. Objekti i mirë nëse brendësohet, argumenton Fairbairn, është Objekti i Idealizuar i Vetes Qendrore që është një sistem në të cilin asnjë nga elementët nuk ndodhet në represion strukturor (Fairbairn, 1952).

⁴⁴ Teksa Melanie Klein e përkufizoi brendësimin si të objekteve të mira dhe të këqija, Fairbairn (1952, Kap.III, IV dhe VII) nuk ishte në një mendje me të dhe argumentoi se vetëm objektet e këqija mund të brendësoheshin. Ai shkruan se “është e vështirë gjetja e një motivi të përshtatshëm për brendësimin e objekteve që janë të kënaqshme dhe të mira” (Fairbairn, 1952 fq.93).



Figura 0.5. Narcizimi fillestar sipas Fairbairn dhe Kernberg

Procesi sipas të cilit asnjë objekt i mirë nuk mund të krijojë një strukturë të represuar të pandashme dhe të paformuar të strukturës endopsikike u quajt *brendësimi i pastrukturuar*. Qenia njerëzore ka nevojë që të mund të brendësojë aëktet e përvojës në botë që të mund të rritet dhe luftojë për veten. Për të kuptuar edhe më mirë pozicionin e Fairbairn për procesin e brendësimit të pastrukturuar duhet të kutojmë parimin sipas të cilit një proces i tillë nuk mund të shpjerë në represion. Vetja nuk represon ato fragmente të përvojës së vet që janë të mira sepse ato integrohen me veten. Brendësimi i pastrukturuar si *Weltansicht*⁴⁵ –e parë edhe nga mundësitë e panumërta sipas kategorive të përvojës së Kantit apo skemës morale të zhvillimit të Kohlberg⁴⁶ përfshin procesin e të mësuarit, kujtesës, organizimit dhe sintezës.

Edhe zhvillimi më i plotë i diferencimit të vetes-objekt nuk përfshin diferencimin strukturor të vetes por njohjen progresive të ndarjes të asaj veteje nga bota e jashtme me të cilën ndërvepron dhe organizimin e dijenisë për natyrën dhe potencialin e saj.

⁴⁵ Nga gjermanishtja, emri merr kuptimin e përgjithësuar të një pikëpamjeve specifike dhe interpretimin të realitetit si tërësi. Në kuptimin social, termi i referohet qendrimeve të mbajtura ndaj jetës dhe realitetit.

⁴⁶ Në teorinë e Kant, kategoritë janë karakteristika të shfaqjes së përgjithshme të objektit përpara se ato të përjetohen. Janë gjendjet e mundësisë së objektit në përgjithësi. Kant i quajti ato "predikate ontologjike". (Për më tepër referojuni i Kant "Sie sind Begriffe von einem Gegenstande überhaupt" 1787). Skemat e zhvillimit moral të L. Kohlberg përfaqësojnë një përshtatje të teorisë origjinë të J. Piaget. Arsytimi moral mbart gjashtë stadi të zhvillimit që i përgjigjen dilemave morale edhe ndaj paraprijësis. Këto stadi përfshijnë: I) Niveli i parë -Stadi para-konvencional (1. Orientimi ndaj bindjes dhe ndëshkimit; 2. Orientimi ndaj interesit të vetes); II) Niveli i dytë –Stadi konvencional (3. Dakortësia dhe konformiteti ndërpersonal; 4. Orientimi ndaj autoritetit dhe mbajtjes së rendit social;); III) Niveli i tretë-Stadi Post-kinvencional (5. Orientimi në kontratë sociale, 6. Parimet etike universale) [Kohlberg L.; 1981 "Essays on moral development"]




Figura 0.6 Përmbledhje e Sistemit Endopsikik të Fairbairn.

Në një argumentim tjetër mes teorisë së Klein dhe të Fairbairn ky i fundit shkruan: “Më duket se Melanie Klein nuk ka mundur kurrë të shpjegojë mjaftueshëm sesi fantazitë e objekteve të trupëzuara në mënyrë orale mund të lindin vendosjen e objekteve të brendshme si struktura endopsikike dhe kështu nuk mund të artikulohen si objekte të brendshme, pasi përndryshe do të qendrojnë thjesht trille të fantazisë”⁴⁷.

Nga një pozicion i tillë shihet qartë se brendësimi i pastrukturuar nuk vendos çdo “entitet” brenda vetes por, duken në një ndryshim të integritetit të vetes ose në krijimin e mendimit, kujtimit apo fantazisë brenda vetes. Një tjetër autor i rëndësishëm i psikanalizës që njohu rëndësinë e teorisë të Fairbairn është Otto Kernberg (1976-1980). Ai argumentoi se brendësimet dhe përfaqësimet psikike në të gjitha nivelet mbajnë në bazën e tyre elementin e vetes, elementin si objekt dhe marrëdhënien afektive e të qëllim të krijuar ndërmjet këtyre elementeve.

Posaçërisht për natyrën e brendësimit dhe përfaqësimit psikik Kernberg ka shkruar: “Të gjitha proceset e brendësimit të marrëdhënive me objektet i referohet brendësimit të pjesëve të gjendjes afektive, të përfaqësimit me objektin dhe vetë-përfaqësimit. Duke ndjekur hapat e Erikson.... mora në konsideratë introjeksionin, identifikimin dhe identitetin e egos si faktor progresiv të këtyre proceseve të brendësuar. Në rastin e introjeksionit, përfaqësimet e objektit dhe vetes nuk janë të diferencuara nga njëra-tjetra, afekti i tyre është primitiv, i fortë dhe i shpërndarë. Në rastin e identifikimit jo vetëm që ka një ndarje të mirë-vendosur mes përfaqësimeve të vetes dhe të objektit por, ka edhe një brendësim të afekteve të rolit të marrëdhënies, që nga njohja sociale e funksionit që po aktualizohet në ndërveprimin me veten-objekt. Gjendja afektive është më pak e fortë, më pak e shpërndarë dhe ëktrumi i diëzotave të afektit është i gjerë dhe i thellë... Identiteti i Egos mund të mendohet si integrim i rregullit të sipërm për identifikimet në një strukturë dinamike, të unifikuar”⁴⁸.

Shohim këtu një bashkëlidhje mes modelit të brendësimit të pastrukturuar të Fairbairn dhe konceptit të Kernberg për identitetin e egos. Të dy teoritë argumentojnë që ka një vazhdimësi të vetë përvojës dhe shprehjes që është e përfshirë në një

⁴⁷ 1952, fq.154

⁴⁸ 1976, fq.75

brendësim të tillë për të shtuar nivelet e sintezës dhe integritetit të egos.

Brendësimi psikik (introjeksioni) i Kernberg i referohet në fakt nivelit të funksionimit ku mos vazhdimësia dhe integriteti lidhen në forma patologjike të vetes. Këto forma shfaqen përmes ndarjes së vetes dhe strukturës së re të formuar. Vazhdimësia e këtyre introjeksioneve të hershme është rrjedhoja e fiksimit të disa marrëdhënieve të turbullta, të marrëdhënieve të hershme objektuale që lidhet me zhvillimin patologjik të vetë ndarjes⁴⁹.

Mënyra e brendësimit të Kernberg është e lidhur me brendësimin e pastrukturuar të Fairbairn.

Kernberg e përshkroi identifikimin normal si:

- 1) modifikim të pjesshëm të konceptit total të vetes nën ndikimin e përfaqësimeve të reja të vetes;
- 2) një nivel integrimi si të përfaqësimeve të vetes dhe objektit në një funksionim autonom të funksionimit të egos në formën e tipareve të karakterit;
- 3) nivel i riorganizimit të modeleve sjellore të individit nën ndikimin e strukturave të reja identifikuese.

Në këtë rast procesi i përfaqësimit të brendshëm vendoset në lidhje me Vetën Libidiale ose Antilibidiale dhe jo me Vetën Qendrore (Bërthamë).




Figura 0.7 Brendësimi i objektit të mirë dhe të keq sipas Fairbairn dhe Kernberg (1976-1980)

Rrjedhoja e fundit e procesit të identifikimit është karakteri patologjik. Sa më rixhide dhe neurotike të jenë tiparet e karakterit, aq më tepër do të tregojnë ato për një marrëdhënie të shkuar objektuale patologjike të brendësuar (konflikti Frojdian) që është

⁴⁹ 1976, fq.34; fq.48

bërë njësh me modelin e karakterit të individit. Teksa identifikime të tilla ndodhin nën ndikimet e strukturave endopsikike patologjike dhe mund të ndryshojnë natyrën e këtyre strukturave në rastet e përsëritjet, nuk kemi të bëjmë kurrësi me përforsim të modeleve por vetëm me mbajtjen e tyre.

Kernberg argumenton edhe se në format më të larta të brendësimit përfshihet një integritet më i mirë i vetes që jep kthjelltësi psikike (insight) në modelin strukturë. Në format e brendësimit po kështu përfshihen nivele të maturuara të strukturave të brendshme, të kuptimit metapsikologjik të vetes⁵⁰, zhvillimit e brendësimit, dinamikat e ndërveprimeve dhe zhvendosja drejt varësisë të maturuar për identifikimin e vetes-objekt. Zhvillimi i një veteje të maturuar është zgjedhur nga Fairbairn si pikënisje për të vëzhguar zhvillimin e vetes sipas niveleve të varësisë.

Veprimtaria njerëzore që merr kuptim në shprehjet më të larta lidhet me përfshirjen e saj në marrëdhënie me njerëzit realë të botës së jashtme a të botës imagjinare të brendshme.

Zhvillimi i shëndetshëm përfshin një mendim ndërvarësie me të tjerët e rëndësishëm sidomos me të dashurit e afërm. Në nivelin më të lartë të zhvillimit të varësisë mature, vihet re një ndërthurje e burimeve njerëzore.

Në qendër të nocionit të Fairbairn për varësinë fëmijërore është *identifikimi parësor* (1952).

Në identifikimin parësor, i vogli lidhet me një tjetër që ai/ajo nuk e përjeton si të ndarë nga vetja. Subjekti nuk është i dijshtëm që personi tjetër është i ndarë nga vetja dhe kështu ai pranon realitetin e të dy formave të nevojave: ekzistencën e një marrëdhënieje që ndodh dhe mospranimin e diferencimit vete-objekt. Fairbairn shton në këtë ndërveprim edhe idenë se lidhja e varësisë të voglit me statet e hershme mbarte disa karakteristika primitive:

- 1) lidhja nuk është e kushtëzuar;

⁵⁰ Metapsikologjia është një term i krijuar nga Frojdi dhe ndeshet për herë të parë në një letërkëmbim të tij me Eihelm Fliess. Në fillime termi ishte i përngjashëm me “metafizikën” ndërsa më 1915 termi mori gjerësinë kuptimore me të cilën kuptohet modeli psikik Frojdian e më pas ai neofrojdian sikundër teoria e Kernberg. Metapsikologjia i referohet koncepteve më abstrakte dhe teorike të psikanalizës. Ajo përbëhet nga një sërë ligjësisht, parimesh dhe konceptesh thelbësore që përshkruajnë funksionet e aparatit mendor në tre aëkte bazë :dinamike, topografike dhe ekonomike.

2) cilësia e nevojës është absolute –nëse nevojat e fëmijës nuk plotësohen, ai do të vdesë;

3) i vogli nuk ka dijeni për ndonjë kuptim ose zgjedhje për objektet dhe mosarritje e marrëdhënies në plotësimin e nevojave ka potenciale për vdekjen.

Procesi i maturitetit psikologjik në skemën e kalimit nga pjekuria fëmijërore në atë të rritur konsiston nga “braktisja e vazhdueshme e marrëdhënieve të identifikimit parësor në favor të marrëdhënieve me objektet e diferencuara”.

Fairbairn shkruan më tej “*Sa më mature të jetë një marrëdhënie, aq më pak do të karakterizohet nga marrëdhëniet e identifikimit parësor*”⁵¹. Ky proces është i vazhdueshëm dhe varion nga nivele të ndryshme të diferencimit me veten-objekt.

Në nivelet më fëmijore nuk ka një kuptim për ndarjen mes vetes dhe tjetrit pra, nuk kemi një dijeni për konceptin e vetes dhe tjetrit. Kur i vogli ka përvoja me botën, fillon të organizojë dhe të ketë dijeni për veten dhe tjetrin.

Nivelet e larta të diferencimit të vetes-tjetër kryejnë ndarjen e plotë fizike dhe psikologjike por edhe të niveleve të organizimit për kuptimin dhe natyrën e objekteve të diferencuara.

Gjendja e varësisë mature përfshin njohjen e ndarësisë së individëve edhe kur janë të përfshirë në marrëdhënie intime dhe ndërvarësie.

Ndarësia nuk nënkupton izolimin dhe vetminë por, njohjen e ekzistencës së vetes dhe të tjetrit si qendër e përvojës dhe qëllimit, ndjenjës dhe dëshirës, mendimit dhe synimit të vetes. Përfshihet këtu edhe marrja e dijenisë për individualitetin unik të tjetrit në një mënyrë që zvogëlon ekzistencën e marrëdhënies vete-tjetër. Ndërmjet stadi të varësisë fëmijërore dhe varësisë së rritur, Fairbairn ndërftoi edhe një stad që ai e quajti *pothuajse-i pavarur*. Kemi një përjasje të brendshme të individit për të luftuar lëvizjen nga stadi i varësisë fëmijërore në mënyra ende të lidhura me atë gjendje.

Stadi i pothuajse-pavarësisë ka gjasa të dështojë pasi mund të vendoset në situata të mbartura të konfliktit mes mbajtjes dhe braktisjes, shprehjes dhe frenimit etj.

⁵¹ 1952

Mënyra sesi vetja rritet nuk parashikohet nga procesi i diferencimit strukturor. Dija e rritjes së vetes të individizimi është pjesë e zhvillimit të integruar të tërësisë. Kur individi arrin nivele të larta të organizimit dhe interpretimit për përvojën e vet, ai funksionon me një shtim të nivelit të diferencimit vete-objekt që shkon nga operacionet e varësisë të fëmijës ndaj mënyrave më të maturuara të të rriturit.

Tërësia e përfaqësimit të teorive të marrëdhënies objektuale siguron forma mjaftueshmërisht të mira për brendësimin, strukturimin dhe zhvillimin “e psikopatologjisë të shëndetshme” nocion të cilin do ta përqafojë dhe konkretizojë ky punim.

2.2. Zhvillimi i Stileve të karakterit

Stilet e karakterit janë elementët kryesorë për të trajtuar individët me një organizim neurotik të egos pasi ato mund të funksionojnë dhe të jenë pjesëmarrës aktivë në trajtim. Stili i karakterit është i lidhur me nivelin e organizimit të egos te individët kufitarë ku nivelet e funksionimit përshtatës kërkojnë një fokus më të madh në krijimin e marrëdhënies terapeutike.

Funksionimi përshtatës dhe vendosja e marrëdhënies terapeutike janë variablet më kritike në studimin e individëve me formë të organizimit të egos psikotike, pasi stili i karakterit ndikon edhe në përmbajtjet simptomatike.

Kështu për shembull mund të kuptohet zhvillimi psikopatologjik mes fazës falike dhe deluzioneve të madhësisë. Për individët me organizim neurotik të egos, qëllimi është të merret kthjelltësi psikike (*insight*) për mekanizmat mbrojtëse të egos dhe mbajtjen e simptomave. Individi mund të zgjidhë konfliktet kur mekanizmat mbrojtëse të neutralizohen dhe supergoja të jetë më pak kufizuese.

Në rastin e individëve me problematika të fazave falike qëllimet përfshijnë mënyrën sesi shprehja dhe represioni emocional përdoren për të shmangur ndjenjat e fajit dhe të turpit.

Mos zgjidhja e efekshme e këtij konflikti mund të prodhojë individin me organizim të personalitetit kufitar në të ardhmen.

Nga një pozicion i tillë i Fairbairn mbi konfliktin shihet qartë se brendësimi i pastrukturuar nuk rrjedhon në vendosjen e çdo “entiteti” brenda vetes por, krijon një ndryshim në integrimin e vetes ose në krijimin e mendimit, kujtimit ose fantazisë së brendshme të vetes.

2.3 Organizimi strukturor i personalitetit

Në përpjekjet e tyre për të kuptuar identitetin njerëzor specialistët e fushave të psikologjisë dhe sociologjisë kanë përdorur qasje dhe pikëpamje të ndryshme.

Argumentet e tyre variojnë që nga pikëvështrimet mbi përfaqësimin krejtësisht intrapsikik dhe makro social (Gecas dhe Burke, 1995) e deri në identifikimin e proceseve dhe terminologjive të përngjashme (House, 1977).

Kërkimet për një status të qendrueshëm të identitetit përbëjnë një nga qasjet më të rëndësishme të studimit të personalitetit në tre dekadat e fundit (Marcia, 1966). Burimet e mëdha të identitetit variojnë në shkallët e rëndësisë: burimet më të prekshme shfaqen në sjelljet dhe përkatësitë e individit ndërsa burimet më pak të prekshme ndërtojnë tiparet e personalitetit tonë.

Patologjitë e ashpra të personalitetit jetojnë në një kontinuum me personalitetin normal.

Në të dyja rastet përfaqësuese shihet ruajtja e aftësisë për testimin e realitetit.

Teksa në personalitetin normal funksionaliteti është i përshtatur dhe fleksibël, në patologjitë e personalitetit kemi të bëjmë me ngurtësi dhe keqpërshtatje. Tiparet tona të personalitetit janë pjesërisht të krijuara nga mbrojtjet që ne përdorim në mënyrë të pavetëdijshme automatike dhe në mënyrë të përsëritur e në rrethana të ndryshme. Fleksibiliteti dhe funksioni përshtatës i personalitetit normal pasqyrojnë edhe natyrën fleksibël të operacioneve mbrojtëse të personalitetit të shëndetshëm dhe të maturuar.

Ndërsa rixhidityeti që karakterizon nivelet e personalitetit patolgjik pasqyron mos përfshirjen e mekanizmave dhe operacioneve mbrojtëse. Individët me personalitet patolgjik mbështeten në mekanizmat mbrojtëse të represionit dhe të ndarjes (distorcionit të imazhit në përfaqësimet e tyre mendore) çka përbëjnë karakteristikat bazë të “nivelet neurotik” të personalitetit të trajtuara në këtë punim.

Është pikërisht qendrueshmëria relative dhe jo fleksibiliteti a mbrojtjet neurotike që kur mvishen me procesin e zhvillimit të identitetit krijojnë shtresën mbajtëse të rixhiditetit të personalitetit patologjik.

Në format e patologjive më të rënda të personalitetit siç ndeshet në argumentimin e Kernberg⁵²për organizimin e personalitetit borderline “rixhiditeti i personalitetit shihet në rastin e identitetit patogjen i karakterizuar nga struktura dhe tipare të personalitetit keqpërshtatëse, kontradiktore, të paqëndrueshme dhe shpesh të papërshtatura shoqërisht. Në patologjitë e personalitetit tiparet keqpërshtatëse mund të shfaqen ose si frenuese të sjelljes normale [strukturë frenuese të sjelljes] ose si teprim i disa sjelljeve [strukturë reaktive sjellore]” (1977).

Në shumë individë këto struktura janë të pranishme të dyja.

Në rastin e tipareve frenuese të personalitetit vihen re mangësi të strukturave sjellore që mund të jenë të përshtatshme për situata të caktuara. Në tiparet e personalitetit reaktiv,për shembull,ndeshemi me praninë e strukturave sjellore që nuk janë domosdoshmërisht të nevojshme për situatën ku ndodhin.

Për të kuptuar më mirë funksionalitetin e tiparit frenues dhe reaktiv mund të marrim shembullin e liderit mësues që në tiparet frenuese mund të jetë krijues në aëektin profesional por i tërhequr dhe pasiv në krijimin e marrëdhënieve të tij me nxënësit në stilin e lidërshipt transformues.

Le të jetë kjo pika 0 e shembullit tonë. Në situatat e reaktivitetit po i njëjti mësues mund të shfaqet në një natyrë kontrolluese mbi gjithçka dhe të gjithë.

Ky individ do të përjetojë gjendje të ankthit dhe shqetësimeve në pjesën më të madhe të kohës dhe mund të habitet kur nxënësit me të cilët deri pak më parë mbante një sjellje të ndryshme do të sillen si të tejashtëzuar ndaj dëshirës së tij për kontroll. Konflikti lind në momentin kur ky lider kërkon t'i kthehet situatës së mëparshme por e ka të pamundur të kthehet në pikën 0.

⁵² The structural diagnosis of borderline personality organisation.

Tiparet e personalitetit patologjik frenues dhe reaktiv mund të zhbëjnë intensitetin e tyre përmes sublimimit⁵³ tipar specifik i personalitetit normal. Në këtë proces të mbrojtjes konfliktet motivacionale drejtohen në formë fleksibël, të përshtatme dhe konstruktive në zonat e funksionalitetit jo konfliktual.

Në studimin tonë një lider mësues me personalitet normal do të zhvillojë konfliktin bashkë me ndjesitë e agresionit e konkurrencës duke mbajtur një qëndrim asertiv, efektiv dhe të kujdesshëm⁵⁴.

Ky individ mund të marrë admirimin e të tjerëve dhe të shihet si dikush që do të jetë i suksesshëm dhe ku mund të mbështeten të tjerët. Në situatat kur mund të jetë e papërshtatme sjellja asertive, për një personalitet normal do të ishte e zakonshme që të kontrolloheshin dëshirat dhe të modifikoheshin sjellja⁵⁵.

Le të shohim më poshtë të përmbledhura disa forma të trajtesës dinamike të zhvillimit psikik me tendencë neurotike, kufitare dhe psikotike të egos sipas stileve të karakterit të individit nga studiues të ndryshëm.

Tabela 0.3 Plan trajtesë për zhvillimin e nivelit neurotik të egos Burimi: F. Trimboli dhe K. L. Farr (2000)⁵⁶.

Stili i karakterit	Aspektet dinamike	Aspektet e trajtesës
Të gjithë stilet e karakterit	Ndalimi i superegos për impulset e idit parandalon ankthin por, gjithashtu forcon mbrojtjet e egos dhe shfaq simptomat.	Neutralizimi i mbrojtjeve të egos dhe reduktimi i pengesave nga superego; kuptimi sesi mbahen simptomat dhe krijimi i distancës ndërpersonale; zgjidhje e konfliktit neurotik.

⁵³ Si mekanizëm mbrojtës, sublimi i referohet procesit që ndryshon rrjedhën e energjisë instiktive nga synimi për marrjen e kënaqësisë seksuale në rritjen dhe nxitjen e krijtarisë kulturore, transformimi i objektit libidinal në ego libidinale para se të drejtohet në qëllime të tjera (Frojd, 1923; Marrë nga "International Dictionary of Psychoanalysis", fq. 1678). Në këtë kuptim, mund të përdoret forca e sublimimit te individët me personalitet patologjik, për të zhbërë energjinë e tyre agresive dhe negative në dicka të vlefshme. Ky është edhe koncepti gjerman mbi *ergoterapinë*.

⁵⁴ Tiparet kryesore të një personaliteti autentik. Kemi të bëjmë në këtë situatë me zhvillimin e konfliktit sipas terminologjisë së psikanalizës dhe jo në kuptimin e përgjithshëm social. Me fjalë të tjera, një lider mësues (individ) mund të përshfaqë konflikt dinamike psikike nëse tiparet e caktuara të botës psikike a personalitetit (reaktiviteti, frenimi etj.) "ndeshen" me forcat e mbajtjes së kontrollit ose mbrojtjet e pavetëdijshme. Për të zgjidhur pjesën më të madhe të këtyre konflikteve që zhvillohen në formë të pavetëdijshme në jetën e përditshme ne mund të përdorim mekanizmin e sublimimit, që në teorinë e Frojdit i përkon "një tipologjie të maturuar të mekanizmit mbrojtës, ku impulset e padëshiruara a të pa pranuar sociale, shndërrohen në sjellje a veprime të pranuar shoqërisht". Në tendencat patogjene ky proces dinamik shpëputet dhe nevoja për të shndërruar një impuls të papranuar në dicka të vlefshme shtypet (represohet) dhe në vazhdimin e kohës kthehet në cikël disfunksional që përforcon tendencën neurotike të shfaqur dhe pamundësinë për të kontrolluar impulsin.

⁵⁵ Kernberg (1999) analizë e shqyrtuar në "Le relazioni nei gruppi. Ideologia, conflitto e leadership".

⁵⁶ A psychodynamic guide for essential treatment planning. *Psychoanalytic Psychology*, 17, 351, 2000. American Psychological Association

Me fiksism oral	Individi fokusohet te vetja: ka mungesë të empatisë, depresion ose varësi.	Motivimi i empatisë; trajtim i pasivitetit dhe frikës dhe reduktimi i forcës energjike të agresionit ndaj burimeve të tjera jo të lidhura me marrjen e kënaqësisë.
Me fiksism anal	Kontrolli/Dominanca/Agresioni; Çrregullim Obsesiv-Kompulsiv.	Vënie përballë e intelektualizimit/ngritja e dyshimeve dhe ekëlorimi/kuptim i gjendjes emocionale; kuptimi i pasivitetit dhe mbrojtja nga ankthi.
Me fiksism falik(Edipial)	Ndjesi dhe veprime të konkurrencës/xhelozii; ndjesi të fajit/turpit; konversion histerik; fobi	Kuptimi i përdorimit të mbrojtjeve emocionale; ekëlorimi i dëshirave dhe fajit të represuar/turp për ndjesitë me sfond seksual

Tabela 0.4 Plan trajtesë për faktorët ndikues në zhvillimin e egos borderline. *Burimi* : F. Trimboli dhe K. L. Farr (2000)

Niveli i Funksionimit	Stili i karakterit	
Oral	Anal	Falik
Funksionimi përshtatës (individë që kanë nevoja terapeutike; për tu trajtuar)	Qëllime për të gjitha stilet; zhvillimi i egos përmes nxitjes së qendrueshmërisë së objektit dhe aftësive menaxhuese; mbajtja e qendrueshmërisë dhe kufijve përballja me çarjen; mbështetje për të gjitha nivelet e mbrojtjeve e funksioneve të larta ekzaminimi i paraprijësve dhe pasojave të veprimit; dhënia e alternativave.	
Funksionimi pjesërisht i dëmtuar (individi funksionon në mënyrë të përshtatur por, është i stresuar)	Qëllime për të gjitha stilet; kihet kujdes me intensifikimin e transferencës dhe agresionin tendencë ndaj vetë shkatërrimit	Qëllime për të gjitha stilet; kihet kujdes me idealizimin si mënyra e parë e rezistencës.
Funksionimi tërësisht i dëmtuar (individi mund të trajtohet si psikotik)	Qëllime për të gjitha stilet përballimi i të gjitha problemave dhe paqendrueshmërive; nevojitet mbrojtje e individit dhe shoqërisë	Qëllime për të gjitha; stilet; parapi dhe zgjidh; idealizimin.

Tabela 0.5 Plan trajtesë për zhvillimin e nivelit psikotik të egos. *Burimi* :F. Trimboli dhe K. L. Farr (2000)

Funksionimi Përshtatës	Aspektet dinamike	Aspektet e trajtesës
Të gjitha stilet (stili është pak i rëndësishëm)	Identiteti i shpërndarë; tolerancë ndaj ankthit/kontroll të impulsit; çarje	Stabilizim, mbështetje, menaxhim rasti, akseset për mjekim, fokusim në tiparet e dobësimit të egos
Niveli i përshtatur	Rrallë kërkon trajtim; i mbrojtur, i çuditshëm, rrezik për dekomensim	Qendrim mbështetës/rezistencë ndaj eksplorimit dhe vetë hapjes; kuptim i stresorëve situacionalë/mbështetje sociale/emocione të shprehura në familje.
Pjesërisht i dëmtuar	Dëmtim i testimit me realitetit; ruajtje paranoide dhe dyshime të tepëruara	Përforcim i funksioneve mbrojtëse; vlerësimi i nevojës për të ndryshuar mjedisin e punës dhe shtëpisë; vetë hapje e mendimeve dhe ndjesive projektive dhe të transferencës nga terapeuti.
Tërësisht i dëmtuar	Testim i dëmtuar i realitetit, anihilacion, skizofreni, paranojë ose bipolaitet	Hospitalizim dhe mjekim, trajtim dhe mbështetje përmes hoëitalizmit.

Siç mund të vërehet nga tabelat e mësipërme çdo stil i karakterit i përgjigjet ndikimeve dinamike të lidhura me karakteristikat kryesore të tendencës për psikopatologji, mekanizmave të përdorur në përshtatje dhe formës së rekomanduar për trajtesë. Aspektet e përshkruar dinamike lidhen pikërisht me elementët me tendencë patogjene që ndikojnë dhe ndikohen nga stilet e karakterit të individit. Kështu për shembull, nëse një lider mësues në shkollë do të kishte një tendencë për sjellje psikopatologjike kufitare, ai ajo mund të përshfaqë një sjellje shumë lavdëruese, ndihmuese apo adhuruese ndaj liderit drejtues, e po në të njëjtën kohë mund të mbartë të fshehura dëshira për ta përçmuar, përçunduar apo zhvlerësuar fare atë në prani të të tjerëve. Niveli i funksionimit është pjesërisht i dëmtuar (tabela 2.4) dhe stili i karakterit të këtij lideri do të vlerësohet si falik. Në rastet kur tendenca për psikopatologji është shndërruar në patologji të mirëfillite, sikundër në rastet e një funksionimi plotësisht të dëmtuar e psikotik të egos (tabela 2.5) aspektet dinamike janë vetëm Antilibidiniale, energjia është shndërruar në vetë-shkatërruese, individi shfaq një nivel të dëmtuar të funksioneve përshtatëse dhe për pasojë tendenca patogjene është shndërruar në patologji të mirëfilltë.

Format e trajtimit në këto raste mund të parashtrojnë edhe hoëitalizimin e mjekimit psikofarmakologjik të ndjekur nga mjeku.

Autorët McWilliams (2011), Gordon (2013), Kernberg dhe Caligor (2005) kanë parashtruar një matricë dinamike të elementëve të Organizmit të Personalitetit sipas të cilës shtatë elementët e OP dhe nën-elementët e tyre përbërës mund të përfshijnë :

- 1) Integritetin, me të cilën nënkuptohet aftësia për të parë veten në qendrueshmëri, kompleksitet dhe përshtatshmëri.
- 2) Marrëdhëniet me Objektin ose aftësia për të ruajtur marrëdhënie të afërta, të qendrueshme dhe të kënaqshme me të tjerët ose tjetrin e rëndësishëm.
- 3) Tolerancën ndaj Afektit, ose aftësia për të përjetuar tërësinë e emocioneve të lidhura me zhvillimin e individit.
- 4) Rregullimi i Afektit, ose fleksibiliteti në përdorimin e strategjive përballuese.
- 5) Integrimi i Superegos, ose aftësia për të përdorur një ndjeshmëri morale dhe të

maturuar.

- 6) Testimi i Aftësisë së kuptimit të Realitetit, ose aftësa për të vlerësuar perceptimet e realitetit.
- 7) Resilienca e Egos ose aftësia për të reaguar dhe rimarrë veten nga burimet e stresit.

Të gjithë këta nën-elementë të matricës shërbejnë për të vlerësuar tiparet e tendencës për patologji psikike të individit dhe zhvilluar Prototipin Psikodinamik të tij. Në rastet e tendencës për psikopatologji këta elemente shfaqen në të përkundërtën e tyre duke përforcuar Antilibidon. Për shembull, një lider mësues me nivel të zhvillimit neurotik të egos dhe stil të karakterit me fiksion falik (tabela 2.3) do të shfaqet si një individ me një ndjesi konkurrence të fortë me drejtuesin e shkollës së vet me të cilin mund të ketë marrëdhënie shoqërore jashtë shkollës. Për këtë ndjesi të fortë të zilisë dhe konkurrencës me mikun e tij ky individ mund të mbartë edhe ndjesi të turpit ose të fajit të cilat mundohet ti mbajë sa më shumë në kontroll dhe ti shtypë. Kur situata mund të sjellë një ndryshim të dinamizmit të jashtëm, këto ndjesi të turpit dhe të fajit do të duhej të ishin të ekuilibruara dhe të dijshme për rolin e individit si mësues dhe jo si drejtues. Por, kur situata mbetet e pandryshuar në dinamizmin e vet, atëherë ajo pashmangshmërisht e përforcon mos lidhjen e realitetit të individit me rolin e vet dhe kështu edhe me tjetrin. Ky lider mësues mund të shfaqet gjatë gjithë kohës fjalaman, me tendencën për të kërkuar vëmendjen dhe përçmues ndaj drejtuesit (të cilin e ka mik). Nën-elementi i Integritetit në këtë rast do të jetë Çintegrimi dhe energjia dinamike (Prototipi i Personalitetit) me nivel të zhvillimit neurotik të Egos.

Argumentat mbështetëse mbi Organizimin e Personalitetit shihen fillimisht në bazën e mendimeve të Frojdit cili dallonte tipet e hershme “primitive ose predipiale” dhe tipet “më të integruara edipiale” të psikopatologjisë.

Në varësi të tipeve të psikopatologjisë janë të dallueshme gjithashtu edhe nivele të ndryshme të zhvillimit të psikopatologjisë. Kernberg, Caligor (2005) dhe McEilliams (1994-2011) në studimet e tyre metanalitike kanë instrumentalizuar këto dallime në literaturën psikanalitike dhe kanë parashtruar disa tipare bërthamë në përcaktimin e niveleve të Organizimit të Personalitetit (Caligor dhe Clarkin, 2010; Kernberg dhe

Tabela 0.6 Përcaktimi i niveleve të Organizimit të Personalitetit *Burimi*:Përshtatur sipas Kernberg dhe Caligor(2005), Nancy McWilliams (2011)

1	Niveli Integritetit të Personalitetit	Problematikë e ashpër	Konfuzion i dallueshëm identiteti	Relativisht i Integruar
2	Niveli mbizotërues i mekan. mbrojtëse,që përballen me stresorët dhe konfliktet e jashtme dhe të brendshme	Mekanizma mbrojtëse primitive (projeksion, çarje)	Mekanizma të hershëm mbrojtëse,(çarje, identifikim projektiv)	Mekan. mbrojtëse dytësore (represion racionalizim, formim reagimi)
3	Aftësia për të Testuar Realitetin	Mund të jetë shumë i ndikuar (për shkak të halucinacioneve o deluzioneve)	Relativisht e paprekur,mund të shfaqen problematika të përkohshme vecanërisht në situata shumë nxitëse	E paprekur
4	Cilësia e Marrëdhënieve me Objektivin dhe përfaqësimeve mendore të vetes dhe tjetrit.	Problematika të mëdha në mbajtjen e marrëdhënieve me objektet dhe disintegrimi i vetes dhe përfaqësimit të objekteve	Marrëdhënie problematike ndërpersonale,shpesh të shoqëruara nga kaosi,idealizimi,denigrimi ,paqendrueshmëria e vetes dhe përfaqësimit të të tjerëve	Marrëdh. mund të karakterizohen nga konfliktet për autonomi, dashurisë dhe agresivitetit
5	Aftësia për vetë vëzhgim	Problematika të ashpra	Shpesh me problematika të ashpra	Relativisht e paprekur
6	Natyrë e konflikteve kryesore	Ekzistenciale (jeta, vdekja, identiteti)	Të ndikuara nga marrëdhëniet	Konfliktet mbi autonominë si ndjesi të fajit të turpër marrësh. ndërpersonale
7	Potencialët e transferencës dhe kundërtransferencës të subjektit (nëse zhvillojnë ndjesitë eforta të transferencës dhe kundërtransferencës)	Shumë e fortë,shpesh pozitive por edhe kundërtransferenciale	Të fuqishme,të karakterizuara nga ndjesitë e idealizimit dhe denigrimit.	Më të mprehta

Këto tipare përcaktojnë një kontinuum të patologjive të personalitetit që varion nga:

- 1) Niveli i Organizimit Neurotik, që karakterizohet nga nivele relativisht të larta të integritetit të identitetit,aftësia e pa ndikuar e testimit të realitetit dhe përdorimi i shtuar i mekanizmave mbrojtëse;
- 2) Niveli i Organizimit Kufitar, i karakterizuar nga një konfuzion në identitet, aftësi relativisht e paprekur për testimin e realitetit dhe përdorimin e mekanizmave mbrojtëse primitive;
- 3) Niveli i Organizimit Psikotik, i karakterizuar nga një konfuzion i dukshëm i identitetit,dëmtim në aftësinë e testimit të realitetit dhe përdorimi i mekanizmave mbrojtëse primitive.

Niveli i Organizimit të Personalitetit që autorët e argumentojnë si pasqyrues të

ashpërsisë së patologjive dhe tendencës për patologji të personalitetit, konsiderohet gjithashtu edhe një parashikues i rëndësishëm i prognozës dhe reagimit ndaj trajtimit⁵⁷.

Studime të tjera në këtë linjë nga Koelen dhe bashkëpunëtorët e tij (Koelen et al., 2012) tregojnë se niveli i Organizimit të Personalitetit lidhet me rezultatet e trajtimit dhe mund të jetë parashikuesi i vetëm i rëndësishëm si në dekursin e patologjisë ashtu edhe në reagimin ndaj trajtimit. Një dallim tjetër ndërmjet qasjes së nivelit të Organizimit të Personalitetit dhe qasjeve diagnostike të DSM-së dhe ICD-së është se në këto të fundit nuk qartësohet një lidhje shkakësore mes strukturës së personalitetit dhe çrregullimeve të personalitetit.

McWilliams (2011) ka arsyetuar se akset përshkruese dhe niveli i OP janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe si të tilla çdo formë e patologjive të personalitetit mund të shfaqet në nivele të ndryshme të OP. Kështu për shembull, një personalitet histerik mund të shfaqet në nivele neurotike, psikotike a kufitare (borderline), Në të njëjtën linjë studimet kanë treguar se Niveli Kufitar përfshin një kategori më të gjerë të problematikave të personalitetit sesa Çrregullimi i Personalitetit Kufitar në DSM⁵⁸.

Studimet kanë evidentuar se kjo formë diagnostike e vlerësimit të OP mund të nxisë individët me diagnoza të ndryshme të ketë rezultate të mira të trajtimit⁵⁹.

Krahas sistemeve diagnostike të DSM dhe ICD,PDM dhe PDC këto studime njohin ngjashmëri edhe me “Diagnostikën Psikodinamike të Operacionalizuar” por, OPD⁶⁰ është e kufizuar në vlefshmërinë e Aksit 1 dhe 4 të saj (Doering et al.,2014)

Në Manualin e Operacionalizimit Psikodinamik-2 (OPD-2)(fq.119) përshkruhen katër dimensionet të strukturës që diferencojnë marrëdhënien me Vetën dhe me të

⁵⁷ Caligor dhe Clarkin, 2010

⁵⁸ Fonagy dhe Luyten, 2016;Shedler ,Westen Bender et al., 2011; Lowyck, Luyten, Verhaest, Vandeneede, dhe Vermote, 2013

⁵⁹ Huprich dhe Greenberg, 2003; Koelen et al., 2012

⁶⁰ versioni i fundit i botuar më 2013 dhe studimet e bashkëlidhura kanë treguar se struktura e organizimit të PDM është më gjithëpërfshirëse (PDM Task Force, 2006)ndërsa OPD është mbështetur nga studime kontrolli dhe monitoruese mbi analizat e saj të rregullimit dhe kuptimit të simptomave (Cierpka, Grande,Rudolf, von der Tann dhe Stasch, 2007; OPD Task Force, 2006). OPD përbëhet nga pesë boshte diagnostike :1) përvoja e sëmundjes dhe motivimi për përfshirje në trajtim ; 2) marrëdhëniet ndërpersonale; 3) konfliktet mendore; 4) niveli strukturor i Personalitetit dhe 5) çrregullimet mendore dhe psikosomatike.Këto pesë boshte mund të vlerësohen nga klinicisti në varësi të të dhënave të grumbulluara nga intervistat klinike 1-2 orë dhe një raporti të detajuar përshkrues dhe kontekstual.

tjerët (objektet):

- Perceptimi për veten dhe perceptimi për objektin:
Aftësi vetëreflektuese
Aftësi për të perceptuar të tjerët në mënyrë realiste dhe si tërësi
- Rregullimi i Vetes dhe marrëdhënieve:
Aftësi për të rregulluar impulse, afektet dhe vetëvlerësimin e vetes
Aftësi për të rregulluar marrëdhënien me tjetrin.
- Komunikimi emocional i brendshëm dhe komunikimi me botën e jashtme:
Aftësi për të komunikuar me botën personale përmes afekteve dhe fantazive
Aftësi për të komunikuar me të tjerët.
- Atashimi i brendshëm dhe marrëdhëniet e jashtme:
Aftësi për të marrë të mira nga objektet personale për vetë rregullimin
Aftësi për të krijuar atashime dhe për tu ndarë.

Ndryshe nga studiuesit e linjës së parë psikodinamike një tjetër autor ka parashtruar një Model të Dy-Polariteteve⁶¹ të OP, model i cili bashkërendon qasjet e diagnozës dhe trajtimit në lëmin e klasifikimit psikodinamik. Në vazhden e qasjeve teorike për çrregullimet e personalitetit, dëmtimin në nivelet e vetes dhe të tjetrit, Blatt ka argumentuar si në këndvështrimin përshkrues edhe në pikëvështrimin teorik se problematikat e personalitetit karakterizohen para së gjithash nga vështërsitë në marrëdhënie⁶² dhe problematikat me përcaktimin e vetes⁶³. Këto problematika vendosen në një kontinuum dy-dimensional, të cilin Blatt e trajtoi si Model të Dy-Polaritetit (Livesley, 2008; Skodol dhe Bender, 2009).

Modeli i propozuar nga Blatt në vitin 2008 vë në pah se marrëdhënia dhe përcaktimi i vetes janë dy dimensionet thelbësore psikologjike që krijojnë matricën teorike për:

- a) kuptimin e proceseve të zhvillimit të personalitetit;

⁶¹ Blatt, 2008; Blatt dhe Luyten, 2010; Blatt dhe Shichman, 1983

⁶² *atashim* sipas termit të përdorur nga Blatt

⁶³ këtu identitetit të vetes

- b) shumëllojshmërinë e organizimit të personalitetit normal;
- c) konceptet e krijimit të psikopatologjisë;
- d) integrimin e mekanizmave të veprimit terapeutik.

Funksionimi i mirë i personalitetit për Blatt (2008) përfshin ekuilibrimin e zhvillimit të marrëdhënies ndërpersonale dhe përcaktimit të vetes. Andaj, nivelet e maturuara të marrëdhënies⁶⁴ lehtësojnë zhvillimin e qendrueshmërisë së identitetit, autonomisë dhe kuptimit të vetes që nga ana e tyre ndikojnë në marrëdhëniet ndërpersonale të integruara. Gjatë zhvillimit, përvojat traumatike dhe predispozita biologjike mund të krijojnë distorcione të linjës së zhvillimit të individit dhe neglizhimin e marrëdhënies me tjetrin.⁶⁵

Shfaqja e formave të ndryshme të psikopatologjisë nuk janë entitete të qendrueshme të shkaktuara nga mangësitë në zhvillim por kostelacione dinamike të konfliktit dhe mekanizmave mbrojtëse që tentojnë të ruajnë balancën (geshtaltin) mes marrëdhënies dhe përcaktimit të vetes.

Dobia klinike e Modelit Dy-polar mbështetet nga të dhënat se ai (modeli) shpjegon lidhjen e komorbiditetit mes “çrregullimeve të simptomës” me “çrregullimet e personalitetit”⁶⁶.

Studimet kanë treguar një korrelacion të fortë mes keqpërshtatjes së elementit të marrëdhënies dhe përcaktimit të vetes në Depresion (Blatt, 2004; Luyten dhe Blatt, 2012), Çrregullimet e të ngrënit (Boone, Claes, dhe Luyten, 2014; Thompson-Brenner et al., 2008), Abuzimin me substancat (Blatt, Rounsaville, Eyre, dhe Wilber, 1984; Blatt dhe Shichman, 1983; Fonagy dhe Luyten, 2016), Çrregullimin e Stresit Postraumatik (Cox, MacPherson, Enns dhe McEilliams, 2004; Gargurevich, Luyten dhe Corveleyn, 2008), Çrregullimet e Qendrimin dhe të Sjelljes (Blatt dhe Shichman, 1983) dhe të Çrregullimeve funksionale somatike (Luyten et al., 2012)

⁶⁴ nënkupto marrëdhënie me subjekt-objektin tjetër

⁶⁵ Kemi të bëjmë këtu me një formë të zhvillimit simbiotik të marrëdhënies së qenies me një tjetër të rëndësishëm. Ndryshimi i linjës së zhvillimit të njëres qenie sjell në mënyrë të drejtpërdrejtë prishjen e ekuilibrit të marrëdhënies me qenien e dytë simbiozë, që nga ana e vet prish ekuilibrin me një qenie tjetër në linjë e kështu me radhë, sipas parimit energjitik të lidhjes së seri. Energjia e zhbërë e qenies së parë, Ego qendrore, tndon ose frustron qenien e dytë me të e në vazhdimësi derisa lidhja përfundimisht të shpëputet. Ky model konkretizon parimin e autenticitetit të Desein dhe vlerëson krijimin e premisë së sjelljes tendencë sipas nivelit të organizimit të personalitetit.

⁶⁶ Blatt, 2008; Blatt dhe Luyten, 2009

përpos tipologjisë së Çrregullimeve të Personalitetit dhe Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse.

Nëse i referohemi qasjes së Prototipit të përshkruar në këtë studim problematikat psikopatologjike mund të mendohen si *Prototype* në modelin dy dimensional. Prototipi i çdo individi në nivele të ndryshme të zhvillimit (Blatt dhe Shichman, 1983; McWilliams, 1994) pasqyron mënyra unike (prototipe) të zgjidhjes së ekuilibrit të marrëdhënies dhe përcaktimit të vetes që shkojnë nga “*funksionimi i personalitetit normal*” deri te “*problematikat e plota dhe nivelet e çrregullimeve të personalitetit*”.

Prototipet e personalitetit përbëhen nga struktura hierarkike shumë dimensionale dhe përfaqësojnë një tërësi më të plotë përshkruesish sesa përcaktuesit e thjeshtë të frikës, ankthit, dëshpërimit etj. Prototipet janë tipologji abstrakte pasi ato nuk përbëjnë kategori specifike. Numri i formave të prototipit të zgjidhjes së konfliktit që mund të përdorë individi mund të jetë i kufizuar. Kufijtë ndërmjet prototipit janë të kalueshëm çka e lejon individin të përdorë tipare nga prototipe të ndryshme.

Në mjedisin klinik, spektrumi i prototipeve përbërës të një personaliteti mund të ndikojë zhvillimin e personalitetit në formën e ndërveprimit sinergjik të përvojave të marrëdhënies dhe përcaktimit të vetes, të përvojave të afërsisë dhe ndarjes, të ngjashmërive dhe papërshtatshmërive dhe forcimit të këtyre ndërveprime sipas parimit “zinxhir” (Safran, Muran dhe Eubanks-Carter, 2011; Safran, Muran, Samstag dhe Steven, 2002).⁶⁷

Termi “*marrëdhënie me objektin*” shfaqet për herë të parë në një shkrim të Karl Abraham më 1924. Gjykimi i Fairbairn se impulset e hershme foshnjërore janë “*kërkuese të objektit*” dhe jo “*marrëse të kënaqësisë*” mbështetet edhe në faktin se egoja mund të zhvillohet vetëm përmes marrëdhënieve të kënaqshme me objektin.

Vetëm nëse egoja është e “fragmentarizuar” dhe patologjike, subjekti i vogël nxitet drejt kërkimit të kënaqësisë e jo të marrëdhënies. Fairbairn arsyetoi se qoftë

⁶⁷ Në teorinë analitike të Jung, i referohet procesit të zinxhirit të “nxjerrjes” në sipërfaqe të mendimeve, emocioneve a sjelljeve të pavetëdijshme të individit. Kështu për shembull, nëse përmes analizës së një emocioni të pavetëdijshëm të një lideri mbi “ndjenjën e kënaqësisë nga lëvdatat e të tjerëve” psikologjikisht mund të marrim të dhëna mbi “mendimet dhe veprimet që shoqërojnë këtë emocion”.

fëmijë, qoftë i rritur, individi preferon më tepër të ketë marrëdhënie qoftë kjo edhe e dhimbshme. Një konkretizim i mirë i modelit të Fairbairn ndodhet te sjellja e fëmijëve të abuzuar, çka është parë edhe në mjediset arsimore në Shqipëri. Sipas parimit të kënaqësisë fëmijët nuk duhet të atashohen me abuzuesit e tyre. Në fakt, në studimet e tij shkencore Fairbairn (1954) por edhe të dhënat empirike kanë treguar se fëmijët atashohen shumë më tepër me abuzuesit e tyre sesa me personat që përkujdesen për ta. Këta tregues të formimit të personalitetit të njeriut si pasojë e figurave të hershme atashuese, e kthejnë dhunën në një cikël të përsëritur të përvojave traumatike të individit të rritur te pasardhësit e tjerë të vegjël.

Këto marrëdhënie me objektin përshtaten në formën e objekteve të “brendësuar” ku subjekti bën pjesë të psikes së tij imazhet e kujdestarëve që kthehen në pikënisje për të gjitha marrëdhëniet e mëtejshme. Ndryshe nga teoria Frojdiane mbi marrëdhëniet me objektin e cila trajton se fëmija brendëson imazhin e prindin për të kontrolluar ndrydhjen e dëshirave të fëmijërisë, teoria e Fairbairn e marrëdhënieve me objektin e sheh brendësimin si të motivuar nga nevoja për zhvillim të vetes dhe guidë për të eksploruar botën ndërpersonale.

Ndryshe nga psikanaliza klasike, teoritë e marrëdhënieve me objektin e konsiderojnë organizmin njerëzor si autonom dhe të motivuar për të formuar personalitetin e vet. Po kështu ato e shohin marrëdhënien me objektin si një produkt i vetëm i përfaqësimeve mendore të brendësuar në procesin e zhvillimit.

Për shembull, nëse kur është i vogël, personi përkujdesës nuk i toleron ndjenjat e agresivitetit dhe i kërkon fëmijës që të mos përdorë më shprehje që tregojnë zemërim, fëmija nuk do të dijë të ndjejë apo të veprojë në formë agresive. Ky element i personalitetit të tij do të zhbëhet dhe do të krijohet konflikti mes nevojës së objektit dhe zhvillimit të vetes që “merret me vete” edhe në botën e të rriturit.

Në artikullin e tyre “Fairbairn dhe origjina e psikanalizës së marrëdhënieve”⁶⁸ Godstein dhe Rinsley shkruajnë: *“Në shkallën në të cilën një individ është i vetë dijësuar kur, jeton në një gjendje reciprociteti me një tjetër të vetë dijësuar; tjetri trupëzohet në brendësimin e tij. Procesi i diferencimit të objektit merr një rëndësi të veçantë jo vetëm pse fëmijëria karakterizohet*

⁶⁸ Fairbairn and the Origins of Object Relations”(1994), fq.90

nga identifikimi e varësia por, edhe nga qendrimet e trupëzimit verbal. Objekti me të cilin identifikohet individi, kthehet si i ngjashëm me objektin e trupëzuar dhe e kundërta, objekte të cilin është lidhur individi është trupëzuar në objektin individual in per se. Në ëndrra ky pikvështrim identifikohet me ngjashmërinë mes të qenurit brenda objektit dhe të pasurit e objektit brenda vetes.”

Qasja e marrëdhënieve me objektet jep një kontribut të rëndësishëm në kuptimin e procesit të atashimit të individit me strukturat disfunksionale dhe në argumentimin se strukturat patologjike qendrojnë në origjinën e marrëdhënieve të pavetëdijshme me të tjerët (objektet) dhe mund të bëhen shkak i shfaqjes së besimeve apo sjelljeve patogjene.

2.4. Pikëpamjet historike, bashkëkohore dhe psikodinamike mbi stilet e lidershit të mësuesit dhe drejtuesit të institucioneve arsimore

Koncepti i lidershit ka marrë një vëmendje të gjerë fillimisht në studimet e psikologjisë organizacionale e më pas në profilizimin klinik dhe psikopatologjik që në gjysmën e dytë të viteve Nëntëqind⁶⁹.

Në etimologjinë e fjalës së sotme angleze “lead” janë rrënjët e kallëzuesit të vjetër “læden” që përkon me fjalën Hollandeze “leiden” dhe Gjermane “leiten” si pjesë etimologjike e familjes anglo-sanksone. Kjo përkatësi e re “to lead” do të thoshte “...për të shkuar me...” ndërsa përdorimi i parë i termit “leadership”⁷⁰ me kuptimin “...të qenit në vendin e parë” nuk njihet para vitit 1300 p.l.k. Karakteristikë themelore kësaj e lidershit është udhëheqja e individëve brenda konteksteve sociale të organizuara, mobilizimi i të gjitha palëve të përfshira brenda një dimensionit të marrëdhënies ndërmjet subjekteve të cilët ndërveprojnë së bashku me qëllim arritjen e rezultateve të kërkuara.

Studimi psikodinamik i procesit të lidershit dhe aspektet dinamike të personalitetit të liderit janë me rëndësi për analizën dhe interpretimin e këtij studimi.

⁶⁹ Quaglio, G.P. (2005) “Leadership. Nuovi profili del leader per nuovi scenari organizzativi” Milano: Raffaello Cortina ed.

⁷⁰ “Family Word Finder: A new thesaurus of synonyms and antonyms in dictionary form” (1978) Reader Digest Library, USA, fq. 455

Përvojat e fëmijërisë dhe modelet e rritjes së fëmijëve ndikojnë në mënyrën e maturimit, zhvillimit dhe krijimit të marrëdhënieve të individit të rritur.

Në modelin e tyre psikanalitik Zigmund Frojd e më pas e bija e tij Anna kanë argumentuar për rëndësinë e metodës së mësimdhënies në shkollë dhe universitet si një nga përfitimet më të mëdha që mund të japë psikanaliza në jetën e përditshme (Frojd,1919). Metoda e mësimdhënies dhe mësimnxënies për Frojdin duhet të jetë didaktike përmes leksioneve, diskutimeve dhe përvojës.

Më 1930, në shkrimin e saj *“Katër leksione mbi psikanalizën për mësuesit dhe prindërit”* Anna Frojd shkruan se marrëdhënia që krijohet mes mësuesit, fëmijës dhe analistit është si proces delikat i arsimimit. Roli i psikanalizës është t'i japë fëmijëve *“një dorë ndihmë”* qoftë në shpalosjen e mundësive të paeksploruara qoftë në përjetimin e plotë dhe të vërtetë të simptomës.

Në modelin e saj teorik nxënësit projektonin edhe shqetësimet e tyre në përjasje për të kuptuar tjetrin përmes marrëdhënies pedagogjike (Marrëdhënie me Objektin) por edhe frustacionet e jetës së tyre të përditshme përmes procesit të të nxënit.

Koncepti i Anna Frojdit mbi edukimin i përngjan *“një betejë të pafundme”* ku egoja vjen në botë përmes mekanizmave të saj mbrojtëse (perceptim, vëzhgim, projektion, halucinacion dhe testim i realitetit⁷¹) përtej ndikimeve dhe trysnive të jashtme. Këto ndryshime të egos së të voglit i bashkëngjiten strukturës të personalitetit të të rriturit.

Po kështu, mësuesit dhe liderët mund të përfshihen në kapërthime të egos, ri dimensionime të dëshirave, aëiratave, ëndërrimeve dhe fantazive bashkë me një gamë të gjerë mbështjellëse të mekanizmave mbrojtëse sipas trajtesës së psikanalizës së Anna Frojd. Të gjithë këta elementë të stilit të karakterit ndikojnë pashmangshmërisht në tipologjinë e liderit të liderit shkollor.

Qasjet e hershme mbi liderhipin, organizatat dhe institucionet ishin të orientuara nga detyrat. Fokusi i tyre ishte nxitja e eficiencës pavarësisht ndikimeve të faktorit njerëzor. Përkundër këtyre modeleve klasike, më 1960 studiuesi Douglas

⁷¹ Katër leksione mbi psikanalizën për mësuesit dhe prindërit (1930), fq.101

McGregor parashtroi modelin humanist të lidershit ku marrëdhëniet njerëzore dhe motivimi mbi punën mbartin një rol kryesor. Studimet e mëvonshme të Robert Tannenbaum dhe Warren Schmidt⁷² e përshkruajnë liderishpin si një kontinuum ku ndërthuren disa tendenca të sjelljes të liderit si rol (objekt) dhe marrëdhënie sociale (subjekt).




Figura 0.8 Skema e lidershit sipas Tannenbaum dhe Schmidt, 1958

Dimensioni i tendencës sjellore i propozuar nga këta autorë mbart një numër pohimesh të Q edhe në studimin tonë.

Për Schmidt dhe Tannenbaum (1985) stilet e lidershit mund të paracaktohen sipas dy makro objektivave që duhen ndjekur:

1. koherenca e rezultateve dhe përqëndrimi në përgjegjësi (tipar më karakteristik i liderit autokratik ose paternal që urdhëron ose bind);
2. marrëdhëniet ndërpersonale dhe përqëndrimi në burimin Njeri (tipar më karakteristik i liderit demokratik ose këshillues që përfshin dhe bashkëpunon me vartësit e tij).

Qasja situacionale e Blake dhe Mouton (1964) argumenton se ekziston një bashkëlidhje mes të dy objektivave që tejashtëzohet në një shumësi stileshe liderishi:

- autoritari-agresivi,

⁷² Tannenbaum, A.S. dhe Schmidt, W.H., (1958) "How to choose a leadership pattern" *Harvard Business Review*, 36, fq.95-105

- asertivi kërkuesi/i vëmendshmi,
- motivacionali,
- administrativi,
- politiku.

Përmes këtij modeli kërkohet të përcaktohet një stil ndaj orjentimit, detyrës dhe situatës ku zhvillohet ky stil. Thënë përndryshe kemi të bëjmë me një qasje ku vihet në dukje marrëdhënia objektuale e liderit mësues dhe drejtues .

Lideri funksional shkollor mbart disa përgjegjësi:

- të organizojë dhe planifikojë (sipas prioriteve dhe të emergjencave të rastit);
- delegojë;
- të njohë meritat dhe vlerat në mënyrë të sinqertë, këmbëngulëse dhe insistuese;
- të verifikojë dhe vlerësojë;
- të ri-projektojë në përmirësim të vazhdueshëm (veprime në kohë dhe të përshtatshme);
- të dijë se çfarë kërkon, të gjejë forma për të arritur çka don përmes maksimalizimit të burimeve dhe me synim nxitjen e eficiencës dhe produktivitetit;
- të krijojë klimën e përshtatshme për të motivuar produktivitetin e individëve;
- të kuptojë se një lider i suksesshëm duhet të zotërojë njohuritë normative, juridike dhe të ekëertimit, kuptimshmëri dhe solidaritet, aftësi të sintezës analitike, aftësi për të zgjidhur problemet dhe marrë vendime asertive dhe konstruktive si dhe të jetë fleksibël.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet një përmbledhje e stileve të lidërshpit dhe formës së operimit të tyre sipas White dhe Goleman .

Tabela 0.7 Përmbledhje e stileve të lidershipit sipas White dhe Goleman (2000)

Stili i Lidershipit Shtrëngues Modus operandi i Liderit: Ku funksionon më mirë ky stil i lidershipit : Impakti i Përgjithshëm	Kërkon komplaincë të menjëhershme. <i>‘Bëj atë që të kërkoj të bësh .’</i> Në krizë dhe problemet e hasura me stafin . Negativ
Stili i Lidershipit Autoritar : Modus operandi i Liderit: Ku funksionon më mirë ky stil i lidershipit : Impakti i Përgjithshëm	Mobilizon njerëzit drejt një vizioni <i>‘Ejani me mua .’</i> Kur ndryshimet kërkojnë një vizion të ri apo kur nevojitet një drejtim i qartë me një drejtim nga politikat e shkollës Pjesërisht pozitiv.
Stili i Lidershipit Afrues : Modus operandi i Liderit: Ku funksionon më mirë ky stil i lidershipit : Impakti i Përgjithshëm	Krijon harmoni dhe zhvillon lidhjet emocionale . <i>‘Të parët janë njerëzit .’</i> Në motivimin e individëve në rrethana cilësuese si për shembull pas një konflikti të vështirë me kolegët Pozitiv.
Stili i lidershipit Demokratik: Modus operandi i Liderit: Ku funksionon më mirë ky stil i lidershipit : Impakti i Përgjithshëm	Jep konsensus përmes pjesëmarrjes. <i>‘Si mendoni ju ?’</i> Në zhvillimin e situatave konsensuale dhe të vlefshme me bashkëpunëtorët si për shembull, vënia në detyrë e një drejtuesi të ri me mësues me përvojë. Pozitiv
Stili i lidershipit hap pas hapi. Modus operandi i Liderit: Ku funksionon më mirë ky stil i lidershipit : Impakti i Përgjithshëm	Vendos standarde të larta për performancën . <i>‘Veproni si unë .’</i> Në situatat kur duhet të merren rezultate të shpejta nga një ekip punë i motivuar dhe kompetent . Negativ.
Stili i lidershipit Trainues Modus operandi i Liderit: Ku funksionon më mirë ky stil i lidershipit : Impakti i Përgjithshëm	Zhvillon burimet e individëve ndaj të ardhmes. <i>‘Provo !.’</i> Për të ndihmuar individët që të zhvillojnë performancën e tyre dhe burimet afatgjata, si për shembull traninimi i mësuesve të rinj për tu aftësuar në menaxhimin e klasës. Pozitiv.

*Kjo tabelë është përshtatur sipas artikullit të Marian Iszatt White “Shpjegimi i Stileve të Lidershipit të Goleman-Shembuj të punës nga Edukimi në Vazhdim” Universiteti i Harvardit, Prill 2000)

Lidershipi në shkollë duhet t'i përgjigjet nevojave për ndryshim dhe informacionit që dëshiron shoqëria duke përqafuar forma të reja të lidershipit e veçanërisht të lidershipit në fushën e mësimdhënies (Frost dhe Durrant, 2003). Lidershipi formues shpërndan përgjegjësinë e udhëheqjes ndaj shumë edukatorëve individuale në një mënyrë anti-hierarkike ose horizontale. Gonzales (2004) argumenton se demokratizimi i arsimit ndodh duke ripërcaktuar lidershipin e mësuesve si një formë e bashkëndarë e lidershipit për të gjithë mësuesit.

“Liderët mësues mund të transformojnë shkollat në komunitete që përgatisin nxënës dhe student për qytetari dhe punë në një shoqëri komplekse, teknologjike dhe demokratike” (Lieberman dhe Miller, 2004; fq.12).

Studimet e Silins dhe Mulford (2002) kanë treguar se ekziston një marrëdhënie e fortë mes rezultateve shumë të larta të nxënësve dhe lidershipit të përdorur në komunitetin e shkollës përfshirë edhe fuqizimin e mësuesve. Mësuesit si liderë mund të vazhdojnë të kërkojnë që institucionet shkollore t'i largohen sistemeve të strukturuar dhe t'i bashkohen formave të përmirësuara organizacionale (Ackerman dhe Mackenzie, 2006). Le të kujtojmë në këtë pikë përpjekjet e vazhdueshme të vendosjes së një rregullatori të brendshëm e të jashtëm të trajtesës së shkollës si “shërbim komunitar” në Shqipëri. Kjo formulë e re për vendin tonë por me baza të forta të besueshmërisë në Vendet Perëndimore, krijon natyrisht më shumë hapësira për rregullimin e sjelljes organizacionale dhe hapësirës së lidershipit për mësuesit dhe drejtuesit në shkolla. Në një studim të ngjashëm mbi përmbushjen e reformës arsimore në Shtetet e Bashkuara autorët Glickman, Gordon dhe Ross-Gordon (2001) dalluan një karakteristikë të rëndësishme që lidhej me lidershipin e bashkëndarë. Në këtë formë të lidershipit mësuesit, sipas autorëve, duhet të jenë pjesëmarrës aktivë që të mund të kontribuojnë në progresin e shkollës (Ash dhe Persall, 2000; Lieberman, 1992; McCay, et al., 2001).

Të dhënat nga studimet e Harris dhe Mujis (2005) tregojnë se mësuesit zgjedhin të qendrojnë në ato institucione arsimore që u ofrojnë mundësi të bashkëpunimit dhe lidershipit të bashkëndarë. Kilcher (1992) arsyeton se kur mësuesit ndjehen të vlerësuar si pjesëmarrës në një komunitet koheziv dhe fuqizohen si vendimarrës, ata e

tejçojnë këtë fuqizim të nxënësit dhe studentët e tyre duke u dhënë zë në vendimarrje. Pont, Nusche dhe Moorman(2008)argumentojnë se lidërshipi i suksesshëm në shkollë kërkon një shkallë të autonomisë administrative në vendimarrje për elementët kryesorë të informacionit hyrës në procesin e mësimdhënies.

Lidërshipi luan një rol të rëndësishëm në ndikimin e sjelljes kompiante⁷³ për qëllime organizacionale dhe të përmirësimit të strukturave pasive me organizimin efektiv. Disa nga dimensionet më të rëndësishme të lidërshit në edukim mund të përmbledhen në skemën e mëposhtme:

Figura 0.9 Skemë përmbledhëse e dimensioneve më të rëndësishme të lidërshit efektiv Edukativ

Burimi:Goleman, D. (1998) “La pratica de inteligencia emocional” (përshtatje nga versioni Spanjoll,fq.19)

Vetë Njohja

Konjicioni i gjendjes së brendshme të vetes dhe burimeve ndërpersonale

Konjicioni Emocional: Njohja e emocioneve dhe efekteve të vetes

Vlerësimi i Përshtatshëm i Vetes: Njohja e pikave të forta dhe të dobëta të vetes

Vetë Besimi: Siguri në vlerësimin e Vetes dhe aftësive të të tjerëve.

Vetërregullimi

Kontrolli i gjendjes, impulseve dhe burimeve tona të brendshme

Vetëkontrolli: Aftësia për të menaxhur në mënyrë të përshtatshme emocionet dhe impulset konfliktuale

Reabiliteti: Besueshmëria ndaj kriterit të sinqeritetit dhe integritetit

Integriteti: Marrja e përgjegjësisë mbi veprimet tona personale

Përshtatshmëria: Fleksibilitet për tu përballur me ndryshimin

Inovacion: Të qenurit mirë dhe i hapur ndaj ideve të reja ,qasjeve dhe informacioneve

Motivacioni

Tendencat emocionale që lehtësojnë arritjen e objektivave tona

Motivacioni për arritje: Përmirësimi dhe plotësimi i kriterëve të ekselencës.

Kompromisi: Plotësimi i objektivave të dhëna nga grupi a organizata.

Iniciativa: Gadishmëria për të vepruar atëherë kur duhet.

Optimizmi: Vazhdimësi në rrjedhojat e objektivave pavarësisht pengesave.

Kompetencat Sociale

Empatia

Konjicioni i ndjesive, nevojave dhe shqetësimi për të tjerët

Kuptimi i të tjerëve: Aftësia për të kuptuar ndjesitë dhe pikëpamjet e të tjerëve dhe interesimi të gjërat e rëndësishme për të

⁷³ këtu bashkëpunuese

Orjentimi ndaj shërbimeve: Parashikimi, njohja dhe plotësimi i nevojave të individit

Avantazhet e Shumëllojshmërisë: Marrja e avantazheve nga mundësitë e dhëna nga tipologji të ndryshme të njerëzve

Vetëdije Politike: Aftësia për të kuptuar marrëdhëniet emocionale dhe pushtetin e individit në grup

Aftësitë Sociale

Aftësia për të paraqitur reagime të dëshirueshme te të tjerët

Ndikimi: Përdorimi i teknikave efektive të bindjes

Komunikimi: Dërgimi i mesazheve të qarta dhe bindëse

Lidershipi: Frymëzimi dhe drejtimi i grupeve dhe individëve

Katalizimi i Ndryshimit: Fillimi i drejtimit të ndryshimeve

Zgjidhja e konflikteve: Aftësia për të negociuar dhe zgjidhur konfliktet

Bashkëpunimi dhe Bashkëveprimi: Të punosh me të tjerët për arritjen e qëllimi të përbashkët .

Aftësitë e Grupit: Aftësia për të krijuar sinergji grupi në arritjen e qëllimeve kolektive

* **Burimi:** Përshtatur nga D .Goleman “La practica de Inteligencia Emocional”(versioni Spanjisht) 1998 ,fq.19

Peter Drucker (2006) na jep një shembull tjetër në modelin e vendimarrjes racionale që ndikon në zgjidhjen e problemeve në lidhshpëri shkollor.

Në këtë model mund të përfshihen:

- a) klasifikimi i problemit;
- b) përcaktimi i problemit;
- c) specifikimi i kushteve për zgjidhjen e problemit;
- d) vendimi për veprimin më të mirë;
- e) kompromisi;
- f) implementimi i kësaj vendimmarrje;
- g) shqyrtimi i efektivitetit të vendimarrjes.

Vendimarrja e bashkëndarë është një proces i marrjes së vendimeve edukative në një mënyrë bashkëpunuese në nivelin e shkollës dhe u jep mundësi profesionistëve të shkollës, prindërve, anëtarëve të komunitetit dhe nxënësve të promovojnë përmirësimet e nxënësve, studentëve dhe efektivitetin e mësuesve e drejtuesve si lidera në shkollë.

T. J. Kowalski(2003) ka cituar disa nga avantazhet e kësaj forme të vendimarrjes:

- a) pjesëmarrja shton motivimin, produktivitetin dhe angazhimin e vartësve ⁷⁴;
- b) vartësit janë më pak konkurrues kur punojnë në qëllime të bashkëndara;
- c) gama e njohurive dhe aftësive shtohet me përfshirjen e njerëzve dhe vendimet e mira;
- d) rritje e komunikimit efektiv dhe njohurive brenda anëtarëve të organizatës.

Sjellja e lidërve gjithashtu bashkërendohet me kontekstin social të tyre, me pritshmëritë nga roli dhe funksioni, me hierarkinë dhe autoritetin si elementë të strukturës dhe me normat, konformitetin ndaj rregullave apo faktorë të tjerë individualë që ndikojë në tërësinë e performancës së liderit.

Organizimi i personalitetit, struktura psikodinamike, tendenca e sjelljes keqpërshtatëse dhe nivelet psikopatologjike të liderit individ janë qendërsuar si elementë bërthamë në këtë punim.

2.4.1. Parashtrimi i stileve të lidërshiptit shkollor

Stilet e lidërshiptit lidhen me personalitetin, angazhimin dhe strukturat e komunikimit të liderit në udhëheqjen e të tjerëve për të arritur qëllimet e vendosura të organizatës ose personale. Hulumtimet më të rëndësishme mbi stilet e lidërshiptit kanë qenë të lidhura me perceptimet vetë raportuese të sjelljes së liderit mbi vendimarrjen, marrëdhëniet ndërpersonale, planifikimin, lidërshiptin mbikëqyrës dhe menaxhimin eficient. Ndër instrumentat më të përdorura në literaturë për të vlerësuar stilin e lidërshiptit janë: Pyetësi i Përshkrimit të Klimës Organizacionale (OCDQ), Pyetësi i Përshkrimit të Sjelljes në Lidërshipt (LBDQ) dhe Inventari i Shëndetit Organizacional (OHI). Të gjithë këto instrumente shërbejnë për të mbledhur të dhëna mbi perceptimet e stafit dhe anëtarëve mbi stilin e lidërshiptit të drejtuesve të shkollës dhe mësuesve në dinamikat e organizimit në shkollë. Literatura, nga ana tjetër, na ofron një sasi të limituar të studimeve empirike për të kuptuar më qartë pse disa stile të lidërshiptit në disa situata janë më dominues sesa të tjerë. Ndër kategoritë kryesore të lidërshiptit në literaturën e tashme janë: lidërshipti karazmatik, lidërshipti i të drejtës

⁷⁴ Këtu të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore

sociale, lidershipi mbi rolet gjinore dhe racën, lidershipi moral dhe shpirtëror.

Katër stile të liderishipit që rrjedhin nga këto kategori janë: autoritari, pjesëmarrësi, transaksionali dhe transformuesi.

Lideri Autoritar përdor taktika shtrënguese për të ndjekur forcërisht rregullat. Ky lider përdor mënyra Makiaveliane për të manipuluar të tjerët dhe jep besimin sipas meritës. Kontrolli dhe Zotërimi janë strategjitë kryesore të menaxhimit që përdoren nga liderët autoritarë. Në këtë formë të liderishipit vihet në pah rëndësia e objektivitetit në vendin e punës, tentohet të mos qenurit i përfshirë në problemet e njerëzve dhe të mos shfaqet emocion o dashamirësi ndaj të tjerëve. Teoria e X-të e Douglas McGregor është laimotivi i stilit autoritar. Kjo teori parashtrohet se njerëzit duhet të detyrohen të punojnë, të mbikëqyren rreptësisht dhe të shpërblehen o të ndërkohohen sipas produktivitetit që sjellin. Në disa situata të caktuara kur kërkohet një “komandant për të drejtuar anijen” stili i liderishipit autoritar është efektiv. Kështu për shembull, nëse drejtuesi i një institucioni të rëndësishëm nuk do të kishte disa karakteristika të stilit autoritar me shumë gjasa drejtimi do të krijonte hapësira për neglizhim dhe kaotizëm. Po kështu është shumë e rëndësishme edhe vetë perceptimi i individit mbi stilin e liderishipit që mbart; të dhënat e këtij studimi të shqyrtuara më poshtë vënë në dukje rritjen progresive të perceptimit mbi stilin e liderishipit dhe forcimit të karakteristikave të atij stili që janë perceptuar.

Lidershipi Pjesëmarrës i largohet mënyrës së liderishipit autoritar duke u përqëndruar në anën njerëzore të institucionit. Kjo formë e liderishipit është propozuar fillimisht nga Elton Mayo (1924), Fritz Roethlisberger dhe Dickson Williams (1939), Mary Parker Follett (1996) Frederick W. Taylor (2008). Për këta autorë produktiviteti dhe marrëdhëniet njerëzore ishin ngushtësisht të lidhur me njëri-tjetrin dhe drejtohen kah strukturave informale dhe sistemeve sociale. Follett arsyetonte se “menaxherët në organizata duhet të trajtonin punonjësit me dinjitet dhe të ndryshojnë mjedisin e punës nga kontrolli autoritar strikt në një koncept më kolegjal të ekipit”. Autorët e kësaj rryme shihni organizatat si sisteme sociale ku nevojat sociale të

njerëzve janë faktorët më të rëndësishëm në motivimin e efikasitetin më të lartë. Në këtë linjë duke arsyetuar se shkollat janë në vetvete organizata mikro dhe makro-funksionale, autorë të tjerë si Kanter dhe Brinkerhoff (1981), Sergiovanni(1994), Deal(1985) dhe McGregor (2006), argumentuan se pjesëmarrja dhe vendimarrja e bashkëndarë në organizmat shkolloë duhet të fokusohet te njerëzit, komuniteti dhe nevojat e tyre. Po kështu mbështetja nga komuniteti dhe bashkëveprimi me të ndihmon shkollën të jetë proaktive dhe sociale. Hartimi i planit strategjik politikbërës për përfshirjen e shkollës në komunitet dhe komunitetit në shkollë në vendin tonë është natyrisht i mirëpritur por rezultatet reale të këtij bashkëveprimi janë ende për tu vlerësuar.

Liderët transaksionalë tentojnë të vënë në balancë strukturat që të plotësojnë nevojat e njerëzve gjatë plotësimit të nevojave të tyre. Kjo formë e liderishipit kërkon integrimin e qëllimeve dhe pritshmërive të organizatës me nevojat e individëve. Si shembull të përfaqësimit të stilit të liderishipit transaksional është modeli i sistemeve sociale Getzels-Guba⁷⁵. Ky model përshkruan tri dimensione kryesore: *idiografike* (nevojat e individëve), *nomotetike* (qëllimet e organizatës) dhe *transaksionet ndërmjet tyre*. Kështu balancohen dinamikat e nevojave dhe produktiviteti i organizatës me nevojat, personalitetin dhe predispozitat e njerëzve në punë.

Në fushën e psikologjisë transaksionale, Eric Berne(1961) analizoi fillimisht marrëdhëniet mes grupit dhe liderishipit sipas parimeve të analizës transaksionale klasike dhe gjendjes së ndryshuar të Egos. Berne përdori konceptin e “kontaminimit” të gjendjes së Egos së të rriturit për të shprehur të njëjtin parim që Teoria e Kontrollit dhe Zotërimit (CMT) e lidh me Besimet Patogjene. Kontaminimi i gjendjes së Egos mund të shfaqet në transaksionin e Prindit, të Fëmijës ose të ndërmjetëm.

⁷⁵ Modeli Getzel-Guba(1957) e koncepton liderishipin dhe organizimin shkollor si një sistem social që përmbledh dy dimensione ndërvepruese por të pavaruara nga njëri-tjetri: Dimensioni i parë është institucioni, i parë në dritën e roleve dhe pritshmërive ndaj roleve. Dimensioni i dytë lidhet me personalitetin dhe faktorët individualë të lidhur me organizimin (Getzel, J.W dhe Guba, E.G.(1957) “Social Behavior and the Administrative Process”, The school review, Vol.65 Nr.4, fq.423-441

Për ta konkretizuar këtë model klasik le të marrim në shembull një mësues të një lënde djathtësore (psh. edukimi muzikor) që mendon dhe sillet sikur të ishte drejtori. Në këtë rast, gjendja e Egos së të rriturit do të ishte e prekur (kontaminuar) nga Prindi. Nëse ky mësues ka jetuar në një familje ku prindërit lëvdonin gjatë gjithë kohës individët me poste të larta dhe nuk konsideronin fare ata në kategori më të ulëta, atëherë ky mësues-fëmijë ka krijuar një besim patogjen duke besuar se duhet të sillet pikërisht kështu për të marrë lëvdatën e admirimin e tjetrit të rëndësishëm (prindit). ⁷⁶Teoria klasike u rishqyrtua në vitin 2011 dhe u integrua në Modelin e të Qenurit- OK, model i fokusuar në paradigmen “Unë jam Ok-Ti je Ok” i cili përfshinte këto elemente: shpërblimin e kontigjencës, menaxhimin përmes përjashtimit aktiv dhe menaxhimin përmes përjashtimit pasiv. Këta liderë ndikojnë motivacionin e ndjekësve të tyre duke shkëmbyer shpërblimet për punonjësit për aq kohë sa ata janë eficientë me nevojat e organizatës. Në shembullin tonë, nëse të njëjtin mësues do ta analizonim sipas Modelit “Unë jam Ok-Ti je Ok”, besimi patogjen për tu sjellë siç do të prisnin prindërit e tij (drejtori) kur bie ndesh me realitetin (nxënësit e neglizhojnë), mund të krijojë modelin psikik “Unë nuk jam Ok-Ti je Ok”. Përvoja e krijuar nga kjo shpërputhje në këtë rast shpie në frustim, konflikt dhe disfunksion të rolit në organizimin e personalitetit. Andaj, është e rëndësishme të studiohet sesi janë të krijuara këto struktura në liderët në shkollë nga përvojat e tyre personale për të kuptuar nivelin e kontaminimit të gjendjes së Egos në marrëdhënien me të tjerët (Funksionaliteti Mendor i Egos)⁷⁷.

Liderishipi Transformues quhet stili i liderishipit ku, lideri punon së bashku me punonjësit për të identifikuar ndryshimet e nevojshme, të zhvillojnë një pikëpamje udhëheqëse për ndryshimin dhe të vënë në jetë efektet e këtij ndryshimi.

Kjo formë e liderishipit nxit motivacionin, moralin dhe performancën në punë përmes një sërë mekanizmash si kuptimi mbi identitetin vetes dhe mënyra e projektimit të këtij kuptimi në identitetin e grupit, të qenurit një model për ndjekësit, sfidimi i punonjësve që të marrin zotërim mbi punën e tyre dhe kuptimi i pikave të

⁷⁶ Përshkruar në librin e Wagner “The transactional manager”, 1981

⁷⁷ Davidson & Mountian “Working Together: Organizational Transactional Analysis and Business Performance”

forta dhe të dobëta të punonjësve në mënyrë që lideri të mund të nxisë performancën e tyre.

Termi është përdorur për herë të parë nga Downton më 1973 ndërsa, strukturimi i tij si qasje vihet re në botimin e sociologut Jams MacGregor Burns me titullin “Lidershipi” (1978). Në këtë punim ai i përshkruan liderët si “njerëz që kapin motivet e ndjekësve që të mund të arrijnë më mirë qëllimet e tyre dhe të ndjekësve”⁷⁸.

Lidershipi transformues përbëhet nga *pesë elementë* themelorë:

- *Ndikimi i idealizuar* (atribuimi) -formë e liderishipit karizmatik që bazohet në emocionet e adhurimit, reëktit dhe vlerësimit të punonjësve nga lideri.

- *Motivacioni Frymëzues* – motivacion për të nxitur një pikëpamje të përbashkët dhe për të stimuluar anëtarët e organizatës që të mbajnë një sjellje që shkon përtej detyrave të parashikuara të organizatës dhe pajisjen e stafit me sjellje të përputhshme me të.

- *Konsiderata e Individualizuara* është shkalla në të cilën lideri ndjek dhe dëgjon nevojat e anëtarëve të grupit, përfaqëson a udhëzon ndjekësit e tij. Sjellja e shfaqur sipas këtij elementi të liderishipit transformues përfshin diskutimin dhe empatinë me nevojat e çdo anëtari individualisht, krijimin e lidhjeve ndërpersonale me anëtarët, shfaqjen e dashamirësisë dhe përkujdesjes për anëtarët dhe nxitjen e përparimit profesional për anëtarët a punonjësit e organizatës.

- Ndryshe nga format e tjera të liderishipit, lidershipi transformues me elementë psikodinamikë vlerëson “brendësinë” d.m.th. botën e brendshme të individit përfshirë emocionet, marrëdhëniet e tij me veten dhe të tjerët por dhe “realitetin” që krijohet nga ndërveprimi dinamik i grupit (Neumann & Hirschhorn, 1999). Lidershipi në kuptimin psikodinamik përfshin ndërveprimin e individëve në të gjitha sistemet dhe kontekstet. Ai studion veçanërisht mënyrën sesi individët dhe institucionet a organizatat sillen, krijojnë dhe forcojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre, menaxhojnë konfliktet e brendshme dhe të jashtme, angazhohen, krijojnë identitetin e grupit dhe

⁷⁸ Leadership ,fq.18

përshtasin sjelljen me qëllim rritjen e efektivitetit të tyre (Burns, 1978; Bennis dhe Nanus, 1985; Stogdill dhe Bass, 1990; Pfeffer 1998; Kets de Vries, 2001). Me formën e liderit karizmatik, kjo formë e liderit mbart dy pika të përbashkëta: rëndësinë e identifikimit me liderin dhe përputhjen e vizionit të liderit me të gjithë anëtarët e organizatës. Studimet kanë treguar se lideri transformues është një faktor i rëndësishëm mbrojtës ndaj procesit të konsumimit (burnout) në institucionet shëndetsore dhe ka një impakt pozitiv mbi marrjen e kënaqësisë në punë dhe përgjegjësinë ndaj organizatës (Green, Miller dhe Aarons, 2013)⁷⁹. Veçanërisht të rëndësishme janë studimet që kanë treguar një lidhje të fortë pozitive ndërmjet stilit të liderit transformues dhe programeve të ndërhyrjes në shëndetin mendor (Aarons, Sommerfeld & Willging, 2011; Stordeur, D'hoore dhe Vandenberghe, 2001)

80.

Një argument tjetër mbi liderin transformues është dhënë nga Bass (1998) i cili arsyetoi për herë të parë mbi konceptin e liderit pseudotransformues. Termi lidhet me liderët që janë vetë konsumues, shfrytëzues dhe të orjentuar drejt pushtetit (Bass dhe Riggio, 2006). Kjo është një pikë mbështetëse edhe ndaj studimit tonë: të forcohen strukturat e personalitetit që lidhin liderin mësues dhe drejtues të shkollës me formën e liderit transformues dhe inovator. Lideri pseudotransformues është konsideruar si i personalizuar që fokusohet te interesat e liderit (Bass dhe Steidlmeier, 1999). Përkundrazi kësaj forme lideri, ekziston edhe tipologjia e liderit transformues autentik. Në këtë tipologji, kemi të bëjmë me një lider të socializuar në të cilin liderët lënë në hije interesat e tyre për hir të të tjerëve (Howell dhe Avolio, 1993). Lideri shkollor autentik nuk është zhvilluar plotësisht në teori pasi është një fushë kërkimore relativisht e re. Studimet gjithashtu kanë treguar se në vetvete është edhe një term i ndërlikuar dhe i vështirë për një përkufizim të qartë (Avolio dhe Gardner, 2005; Chan, 2005). Lideri shkollor autentik lidhet me një

⁷⁹ Transformational Leadership Moderates the Relationship between Emotional Exhaustion and Turnover Intention among Community Mental Health Providers
<https://.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4209723/>

⁸⁰ Leadership, organizational stress, and emotional exhaustion among hospital nursing staff.
<https://onlinelibrary.wiley.com/doi/abs/10.1046/j.1365-2648.2001.01885.x>

model të sjelljes së liderit i cili mbështetet dhe promovon aftësi psikologjike dhe një klimë etike pozitive; nxit vetëdijësimin, ofron një këndvështrim të brendshëm moral, ofron një formë të ekuilibruar të përpunimit të informacionit dhe motivon pozitivisht marrëdhëniet e liderëve drejtues me liderët e varës (Walumbwa et al., 2008).

Robins dhe Coutler (2005) kanë argumentuar se lidërshtipi autentik është dimension i më i rëndësishëm i lidërshtipit etik. Në një analizë të mëtejshme për qasjen teorike e lidërshtipit autentik shkollor, Walumbwa et al. (2008) argumentojnë se kjo formë lidërshtipi bazohet në parime të forta etike dhe cilësi pozitive psikologjike (besim, shpresë, optimizëm dhe rezistencë). Walumbwa et al. (2008) dhe Avolio et al. (2009) krijuan një model të ri lidërshtipit autentik, i cili përdoret gjerësisht në literaturën e lidërshtipit shkollor (Northouse, 2013). Ky model përfshin katër komponentë të ndryshëm por të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Vetëdijshmëria - përfshirë perceptimet personale të një lideri për vetë-vetëdijen e individëve (Kernis, 2003);

2. Perspektiva e brendshme morale - veprime të përafruara me besimet dhe moralin e liderit (Gardner et al., 2005);

3. Balanca – pranimi i këndvështrimeve të të tjerëve (Walumbwa et al., 2010);

4. Transparenca në marrëdhënie - komunikimi dhe vetë hapja ndaj të tjerëve (Kernis, 2003). Një lider i mirë duhet të zhvillojë secilën nga këta katër përbërës të sjelljes me qëllim qasjen sa më të mirë jo vetëm në marrëdhëniet me të tjerët e rëndësishëm (Veten dhe Tjetrin) por edhe të vetë karakteristikave psikodinamike të personalitetit.

Zhu, Riggio dhe Sosik⁸¹ kanë propozuar një tjetër model teorik që shpjegon sesi lidërshtipi transformues autentik ndikon etikën e ndjekësve dhe grupeve të individëve.

Për autorët, lidërshtipi autentik transformues ndikon pozitivisht identitetin moral dhe emocionet morale që shpien në vendimarrjen dhe veprimin moral të ndjekësve të

⁸¹ Zhu, W., Sossik, J. John dhe Riggio E. Ronald (2012) Relationships between Transformational and Active Transactional Leadership and Followers' Organizational Identification: The Role of Psychological Empowerment, Institute of Behavioral and Applied Management, fq.3

tyre. Andaj ky nëngrup i lidërshiptit është pozitivisht i shoqëruar me klimën etike të grupit, vendimarrjen dhe veprimin moral. Autenticiteti i liderit konsiderohet po kaq i rëndësishëm sa autenticiteti i qenies. Studimi psikodinamik i procesit të lidërshiptit dhe aëktet dinamike të personalitetit të liderit janë më rëndësi për analizën dhe interpretimin e këtij studimi. Përvojat e fëmijërisë dhe modelet e rritjes së fëmijëve ndikojnë në mënyrën e maturimit dhe zhvillimit të individit.

Në vitet e hershme fëmijët fillojnë të idelizojnë prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj ndërsa, me rritjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre vetjak, ata identifikojnë figurat e jashtme me role dhe modele të caktuara.

Ekziston gjithnjë rreziku i atributit të roleve *lidërshiptiale* (udhëheqëse) ndaj modeleve të rolit. Stech (2006) argumenton se qasja psikodinamike e lidërshiptit fillon nga një analizë e thelluar e personalitetit njerëzor që bashkëlidhen më pas me tipet dhe nivelet e lidërshiptit. Këto tipare të formësuara të personalitetit ingranohen ngushtësisht me njëra-tjetrën.

Qasja psikodinamike kërkon të ekëlorojë motivet e pavetëdijshme të liderit në mjedisin e edukimit dhe partnerëve të tij në këtë marrëdhënie, nxënësve. Kroeger dhe Theusen (2013) vënë në dukje se lidërshipti përfshin përdorimin e pushtetit dhe tiparet e personalitetit të liderit mund të diktojnë mënyrën sesi reagohe ndaj vështërsive, situatave të krizës dhe vendimarrjes.

Në studimin e tyre mbi zhvillimin e identitetit, Cote dhe Schwartz citojnë studimet e Marcias (1980) mbi këtë argument. Ata parashtrojnë një fushë 4 dimensionale të *maturitetit* dhe *vetë rregullimit* në Identitetin psikodinamik të liderit.

- Difuzioni i Identitetit, më pak i maturuari karakterizohet nga një mungesë e drejtimit dhe orjentimit ndaj qëllimeve.
- Identiteti i Bashkëlidhur është më shumë i maturuar dhe përfshin angazhimin.
- Individi me Identitet Moratorium ndërmerr hapa proaktive dhe synon arritjen e një veteje autonome. Në fundin e hierarkisë qëndron Arritja e Identitetit, gjendja më e maturar e shoqëruar me të menduarin, marrëdhëniet ndërpersonale dhe

shoqërore të maturuara (Cote dhe Schwartz, 2002).

Në kuptimin psikodinamik, një lider me identitet të Arrirë është individi ku forcat Libidinale dhe Antilibidinale neutralizojnë njëra-tjetrën për të mirën e Egos.

Mund të flasim kështu për lider Autentik me Identitet të Arrirë dhe Ego mbrojtës si individin mësimdhënës me parametrat më të larta të organizimit të një personaliteti. Qendrueshmëria e forcave neutralizuese është kështuqë thelbi i një OP të shëndetshëm me orjentimi sjellor (bihejvoral) pozitiv për liderin mësues.

Në studimet e tij mbi lidërshtipin transformues dhe elementët përbërës të tij, Conger⁸² përdori për herë të parë fjalën *karizëm* që përshkruan një dhuratë të vecantë që disa individë mbartin, ajo që u jep atyre aftësinë për të kryer gjëra të jashtëzakonshme. Weberi e përshkruan karizmën si karakteristikë e vecantë të personalitetit që i jep njeriut fuqi të njohjes së roleve të rëndësishme të karizmës të këta liderë (Bryman, 1992; House,1976). Për House⁸³ karakteristikat e personalitetit të një lideri karizmatik përfshijnë të qenurit dominant, të pasurit enjë dëshirë të fortë për të ndikuar te të tjerët,të qenurit me besim te vetja dhe me një sens të fortë të vlerave morale.

Më poshtë paraqiten të përmbledhura disa nga karakteristikat e personalitetit,veçoritë e sjelljes dhe efektet e tyre të ndjekësit e liderit karizmatik.

Tabela 0.8 Përmbledhje mbi Karakteristikat e Personalitetit,Sjelljet dhe Efektet të ndjekësit të liderit Karizmatik

Burimi:House(1976) “Lidërshtipi Transformues dhe Karizmatik”

Karakteristikat e Personalitetit	Sjelljet	Efektet të ndjekësit
Dominant	Rol dhe model i fuqishëm	Besim në ideologjinë e liderit
Dëshira për ndikim	Tregon kompetencë	Besim i njëjtë mes liderit dhe ndjekësit
Vetë Besimi	Artikulum i qëllimeve	Pranimi pa kushte

⁸² Conger, J. A. (1999) ‘Charismatic and transformational leadership in organizations: An insider’s perspective on these developing streams of research’ *Leadership Quarterly*, 10: 145–179 ; Hunt, J. G. and Conger, J. A. (1999) ‘From where we sit: An assessment of transformational and charismatic leadership research’, *Leadership Quarterly*, 10: 335–343

⁸³ House, R. J. (1977) ‘A 1976 theory of charismatic leadership’, Gjendur në J.G. Hunt and L.L. Larsen (eds), *Leadership: The Cutting Edge*. Carbondale, IL: Southern Illinois University Press

Vendosja e vlerave morale	Artikulum i pritshmërive të larta Shfaq konfidencë Nxit motivet	Afeksion ndaj liderit Bindje Identifikim me liderin Përfshirje emocionale Qëllime të larta Besim i lartë
---------------------------	---	---

Në strukturën e tyre të personalitetit, liderët me tipare karizmatike shfaqin tipe ëecifike të sjelljes. Së pari, kemi të bëjmë me modele të forta rolesh për sistemin e vlerave dhe të besimit, kompetencë dhe motivacional për ndjekësit e tij .

Së dyti, ata artikulojnë qëllimet ideologjike⁸⁴ e morale dhe komunikojnë pritshmëritë me ndjekësit e tyre. Një lider shkollor me karakteristika të tilla do të përfaqësonte prototipin e shëndetshëm me stil të lidershit autentik .

Siç mund të shihet edhe nga tabela përmbledhëse në vijim, dy modelet kryesore të liderishipit që trajtohen më gjerësisht në këtë studim, lidershipi transformues dhe transaksional, përbëhen nga faktorë të ndryshëm.

Sipas modelit të propozuar nga Bass këta faktorë përmbledhin qëllimet dhe mënyrat kryesore të operimit të liderit në kontekstet e kërkuara.

Tabela 0.9 Faktorët e Liderishipit Transformues, Transaksional dhe Laissez-Faire.

Liderishipi Transformues	Liderishipi Transaksional	Liderishipi Laissez-Faire
Faktori 1 Ndikimi i idealizuar Karizma	Faktori 5 Shpërblemi Kontigjent Transaksioet Konstruktive	Faktori 7 Laissez-Faire Jo Transaksional
Faktori 2 Motivacioni i Frymëzuar	Faktori 6 Menaxhim përmes përjashtimit Aktiv dhe Pasiv Transaksionet Korrigjuese	
Faktori 3 Stimulimi Intelektual		

Faktori 4 Konsideratat e Individualizuara		
--	--	--

Në qëllimin e vet kryesor, lidershipi transformues kërkon të përmirësojë performancën e ndjekësve të vet dhe të zhvillojë potencialet e tyre të plota (Avolio, 1999; Bass dhe Avolio, 1990).

Kjo formë e lidershipit mund të përfshfaqet nga njerëzit që mbartin një sërë vlerash dhe idealesh personale dhe mund të motivojnë të tjerët që të veprojnë në forma që mbështesin interesin e të gjithëve dhe jo vetëm të vetes (Kuhnert, 1994).

Promovimi i këtij stili të liderishipit nxit liderin mësues dhe drejtues që të ndikojë në zbërthimin dhe kuptimin e konflikteve intrapsikike dhe në fuqizimin e potencialeve e burimeve të brendshme të nxënësve si konsumatorë të dijes dhe zhvillimit.

Faktori i parë *Ndikimi i Idealizuar* ose karizma përshkruan elementin emocional të lidershipit (Antonakis, 2012). Liderët nën ndikimin e këtij faktori veprojnë si modele të fuqishme për ndjekësit e tyre, të cilët identifikohen me ta dhe dëshirojnë të ngjajnë me modelin e liderit të tyre. Liderë të këtillë mbartin standarde shumë të larta të moralit dhe sjelljes etike, ata përcjellin një respekt të madh të ndjekësit e tyre dhe i japin atyre (ndjekësve) një vizion të qartë largpamës.

Faktori i ndikimit të idealizuar mund të vlerësohet përmes dy komponentëve: *komponenti atribues* që lidhet me atributet që u jepen liderëve nga perceptimet e ndjekësve të tyre dhe nga *komponenti sjellor (bihejvioral)* që lidhet me vëzhgimet që ndjekësit i kryejnë sjelljes së liderit. Faktori i karizmës përshkruan individët e vecantë që mund të bëjnë të tjerët të bashkëndajnë vizionin e tyre për të shkuar përpara.

Faktori i dytë *Motivacioni Frymëzues* përshkruan liderët që vendosin pritshmëri të larta për ndjekësit e tyre. Ata i frymëzojnë ndjekësit që përmes motivacionit të angazhohen dhe të jenë pjesëmarrës me vizionin e përgjithshëm të organizatës. Liderë të tillë përdorin forma simbolike dhe fraza emocionale që të fokusojnë përpjekjet e grupit për të arritur më shumë.

Faktori i tretë, *Stimulimi Intelktual* përfshin formën e liderishipit që i stimulon

ndjekësit që të jenë krijues dhe inovativë për të sfiduar sistemet personale të vlerave, besimit të liderit dhe krejt institucionit.

Në këtë formë liderishi individët motivohen për të zhvilluar qasje dhe mënyra të reja inovative për të zhvilluar mendimin e tyre kritik dhe të zgjidhin problemet e tyre.

Faktori katërt, *Konsiderata e Individualizuar* përfaqëson liderët që japin një klimë mbështetëse, dëgjojnë me vëmendje dhe ndihmojnë individët në nevojat e tyre.

Lideri sipas këtij faktori është model trajnues dhe këshillues teksa ndihmon ndjekësit që të vetë aktualizohen. Këta liderë mund të përdorin edhe delegimin për të ndihmuar ndjekësit që të fuqizohen përmes sfidave personale.

2.5. Klasifikimi i çrregullimeve mendore përmes PDM versioni për të rritur

Në perspektivën psikodinamike arritja e një kuptimi stabël e pozitiv të vetes si dhe vendosja e një marrëdhënieje reciprokisht të kënaqshme dhe jetëgjatë janë me gjasa dy detyrat thelbësore të zhvillimit të individit.

Një studim mjaft interesant i kryer nga Robert Gordon (2008-2009) hulumtoi mënyrën sesi psikologë me orjentime teorike dhe specialitete të ndryshme (psikodinamike, konjitive-bihejvorale dhe të tjera) gjykuan mbi PDM.

Rezultatet treguan një vlerësim mjaft të lartë për manualin nga të gjithë psikologët pjesëmarrës. Pjesëmarrësit cilësuan vlerën e gjuhës të lehtë dhe komentuan mbi dobinë e ndihmës që u jep klinikistëve për formulimin dhe trajtimin e diagnozës.

Në Europë studimet mbi vlerësimet dhe perceptimet e PDM-së u udhëhoqën nga Franco del Corno dhe Vittorio Lingiardi (Universitetit i Sapienza, 2012)⁸⁵. Rezultatet e vjela të studimit të tyre treguan se :

1) në literaturën Gjermane referimet mbi manualin e PDM lidhen me kapitullin e Diagnozës së Operacionualizuar Psikodinamike (OPD-2-Task Forca e OPD, 2001);

2) në Spanjë dhe Portugali (Ferrari, 2006-2008) një grup kërkuesish propozuan

⁸⁵ Gjendur në Lingiardi et al. (2015) Clinicians' emotional responses and Psychodynamic Diagnostic Manual adult personality disorders: A clinically relevant empirical investigation. *Psychotherapy*, 52(2), 238–246

një “*Formular mbi Raport Hulumtimin*” dhe krijimin e versionit Sanjoll të manualit. Rosenthal (2008) karakterizoi PDM-në si një mënyrë e lidhjes së psikanalizës me disiplinat e tjera shkencore;

3) në Turqi, Dereboy (2013) projektoi përdorim e PDM-së në programet e studentëve të Masterit dhe ëecialistët e shkencave të mjeksisë përgjatë viteve 2018-2019;

4) në Francë, Widlocher (2007) shkroi një monografi mbi manualin të titulluar “*Nga nosografikja te psikopatologjikja*”⁸⁶ në të cilën argumentohet se modeli psikanalitik është konteksti më i mirë për zhvillimin e klasifikimeve të reja të çrregullimeve psikiatrike që mund të jenë plotësuese me DSM.

Widlocher dhe Thurin (2011) argumentojnë se PDM përbën një model të integruar të perëektivës dinamike për psikopatologjinë me një diagnozë të orjentuar nga sjellja dhe simptoma;

5) në Itali PDM është përkthyer dhe botuar më 2008 ndërsa një ekip multidisiplinar e ka përshtatur atë për përdorime klinike në Janar të 2018.

Në qendër të kontributeve të gjera dhe të ndryshme të Fairbairn qendron pikërisht mendimi kritik dhe riformulimi i teorisë psikanalitike të motivacionit e quajtur “*teoria e nxitjes së instiktit*”⁸⁷.

Libido kësisoj nuk është një element psikik që kërkon kënaqësi sikundër argumentohet në psikanalizën klasike por një kërkues për krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve me tjetrin e rëndësishëm (objektin). Lidhjet me të tjerët që në atashimin e hershëm nënë-fëmijë mund të kenë qenë të paplotësuara dhe fëmija i rritur me gjasa do të zhvillojë më vonë një marrëdhënie keq funksionale me jetën e vet libidinale.

⁸⁶Le Manuel Diagnostique Psychodynamique. Du nosographique au psychopathologique, 2007

⁸⁷ Përpos teorisë klasike psikanalitike që trajtonte motivacionin si pulsion të libidos ndaj kërkimit të kënaqësisë, teoria e marrëdhënieve me objektin e sheh motivacionin si nxitje për kërkimin e Tjetrit të Rëndësishëm, marrëdhënien. Dy autorë të kësaj torie, Fairbairn (1952) dhe Sullivan (1953) e studiuuan këtë zhvillim të ri në evolucionin e marrëdhënieve me objektin. Fairbairn argumentoi mbi qëllimin objekt kërkues të libidos ndërsa Sullivan ndërtoi një model të strukturës dhe zhvillimit të personalitetit që lidhej me distorcionet e vetë perceptimit dhe shmangien e ankthit të përgjithësuar si faktor i jetës së njeriut (*Handbook of Personality: Theory and Research, Botimi i tretë, John, P. Oliver dhe Pervin, A. Lawrence (2010) Kap. III, fq. 63, The Guilford Press*).

Në kuptimin e vështërsive psikologjike të krijuara nga marrëdhënia disfunktionale me tjetrin e rëndësishëm për shëndetin mendor, operon edhe PDM-ja. Si një manual i ri i trajtimit PDM nuk e sheh simptomën në një mënyrë kategorike dhe të izoluar sikundër manualët e tjera diagnostike DSM dhe ICD por e analizon atë në thellësinë e formimit të brendshëm dhe efektet e shfaqjes së jashtme. Diagnozat e krijuara nga PDM janë prototipike pasi përshkruajnë çrregullimet e ndryshme klinike dhe të personalitetit jo si forma kategorike të kriterëve dhe simptomave por, sipas një niveli të caktuar pragu të pikëzuar sipas Tabelës Psikodiagnostike (PDC-2) që lejon analizën e thelluar dhe kuptimin e shfaqjeve klinike të subjekteve. Niveli i ngjashmërisë mes vlerësimit të një individi dhe prototipit të tij mund të vlerësohet në formë dimensionale dhe në formë kategorike brenda të njëjtës shfaqje klinike. PDM-ja pra, bashkërendon diagnozën dimensionale me atë kategorike duke dhënë një kuadër të plotë e shterrues të funksionalitetit të secilit individ (prototip).

2.5.1. Përcaktimi i strukturave të personalitetit dhe funksionimit mendor (Akset P dhe M).

PDM e trajton shëndetin mendor të njeriut në tri diëozita të mëdha :

- I. Modele të Personalitetit (Aksi- P)
- II. Funksionimi Mendor (Aksi-M)
- III. Përvoja Subjektive (Aksi-S)

Në artikullin e tyre “*Konsiderata Etike në Zhvillimin dhe Aplikimin e Nozologjive Mendore dhe Bihejvorale: Mësime nga DSM-5, Kërkesat dhe Ligjësitë Psikologjike*”⁸⁸, Gordon dhe Gosgrove kanë argumentuar se DSM-ja mund të konsiderohet si një manual diagnostik që përfshin një sërë kategorish specifike për të arritur te një diagnozë që është problematike shkencërisht. Nga ky argument i tyre lindën disa kundërthënie me DSM-5 për shkak të kriterëve kategorike përshtjelluese⁸⁹ që ajo ofronte për trajtimin klinik. Studiuesit e psikanalizës filluan të interesohen për nivelin e organizimit të personalitetit ose ashpërsinë e çrregullimit të personalitetit të

⁸⁸ Ethical Considerations in the Development and Application of Mental and Behavioral Nosologies: Lessons from DSM-5, Psychological Injury and Law

⁸⁹ 2013; fq 2-5

ofruar në manualin e ri PDM. Ky manual bazohet në të dhënat e fundit të neuroshkencë, të trajtimit dhe hulumtimeve empirike që kanë treguar se strukturat emocionale, sjellore, sociale dhe të funksionalitetit përfshijnë një gamë të gjerë fushash të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Studimet kanë vënë në dukje rëndësinë e analizës dhe interpretimit të tërësisë së strukturave emocionale dhe sociale në trajtimin e shëndetit mendor. Studiues si Blatt, Auerbach, Zuroff dhe Shahar, Norcross dhe Wampold (2002) ⁹⁰ treguan se natyra e marrëdhënieve psikoterapeutike së bashku me aspektet operuese të mendjes dhe trurit mund të parashikojnë më shumë rezultate sesa çdo qasje tjetër trajtimi. Natyra dhe gama e parashikimeve është në qendër të strukturave të organizimit në Manualin Diagnostik Psikodinamik. Struktura multi-aksiale jep vlerësime të artikuluara dhe multidimensionale të funksioneve psikike të individit, të përvojës subjektive të tij lidhur kjo edhe me vlerat kulturore dhe kontekstet e lidhura me to por edhe të burimeve e potencialeve të individit për të tejkaluar vështësitë. Për këtë arsye, krijimi i një prototipi psikodinamik na lejon edhe vlerësimin e mekanizmave përballuese të matururara që ndihmojnë në parandalimin e zhvillimit të psikopatologjisë. Një veçori tjetër e këtij manuali, ndryshe nga manualët e tjera të diagnostikimi, është edhe vëmendja që i kushtohet fashës moshore të zhvillimit. Klasifikohet kështu seksioni për të vegjlit dhe fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit. Pjesa diagnostike e të rriturit në të cilin është mbështetur ky studim, fillon me personalitetin e tij. Aksi –P i Modeleve të Personalitetit dhe Çrregullimeve është vendosur fillimisht në sistemin e PDM pasi të dhënat e grumbulluara dhe simptomat e tyre nuk mund të kuptohen ose trajtohen në mungesë të një kuptimi të thellë të tipareve të personalitetit të të rriturit mbartës.

Në këtë aks përshkruhen :

1. Niveli i organizimit të personalitetit
2. Stili i personalitetit, modeli ose çrregullim i personalitetit.

⁹⁰ PDM, fq.32

Niveli i organizimit të personalitetit është një ëektrum që përshkruan nivelin e ashpërsisë së disfunkcionit të personalitetit të individit në një diapazon që shkon nga *personaliteti i shëndetshëm* (mungesë të një çrregullimit të personalitetit) në *nivelin neurotik* të çrregullimit të personalitetit. Në kufirin e nivelit tjetër shtrihet *niveli i organizimit të personalitetit kufitar (borderline)* dhe *psikotik*. Konceptet “Neurotik”, “Kufitar” dhe “Psikotik” përdoren në PDM si një nivel i ashpërsisë dhe jo si një çrregullim specifik i personalitetit si në DSM. Nivelet e organizimit të personalitetit (i shëndetshëm, neurotik, borderline dhe psikotik) përcaktohen nga vlerësimi i aftësive dhe kompetencave të individit. Këto aftësi përfshijnë: *maturitetin dhe identitetin, aftësinë për krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të qendrueshme, rregullim i afektit, arsyetimin moral, testimin e realitetit dhe aftësinë për të reaguar dhe u rehabilituar nga stresi*.

Zhvillimi i stilit të personalitetit përfaqëson stile a tipe të personalitetit që zhbëjnë nivelin dinamik të personalitetit. Ky koncept i zhvillimit të stilit të personalitetit nuk nënkupton gjendjen e shëndetshme apo patologjike por parimet dinamike psikologjike të personalitetit të individit.

Pas përcaktimit të të gjithë nivelit të organizimit të personalitetit, ne marrim në shqyrtim modelet e personalitetit të Aksit-P që mund të jenë të përshtatshme (në minimumin e dëmtimit) ose në çrregullim të personalitetit të qendrueshëm (që shkaktojnë vuajtje të përsëritura për veten dhe të tjerët).

Modelet ose çrregullimet e organizimit të personalitetit në Aksin P përfshijnë:

1. skizoidin;
2. paranoidin;
3. psikopatikun (antisociali) i ndarë në dy nëntipe : pasiv/parasitik dhe agresiv
4. narcistikun i ndarë në dy nëntipe- arrogantë dhe të depresuar;
5. sadistin dhe tipin e ndërmjetën me manifestime sadomazokiste;
6. mazokistin(vetë-shkatërrues) i ndarë në dy nëntipe : mazokisti moral dhe mazokisti relacional;

7. depresivin e ndarë me nëntipet: introjektiv dhe analitik. Manifestimi i kundërt në këtë model është individi me manifestime të nivelit hipomaniak ose të somatizuar;
8. vartësin i ndarë në nëntipin pasiv-agresiv. Manifestimi i kundërt në këtë model është individi me manifestime të nivelit dominant;
9. fobikun (shmangësi). Manifestimi i kundërt në këtë model është individi me manifestime të nivelit kundërfobik -anksioz;
10. obsesiv –kompulsivin i ndarë në nëntipet obsesive dhe kompulsive;
11. histerikun (histrioniku) me nëntipe i frenuar, pompoz dhe dissociativ;
12. i përzier/tjetër.⁹¹

Këto modele të organizimit të personalitetit përfaqësojnë në fakt atë që Gazillo dhe Lingardi (2012) i quajten 19 Format-Prototipe (PDP) të organizmit të Personalitetit sipas këndvështrimit psikodinamik.

Më pas Aksi-P i PDM-së merr në konsideratë secilin çrregullim të personalitetit sipas strukturave të temperamentit, tematikave, afekteve, konjicioneve dhe strukturave mbrojtëse. Personaliteti psikopatik (antisocial) për shembull ka një agresivitet dhe prag të lartë për stimulim emocional si pjesë e faktorëve të temperamentit ose maturitetit të individit. Problematika qendrore apo shqetësimi parësor është manipulimi dhe të qenurit i manipuluar. Afektet kryesore të këtij personaliteti janë *inati dhe zilia*. Besimi patogjen karakteristik për veten është : “*Unë mund të bëj gjithcka*”. Besimi patogjen karakteristik për të tjerët është: “*Të gjithë janë mendjemdhenj, manipulatorë dhe të pandershëm*”. Mënyrat kryesore të mbrojtjes janë *kontrolli dhe dominanca* mbi të tjerët. PDM-ja nuk i trajton vështërsitë psikologjike ose çrregullimet si të izoluara dhe të dallueshme por si pjesë e tërësisë së dinamikave të zhvillimit biologjik, psikologjik dhe social. Për këtë arsye ajo mund të konsiderohet fare si model bio-psiko-social i psikodiagnostikës alternative. Kështu për shembull, depresioni nuk është thjesht vetëm një model çrregullimi mendor por gjithashtu edhe tipar i personalitetit.

⁹¹ Për një shqyrtim të plotë të akteve referojuni “Manualit Psikodinamik” të grupit Task Force 2006 kapitulli i cituar nga Fonagy dhe Leichsenring

Manuali klasifikon një model të personalitetit depresiv me nëntipin e introjektivit (vetë-kritikut) dhe analitikun (reagim i lartë ndaj humbjes dhe refuzimit). Në rastet kur energjia e individit është në kahun Antilibidinal, atëhere modeli i personalitetit depresiv shfaqet me manifestimin e përkundërt në nivelin hipomaniak që karakterizohet nga energjia e lartë, frika nga marrëdhëniet e afërta me të tjerët etj.

PDM gjithashtu na jep sugjerimeve të trajtimit kur kemi të dhëna të mjaftueshme për të. Kështu, tipi introjektiv i përgjigjet më mirë interpretimeve dhe insight-it, ndërsa tipi analitik i përgjigjet më mirë marrëdhënies sociale. Tipi hipomaniak shpesh i shmanget angazhimeve dhe kësisoj nuk qendron gjatë në marrëdhënie.

Bazuar në këto të dhëna Gazillo, Lingiard dhe del Corno ⁹² zhvilluan më tej studimin e tyre për format e PDP-ve të lidhura me katër themelet e Personalitetit. Autorët i integruan këto këto kategori në Tabelën Psikodiagnostike që vlerëson Personalitetin në katër element bazë : 1) I Shëndetshëm 2) Neurotik 3) Kufitar dhe 4) Psikotik (Gordon dhe Bornstein ,2012; Gordon dhe Stoffey, 2014).

Për një **Personalitet të Shëndetshëm** tabela përfshin një rankim prej **9-10** pikavarazhesh. Subjekti është në Ego-Real të fortë në ngjarjet e veta jetësore me aftësi të përshtatshme përballuese (aftësitë coping). Një nivel Personaliteti Neurotik është i karakterizuar nga **6-8** pikavarazhe. Subjekti ka një kuptim bazik për identitetin, testimin e realitetit dhe marrëdhënies intime por ka mekanizma të kufizuar për përballime dhe një manaxhim të rregullim afekti po aq të kufizuar.

Niveli i **Personalitetit Kufitar (Borderline)** tabela jep një pikavarazh nga 3-5. Ky nivel përfaqëson një individ me një marrëdhënie të këqija dhe të paplota, vështërsi në kontrollin e impulsit dhe krijimin e vetë- identitetit, me mekanizma mbrojtëse si mohimi, çarja dhe identifikimi projektiv. Kësisoj subjekti qendron në kufij dhe sillet ndonjëherë si psikotik dhe ndonjëherë si neurotik. Ky nivel personaliteti lidh dy nivelet e Personalitetit Neurotik dhe Personaliteti Psikotik.

⁹² F.Gazillo, V.Lingiardi dhe F.Del Corno (2013) “ Prototipi Diagnostik Psikodinamik -2 ” New York 2018.

Personaliteti Psikotik mban një pikavarazh 1-2 pikë. Individu ndahet nga realiteti; mendimi i tij/i saj është kryesisht deluzional dhe ndonjëherë halucinant me një afekt dhe humor të sheshuar. Besimet patogjene janë qendër e funksionimit dhe udhëheqin stilin e jetës së individit. Është entiteti më disfunksional në termat e modeleve psikopatologjike.

2.6.2. Funksionimi Mendor-Aksi

Dimensioni i dytë i PDM-së, Funksionimi Mendor i Aksit-M jep një pamje të detajuar të aftësive që kontribuojnë në personalitetin individual dhe nivelin e përgjithshëm të shëndetit psikologjik ose shqetësimeve.

Ky aks vlerëson funksionimin mendor të individit në disa aspekte kryesore:

a. Proceset konjitive dhe afektive ku përfshihen:

1. Aftësia për rregullim, vëmendje dhe të nxënë;
2. Aftësia për krijimin e përvojave afektive, shprehja dhe komunikimi;
3. Aftësia për të menduar dhe reflektuar;

b. Identiteti dhe zhvillimi i marrëdhënieve ku përfshihen:

4. Aftësia për të diferencuar dhe integruar (identiteti);
5. Aftësia për krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve me të tjerët (përfshirë thellësinë, shtrirjen dhe konsistencën);
6. Rregullimi i vetë-vlerësimit dhe cilësia e përvojave të brendshme;

c. Aftësitë mbrojtëse dhe përballuese ku përfshihen:

7. Aftësia për kontrollimin dhe rregullimin e impulseve;
8. Funksionet mbrojtëse;
9. Aftësia për tu përshtatur, aftësia për rehabilitim i burimeve psikologjike;

d. *Vetëdijshmëria dhe drejtimi i vetes ku përfshihen:*

10. Aftësia-vetë-vëzhguese (mendësitë psikologjike);

11. Aftësia për mbajtjen e standardeve të brendshme dhe idealeve (moraliteti).

Secila nga aftësitë e përshkruara janë përkthyer në pohime specifike në konkursin Q-sort të zhvilluar në këtë studim. Identiteti normal bashkëshoqërohet me një përvojë të vazhdueshme në kohë dhe hapësirë për veten dhe tjetrin e rëndësishëm si dhe me aftësinë për të vlerësuar atributet dhe përvojat e brendshme të të tjerëve në thellësi, kompleksitet dhe plotësi. Ky identitet është gjithashtu i shoqëruar me aftësinë e individit për të investuar në kohë mbi interesat e veta profesionale, intelektuale dhe krijuese. Një dinamizëm i tillë linjëzohet sipas vlerave, opinioneve, shijeve dhe besimeve të individit. Individët me patologji të identitetit klinik paraqiten me një problematikë të dukshme në konceptimin e përvojave të vetes dhe të botës. Identiteti patologjik klinik shoqërohet me një fragmentarizim dhe paqëndrueshmëri të kuptimit të vetes dhe përvojës së tjetrit të rëndësishëm në kohë dhe hapësirë.

Përvoja subjektive e individit për veten dhe të tjerët është e varfër me mangësi të thellësisë, sipërfaqësore dhe e polarizuar. Mjedisi klinik e sheh individin me patologji të identitetit si të shoqërizuar me nivele të larta të tërheqjes nga trajtimi, dëmtim të aftësisë për vetë reflektim, vështërsi në mbajtjen e aleancës terapeutike, tendencë për plane konkrete në testimin e realitetit dhe tendencë për veprime impulsive

Shijet, opinionet dhe vlerat janë jo lineare, ato mund të jenë të marra nga të tjerët përreth mjedisit dhe po kështu mund të zhvendosen lehtësisht brenda individit dhe në mjedisin e tij.

Individi me patologji të identitetit ka mangësi në aftësinë e kuptimit të të tjerëve dhe nuk mund të reagojë ndaj çështjeve shoqërore që e rrethojnë. Përpos shfaqjes së qartë të kësaj forme të identitetit patologjik, një sërë patologjish të tjera të identitetit karakterizojnë pjesën më të madhe të çrregullimeve të rënda të personalitetit në DSM që nuk janë në fokus të këtij studimi.

2.5.3. Struktura e simptomës dhe përvoja subjektive (Aksi S)

PDM trajton në Aksin- S “*Shfaqjen e Simptomave dhe Interesave të subjektit*”. Këto janë modelet simptomatike të DSM-IV-TR por me fokusim mbi interpretimin e përvojën së subjektit mbi simptomën. Këto modele simptomash duhet të shihen në kontekstin e personalitetit të personit (Aksi P) dhe funksionimit mendor (Aksi M). Cilësia e përvojës të vështërsisë psikologjike ose sëmundjes dhe mënyrat me të cilat përpunohen ato kanë një rol qendror në formulimin e treguesve terapeutikë veçanërisht në vlerësimet e tipologjive të ndryshme psikike. Sipas teorisë psikodinamike, këto aspekte lidhen me strukturën e personalitetit të individit specifikisht në tematikat konfliktuale dhe dukuritë zinxhir që ato sjellin. Subjektiviteti në Aksin-S përshkruhet në termat e “modeleve afektive”, “përmbajtjes mendore”, gjendjet shoqëruese “somatike” dhe modelet shoqëruese “të marrëdhënieve” (Lingiardi, 2015)⁹³.

Proceset konjitive të vlerësimit të gjendjes subjektive të mirëqenies personale ose të vetë burimeve përshtatëse konsiderohen mekanizma qendrore në përshtatjen e individit në marrëdhëniet individ-mjedis- stresor (sëmundje). Vaillant (1971) duke përdorur një model evolutiv të mekanizmave mbrojtëse, dallon procese të ndryshme përshtatshmërie sipas shkallës së maturisë dhe përshtatshmërisë së tyre në zgjidhjen e konflikteve. Në rastin kur mekanizmat mbrojtëse nuk konsiderohen vetëm si procese disfunktionale dhe patologjike por edhe si përfaqëuese të Egos (Unit), ato lehtësojnë përshtatshmërinë (Steffens dhe Kächele, 1988). Në proceset e përpunimit të një sëmundjeje mekanizmat mbrojtëse do të jenë në shërbim të rregullimit intrapsikik (përpunimi i afekteve) ndërsa aftësia përballuese (coping) do të jetë e lidhur me përshtatshmërinë problem-zgjidhëse më afër realitetit.⁹⁴ Shfaqja e një mekanizmi mbrojtës krahas afekteve kërcënuese dhe përvojave që vënë në rrezik integritetin e Vetes, strukturon një formulim të aftësisë së individit për t’u përballur në mënyrë konstruktive me nevojat e vështërsisë psikike. Në fushën e psikodinamizmit kjo përvojë dhe mënyra sesi e përballon individi atë shihen si pasoja të tipareve të

⁹³ 49th Congress of International Psychoanalytic Association (IPA), Boston, USA

⁹⁴ Idem, 1988

personalitetit të atij subjekti në nivel dinamik, konjitiv, afektiv dhe të burimeve sjellore të brendshme. Shumë i rëndësishëm këssoj është konceptimi i strukturës së personalitetit (proceset e perceptimit të Vetes, tolerimi ndaj stresit, funksionet e ndryshme të Unit, tipologjitë e mekanizmave mbrojtëse, toleranca ndaj frustacionit dhe ankthit, aftësia vetë rregulluese, përvojat e realitetit dhe aftësia për të qenë i qendrueshëm në marrëdhënie). Një aspekt i rëndësishëm është bashkëlidhja konjitive-emocionale e individit me vetë sëmundjen e tij dhe burimet e brendshme që ai përdor për ta përballuar atë⁹⁵. Vihet në dukje rëndësia e mendimeve vetjake, ndjenjave dhe mënyrave, të pavetëdijshme ose jo, për të reaguar, për të përpunuar dhe hyrë në marrëdhënie në momentin e sëmundjes a vështërsisë. Në këtë formë mund të përforcohet hapësira që lejon individin për të marrë kthjelltësi dhe për të përpunuar mundësi të reja të bazuara në një imazh të ri për veten larg nga ndjesitë e ankthit dhe konfliktet intrapsikike. Individi do të ndihet i lehtësuar për faktin se impulset e “padëshiruara” nuk veprojnë drejtpërdrejt së jashtmi. Kënaqësitë shkojnë në motivimin e individit për të zhbërë mbajtjen e rolit të së sëmururit. Individi ndihet i ngarkuar si në jetën private si në atë profesionale, me një sërë detyrimesh sociale që në rastin e problemeve psikologjike ndihmohen të zhbëhen nga profesionistët e shëndetit mendor (Horn et al.1984). Janë pikërisht strukturat e marrëdhënieve disfunktionale që mbartin një rëndësi themelore në procesin psikoterapeutik pasi ato përbëjnë një pjesë të rëndësishme të problemeve që mbarten nga subjekti. Këto struktura disfunktionale modelojnë transferencën e individit në marrëdhëniet me të tjerët në jetën e përditshme ose marrëdhënien terapeutike kur është në mjedisë klinike. Mënyra sesi personi ka perceptuar dhe përjetuar marrëdhëniet e tij me të tjerët ka një kuptim të rëndësishëm në linjat psikodinamike. Në mjedisin klinik, marrëdhëniet sjellore që pacienti vë në zbatim në mënyrë të pavetëdijshme, bëhen të vëzhgueshme dhe provohen në strukturën e transferencës. Përvojat subjektive organizohen në bazë të emocioneve që i shoqërojnë. Organizimi subjektiv i kujtimeve dhe strukturave të rëndësishme kontribuojnë në përpunimin e informacioneve të tashme d.m.th të atyre pritshmërive që një person ka nga marrëdhëniet e së tashmes.

⁹⁵ Bishop 1987; Millstein dhe Irwin 1987; Streek et al.1986

Mbartja e marrëdhënieve, veçanërisht me figurat e referencës në fëmijëri dhe adoleshencë, kristalizohen në mënyrë intrapsikike me marrëdhëniet objektuale të brendësuar (si përfaqësimi i vetes dhe objektit) ndërsa imazhet e brendësuar ndërfiten në një kontekst ndjenjash, dëshirash, pritshmëriash dhe frikërash ndaj vetes dhe ndaj objektit të marrëdhënies edhe në moshën e rritur. Kernberg(1995) e konsideron këtë bashkim “vete-objekt-afekt” si strukturë primare të formësimit të strukturës intrapsikike. Skemat e brendësuar përfaqësojnë përpunimin subjektiv të përvojave dhe marrëdhënieve ndërpersonale. Kernberg argumenton mbi një formësim fillestar të Unit të ndarë nga Vetja e diferencuar nga objekti mëmësor ndërsa Stern (1985) dhe Emde (1988) e shohin fëmijën si qenie me elemente afektive, aktive dhe të aftë për vetërregullim të ndarë që në fillim nga kujdestari i tij. Fëmijët, pra, identifikohen me ato modele relacionale me të cilat kanë qartësuar strukturat e tyre⁹⁶ (Cierpka, 1992). Përfaqësimet dhe përvojat mund të sjellin shfaqjen e prediëozitave disfunksionale në sjelljet e pacientit duke kufizuar mundësitë e tij të ndryshimit. Kësisoj mund të pranohet se individ do të përdorë strukturën relacionale për të arritur një situatë të karakterizuar nga ndenjat e sigurisë, mirëqenies personale dhe besimit. Vetë strukturat ndërtojnë situata ku sendërtohen këto nevoja bazë dhe ku mbahet ekuilibri psikik i gjithkujt. Në identifikimin dhe shpjegimin e episodeve relacionale disfunksionale psikologu klinik duhet të mbajë parasysh dy perspektiva: të analizojë atë që po ndodh në transferencë-kundërtransferencë⁹⁷ dhe të mund ta përdorë këtë analizë në kuptimin e marrëdhënieve të tashme dhe të strukturave relacionale disfunksionale përsëritëse të subjektivit. Me një rëndësi specifike është edhe pikvështrimi që ka individ për veten d.m.th vlerësimi për karakteristikat strukturore. Kësisoj klinici në varësi të materialit të marrë duhet të formulojë ndërhyrjen ose planin e parandalimit.

⁹⁶ Përvojat e kujtuara përfshijnë imazhe kontraditore të Vetes dhe objektit dhe kontribuojnë në shfaqjen e konflikteve intrapsikike

⁹⁷ Sipas teorisë së Kontrollit dhe Zotërimit të Egos (CMT) transferenca dhe kundërtransferenca nuk janë procese ekskluzive të marrëdhënies klinike mes terapistit dhe klientit. Përkundrazi, ato janë procese që mund të përdoren në mënyrë të vetëdijshme sipas një skeme shkencore për të ekëlourar besimet patogjene dhe burimet e mbajtjes ose zhbërjes së tyre.

Për të formuluar një strategji të mirë parandaluese psikologu klinik analizon frustimet e subjektit në sistemin e tij jetësor. Më tej ai vlerëson ndryshimet në sistemin e tij ego-mbrojtës duke analizuar specifikisht marrëdhëniet e rivendosura mes vetes dhe të tjerëve të rëndësishëm. Në analizën e individëve me tendencë të sjelljes patogjene, vihet re një sistem delikat i egos i cili ka kushtëzuar grumbullimin e ndjenjave të shtuara të fajit dhe vetë-gjykitimit. Duke u akumuluar ndjenjat e fajit dhe vetë-gjykitimit, krijohet te subjekti një shtresë të re e mbivendosur e lidhur drejtpërdrejtë me rritjen e brendshme dhe vetë-vlerësimin. Ndikimi që përshfaq mbivendosja në vetë-vlerësim shfaqet rrjedhimisht në perceptimin e subjektit për veten dhe mënyrat e krijimit të marrëdhënieve me të tjerët. Një sistem jo funksional ego-mbrojtës shton po kështu mekanizmat disfunktionale të mbrojtjes dhe krijon ndërvartësi me marrëdhëniet e jashtme. Një disfunkcion prodhon një varg zinxhir disfunksionesh të cilat janë më të mëdha sesa shuma e çdonjërit prej tyre. Rritja e shtypjes së brendshme ndryshon marrëdhënien e shtresave të personalitetit dhe u jep atyre formacione të reja që në përbashkësi krijojnë simptomatologjinë. Në këtë linjë, marrëdhëniet e hershme disfunktionale shkaktojnë marrëdhënie të tjera të mbivendosura që në fund rezultojnë në patologjike dhe çorganizuese për krejt veprimtarinë jetësore të individit. Qëllimi përfundimtar i çdo strategjie parandalimi a ndërhyrjeje psikanalitike lidhet padyshim me kuptimin e thelluar të simptomave, me reduktimin e tyre si edhe me përmirësimin dhe mbajtjen e cilësisë së jetës në përballimin e modeleve keqpërshtatëse relacionale.

2.7. Sjellja keqpërshtatëse dhe tendenca e sjelljes keqpërshtatëse.

Kompulsionet e përsëritura janë një tendencë e trashëguar dhe prehistorike në të pavetëdijshmen që e pengojnë individin nga përeritja e disa veprimeve, veçanërisht atyre me karakter të dhimbshëm dhe shkatërrues. Nëse individi nuk mund të jetë autonom, të vetërregullohet në mënyrë të mjaftueshme dhe të reflektojë mbi veten, ai nuk ka të strukturuar një marrëdhënie të vlefshme me objektet mbështetëse qoftë të jashtme, qoftë të brendshme. Modelet strukturore të individit kthehen në shfaqje të ndërveprimit me tjetrin. Është thelbësore këssoj për psikologun klinik që të mund të

“bashkëbisedojë” me atë strukturë të individit që i përgjigjet kushtit kohor dhe hapësinor “tani dhe këtu” dhe të zhvillojë në këtë bashkëbisedim një linjë të ndërveprimit që lidhet me sfondin personal të zhvillimit dhe veprimtarinë e jetës së tij të përditshme. Në analizën e strukturave dhe marrëdhënieve disfunktionale duhen qartësuar edhe nivelet e zhvillimit strukturor të individit. Një model strukturor i një nentipi mazokist, për shembull që karakterizohet nga një zonë e lartë energjitike mes nënshtrimit, durimit të dhimbjes dhe marrjes së kënaqësisë kundrejt inatit, shpërthimit të brendshëm dhe mbizotërimit, mund të shfaqet në mënyra të ndryshme sipas niveleve të zhvillimit, të empatisë ose të kontrollit të impulseve. Në secilin prej këtyre niveleve aftësia e krijimit dhe mbajtjes së marrëdhënies të shëndetshme është disfunktionale dhe kthehet në manifestimin e kundërt si organizim i personalitetit të individit. Siç kanë argumentuar Schacht dhe Henry (1994) dhe Strupp dhe Binder (1984) modelet e marrëdhënieve funksionojnë si lente reaguese ndaj sjelljes keqpërshtatëse. Krijohen kështu cikle të bindjeve të pavetëdijshme disfunktionale që kushtëzojnë qendrueshmërinë dhe reziliencën ndaj vetes dhe tjetrit. Këto marrëdhënie janë të modeluara në mënyrë të pavetëdijshme që të influencojnë tjetrin për të konfirmuar bindjet e pavetëdijshme (Anchin,1982; Strupp dhe Binder, 1994).

KREU III

METODOLOGJIA

3.1. Aspektet historike të zhvillimit dhe standardizimit të metodologjisë Q

Në formën e vet klasike, Q-sort i përdorur në procesin psikoterapeutik (**PQS**), është një instrument me 100 pohime që strukturon një renditje gjuhësore për qëllimet e të përshkruarit dhe kuptimit klinik të ndërveprimit terapist-pacient në forma të përshtatshme për krahasim dhe analizë sasiore (Jones, 1985). Ajo që përfaqëson sot metodologjinë Q është shkruar për herë të parë në një letër në revistën shkencore “*Nature*” nga mjeku dhe psikologu britanik William Stephenson më 1935. Stephenson shërbente në atë kohë si asistenti i Charles Spearman, shpikësi i analizës faktoriale. Në këtë letër Stephenson trajton vëzhgimet e tij mbi mënyrën sesi ishte zhvilluar deri në atë kohë teknika e faktorit analitik nga Spearman, Thomson, Pearson dhe të studiues të tjerë për të lehtësuar vlerësimin dhe manipulimin e tipareve kryesore. Mund të vendoset kështu një kornizë e re e vlerësimit e quajtur “*studim sistematik i subjektivitetit*”.

Metodologjia Q u krijua për të eksploruar dimensionin subjektiv të problematikave ku shprehen këndvështrimet e ndryshme. Termi “metodologji Q” i trajtuar nga Brown⁹⁸ është shjeguar më tej në artikullin “*Të krijosh korrelancat e Personave dhe jo të Testeve*”, “*Themelet e psikometrisë: Sistemet Katër Faktoriale*” dhe në një shkrim tjetër “*Pikëpamjet Alternative mbi Korrelancat ndërmjet Personave*”⁹⁹.

Metodologjia Q është shpikur më 1935 nga Stephenson si një metodë që trajton të dhëna cilësore të subjekteve me analizë sasiore dhe faktoriale. Përtej procedurave statistikore ajo që Stephenson (1953) kërkoi të zhvillonte ishte që të kuptohej shfaqja e subjektivitetit në çfarëdo shtate të dhënë të jetës si p.sh në intepertime poetike, perceptimi i rolit organizativ, sjellje politike, kujdesi shëndetsor, konsumimi i pijeve

⁹⁸ Brown, “Q-methodology” 1991

⁹⁹ Correlating Persons Instead of Tests”, 1935; Foundations of Psychometry: Four Factor Systems, 1936; Alternative Views on Correlations Between Persons, 1939.

alkoolike etj.dhe vlerësimi i saktë statistikor i tij.

Është jeta e jetuar nga pika e personit që po e jeton që vëzhgohet në procedura sasiore dhe është subjektivisht në këtë kuptim që Metodologjia Q procedon edhe në fushën e kërkimit cilësor. Metodologjia Q “*kombinon fortësinë e traditave të kërkimit cilësor dhe sasior*”¹⁰⁰ dhe krijon një urë ndërmjet të dyjave (Sell dhe Brown,1984). Baza instrumentale e metodologjisë Q është teknika Q-sort, që përfshin renditjen e një sërë pohimesh variojnë nga të qenurit dakort në mos qenurit dakort (Larson, 1984).

Teknika Q-sort e propozuar nga Stephenson (1953) është studiuar në mënyrë sistematike nga Block dhe Haan (1971).

Ajo është një teknikë e vlerësimit me një dimension të gjerë përshkrimi, analize dhe aplikimi në fushën e shkencave psikologjike,mjeksores,menaxhimit dhe edukimit. Metoda Q konsiston në një seri pohimesh, numri i të cilëve varion sipas rasteve, secili përfaqësues i një aspekti sjellor ose psikologjik të individit ose situatës në shqyrtim. Sikundër është argumentuar nga Jones,Cumming dhe Pulos (1993) përmbajtja e Q-set mund të përpilohet sipas objektivave të kërkimit. Q-sort është një metodë matëse hipsative ¹⁰¹ ndaj pohimet renditen edhe brenda për brenda një rasti (nga më karakteristiket e personit dhe situatës në ato më me pak karakteristiket) me qëllim vlerësimin e specifikave dhe ndryshimeve.

Në kërkimet psikoterapeutike, teknika Q-sort është përdorur fillimisht për të vlerësuar rezultatet e trajtimit (Jones, Cumming dhe Pulos,1993). Block propozoi ndërtimin e metodës Q bazuar në konceptet relative të variableve me interes studimi dhe në ndërtimin e pohimeve përmes analizës së variancës për të verifikuar karakteristikat e vëzhguara (Block 1961; Block dhe Haan,1971). Në punimin e tij më të rëndësishëm “*Studimi i sjelljes:Teknika Q dhe Metodologjia e saj*” (1953) Stephenson qartëson parimet themelore dhe implementimin psikometrik të Q.

¹⁰⁰ Alternative Views on Correlations Between Persons,1939.

¹⁰¹ Matje hipsative është term i përdorur në psikologji për të treguar një tipologji specifike matjeje ku respondentët krahasojnë dy ose më shumë opsione të dëshiruara dhe marrin atë që ata preferojnë. Kjo matje quhet ndryshe edhe Shkalla e Zgjedhjes së Detyruar.

Sikundër shkruan Stephenson¹⁰²: “....instrumentat nuk u krijuan kurrë në Q për të vlerësuar diçka kategorike....mundësitë u lanë të lira për vlerësimin e subjektivitetit si një gjendje jo e mendjes,por e ndjesisë....”

Në metodologjinë klasike Q vlerësues klinikë lexojnë transkriptime të një terapie ose biseda klinike të plota dhe më pas përzgjedhin 100 pohime në Q-set në një kontinuum nga më pak karakterizuesja (kategoria 1) në më karakteristiken(kategorinë 9) (Ibrahimi dhe Qirjako,2011). Pjesët e mesme (kategoria 5) përdoren për pohimet neutrale ose të palidhura me kohën e proceduar. Secili pohim përmban përshkrime të dy anëve të kundërta të kontinuumit ku do të renditen Q. Vendosja në drejtim jo karakteristik nuk tregon se një sjellje ose përvojë është e papërshtatshme.

Në të kundërt, një renditje jo-karakteristike tregon se pohimi ka kuptim që është e rëndësishme të merret në përshkrimet e Q-sort. Pjesa më e madhe e pohimeve ka udhëzime ëcifikë që japin shembuj të dallimeve mes renditjeve neutrale dhe jo karakteristike.

Numri i kartave i vendosur në çdo kategori të Q-sortit (nga 5 në ekstremitete në 18 në mesin e kategorive neutrale) ka një shpërndarje normale dhe i kërkon gjykatësve të bëjnë vlerësime të shumëfishta ndaj pohimeve duke eliminuar kësioj efektet halo¹⁰³ (Block ,1961).

Si instrument vlerësimi në procesin klinik dhe psikoterapeutik,metoda Q përdor një orë të plotë vëzhgimi dhe regjistrimi të përgjigjeve të individit. Pohimet që vlerësohen lidhen me veprime të veçanta, sjellje dhe fjali. Duke qenë se kjo metodë në psikoterapi vlerëson edhe veprimet e terapistit përgjatë terapisë, është e dobishme marrja e një reagimi (feedback) nga subjekti për instrumentin e dhënë (Jones, Hall dhe Parke, 1991; Lambert dhe Hill,1994).

¹⁰² 1986,fq.246; marrë nga Paul Steiner-Qmethodology as a constructivist method fq.20(2009) Operant subjectivity: the international journal of Q methodology, 32(1-3) fq. 46–69, për më shumë rreth energjisë fizike, metafizike dhe shkakësore të ngjarjes referoju shkrimit

¹⁰³ Efekti Halo quhet fenomeni që ndodh teksa një person influencohet nga cilësitë e dëshirueshme,fortësia ,pamja fizike,sjellja apo ndonjë faktor tjetër kundrejt një personi tjetër apo situatë të caktuar .




Figure 0-1 . Hapat e Implementimit të Metodologjisë Q.

Në metodologjinë Q subjektiviteti është fokusi i interesit brenda dy konteksteve që lidhen me aspektet Q: mbledhja e të dhënave në formën e Q-sort dhe të dhënat e korrelacioneve e analizat faktoriale mes personave mbi këto rankime. Pavarësisht pyetjes kërkimore ndaj të cilës implementohet Q, rezultati është identifikimi i një numri të caktuar të pikëpamjeve ku secila pikëpamje përfshin më shumë sesa shprehjen e një “qendrimi” ndaj “një objekti” të dhënë. Rankimi Q si formë e mbledhjes së të dhënave u krijua nga Stephenson jo vetëm për të rritur shprehjen e subjektivitetit, por, edhe për të marrë me një formë të re të analizës së të dhënave, trajtimi i pjesëmarrësve si variable dhe jo si raste. Metodologjia Q studion grupet e pjesëmarrësve që rankojnë një sërë pohimesh në Q të marra si geshtalt dhe dimension subjektiv të përmbushjes. Këto pohime Q mund të analizohen më pas sipas lidhjeve korrelacioneve ndërpersonale për të krijuar një bashkësi (P-set) më të vogël faktorësh (konkursin). Pohimet e Q përzgjidhen sipas rëndësisë së tyre psikologjike për secilin pjesëmarrës (variabël) andaj ato pohime që mbartin vlerën më të lartë gjatë peshimit do të renditen më lart dhe kështu edhe për pohimet me peshën më të ulët.

Për interpretimin korrekt të saj Brown (1980\2008) ka rekomanduar një procedurë të përgjithshme të analizës në metodologjinë Q. Hulumtuesi mund të krijojë një matricë me pikavarazhet e faktorëve në analizë në formën e pikavarazheve

z (z-score) ose të renditjes(rankimit) të të gjitha pohimeve për secilin faktor. Pikavarazhi i rankimit përfaqëson matricën Q-sort të atij individi për faktorin e analizuar dhe pas rrotullimit faktorial të krijojë një tabelim me faktorët me peshën eëcifike më të lartë për individin apo grup-popullatat. Për të kuptuar më mirë faktorët dhe ndikimet e tyre për individin, hulumtuesi duhet të analizojë të veçantat dhe ngjashmëritë ndërmjet secilit faktor që do të analizohet.

Kështu, ne mund të klasifikojmë një gamë të madhe pohimesh heterogjene si “homogjene për një individ” (Stephenson, 1936) dhe pas analizës statistikore të pohimeve specifike të të gjithë individëve të kampionit, të krijojmë një matricë me të dhënat e përgjithshme. Q -sort i vjelë nga një individ mund të krahasohet më tej me q-sort të pjesmarrësve të tjerë (korrelacionet ndërsujektive). Secili prej këtyre faktorëve identifikon një bashkësi ndër-korrelacionale Q që shpreh një pikëpamje të bashkëndarë të subjekteve mbi çështjen ose dukurinë e studiuar.

Metodologjia-Q është përdorur si në terapinë psikodinamike, në atë konjitive-sjellore, me klient të qëndësuar, geshtaltiste dhe racional-emocionale (Jones, Cumming dhe Horowitz, 1998). PQS ka treguar besueshmëri dhe vlefshmëri përgjatë studimeve dhe modeleve të ndryshme të trajtimit. Qëllimi i një metodologjie të këtillë është të ofrojë një set pohimesh për të kuptuar dimensionet e ndryshme që analizohen. Një shembull është dhënë nga Jones (1985) në “*Procesin Psikoterapeutik Q-sort*”¹⁰⁴ përdorur për të përshkruar procesin terapeutik, vlerësuar marrëdhënien mes proceseve dhe rezultateve dhe analizuar natyrën e ndryshimit në procese të ndryshme.

Ky instrument mund të aplikohet edhe ndaj pamjeve video, audio dhe traskripteve të të gjithë seancave psikoterapeutike (instrument panteorik¹⁰⁵) për tre aëekte themelore:

- **Qendrimet**, sjelljet dhe përvojat e shprehura të subjektit.
- **Veprimet** dhe qendrimet e klinikistit.

¹⁰⁴ Psychotherapy Process Q-sort (PQS).

¹⁰⁵ Matjet panteorike përdoren për të vlerësuar përputhshmërinë e asaj që thuhet verbalisht me sjelljen e shfaqur.

- **Natyra e ndërveprimit** diadik ndërmjet subjektit dhe klinikistit, mjedisi dhe atmosfera e seancës.

Për një aplikim korrekt të instrumentit është e nevojshme që vëzhguesit të mbajnë një qendrimin deatashues nga procesi i terapisë, t'i përmbahen fakteve, të jenë sa më objektivë të jetë e mundur dhe të mos jenë të influencuar nga parakonceptet teorike ose nga reagimet personale ndaj subjektit a klinikistit. Në çdo kategori, ka një numër të përcaktuar pohimesh për të krijuar shpërndarjen normale (Pulos dhe Jones, 1987; Jones dhe Windholz 1990; Jones, Cumming dhe Horowitz 1998; Jones, Parke dhe Pulos, 1992).

Implementimi i metodologjisë përmes rankimit Q (Q-sorting) është konsideruar si diçka inovatore në shqyrtimet e studiuesve ndaj punës së Stephenson (Eysenck,1952; Cronbach dhe Glesser,1954¹⁰⁶; Esrock, 2005; Kim,2008). Bannister dhe Fransella (2004) argumentojnë se pikëpamjet e individëve janë të ndryshme nga njëri-tjetri andaj metodologjia Q mund të trajtohet si një teknikë reduktuese e teorisë së konstruktit të personalitetit.

Në ditët e sotme metodologjia Q është gjerësisht e përdorur në shkencat sociale,shkencat infermieristike dhe mjekësore, mjekësinë bihejvorale dhe veçanërisht në psikologji (Stainton Rogers et al.,1995; Eccleston, Williams dhe Stainton Rogers, 1997; Stenner et al., 2000; Stenner, Cooper dhe Skevington, 2003; Stenner, 2015). Eccleston et al. (1997) e kanë përdorur metodologjinë Q për të krahasuar të dhënat e marra nga pacientët me dhimbje kronike me ato të profesionistëve që kujdeseshin për ta. Studime të tjera mbështetëse përfshijnë punimet e Collins, Maguire dhe O'Dell (2002) mbi perceptimet e duhanpirësve mbi sjelljen e tyre ndaj tymosjes. Studimet e kryera nga Rayner dhe Warner (2003), James dhe Warner (2005) u fokusuan në problematikën e vetë dëmtimit. Ata përdorën kampione *P* nga popullata e përgjithshme, pacientë dhe specialistë të fushës.

Të rëndësishme gjithashtu janë edhe kërkimet e Jordan, Capdevila dhe Johnson (2005) mbi ekëlorimet e imazhit të trupit te një kampioni grash që sapo kishin sjellë

¹⁰⁶ Gjendur në artikullin e Stephenson mbi argumentat e Cronbach&Glesser për efikasitetin e metodologjisë Q,fq.331-333

në jetë fëmijë. Një studim tjetër i Watts dhe Stenner (2005) për dashurinë mes partnerëve paraqet mundësinë e ofruar nga metodologjia Q për të lehtësuar problematikat sociale komplekse. Në këtë studim, krijimi i Prototipit të Personalitetit u krijua pas vlerësimit të përgjigjes së pohimeve Q (konkursi) ndaj faktorëve të krijuar pas peshimit të secilës bashkësi.

Ne vendosëm një kufi të konsideratës $\leq 0,4$ për domethënien e peshës ndaj çdo përgjigje të anëtarëve në studim. Më pas, variablet iu nënshtruan peshimit faktorial dhe studimi është përqëndruar në ato variable që nga peshimi faktorial kanë rezultuar më të lartë sesa pragu i vendosur 0,4. Në mënyrë të detajuar të dhënat e këtyre rezultateve mund të gjenden në kapitullin e analizës së të dhënave. Rezultati i marrë nga studimi i Q është një identifikim holistik i një diapazoni pikëpamjesh të lidërve shkollorë.

Nga një paraqitje e tij në një konferencë ndërkombëtare të shkencave Ekonomike, mbështetur në shkrimet e Beryl C. Curt për Metodologjinë Q (1994) citojmë: *‘Ajo që ne po kërkojmë si metodë është e kundërta e korrelacionit të tipareve, diçka që mund të korrelojë struktura të tëra leximesh, që të mund të shpaloshim mënyrën sesi ato copëzohen në histori të përngjashme me strukturën e parë’*¹⁰⁷

Në fazën pilot të testimit të Q në këtë studim, pjesëmarrësit zgjedhën pohimet në një shpërndarje 3, 5, 8, 12, 16, 18, 16, 12, 8, 5, 3. Pasi pjesëmarrësi e kishte plotësuar Q-sortin, ne i regjistruam numrin e pohimeve të renditura në një matricë.

Në fund ne drejtuam disa pyetje me fund të hapur për të marrë një reagim vlerësues nga pjesëmarrësit tanë (feedback) :

“A keni dëgjuar më parë për PDM ?A ishte ky studim ndihmës për ju? “

“Si e vlerësoni ju këtë metodë ?”

“Si ju ndihmoi kjo metodë ?”

“A vërejtët diçka në stilin tuaj të lidërshpit që nuk e kishit vlerësuar më parë ?”

“Cili pohim ishte më karakteristik dhe më pak karakteristik për ju?”

“Cili pohim ishte më i vështiri për tu trajtuar?”

¹⁰⁷ Curt,1994,fq.119-120

“Cili është stili i leadershipit më karakteristik apo më pak karakteristik për ju?”

“Cili nga pohimet ju përshkruan më mirë dhe cili përshkruan më mirë kolegun tuaj (qoftë mësues qoftë drejtues)?”

“Nga gjithcka e zhvilluar, si mund ta përshkruani orjentimin e sjelljes tuaj?”

Përgjigjet e grumbulluara nga pjesëmarrësit shërbyen për të krijuar jo vetëm një panoramë të nevojave dhe aspiratave të lidervë por edhe për të kuptuar aëktet aplikative të metodës, si dhe të planifikimit të konkursit në testin e metodologjisë Q.

Metoda Q konsiderohet e përshtatshme për kërkimin dhe ekuilibrimin e përvojave subjektive, perspektivave dhe besimeve. Në të njëjtën kohë ajo lehtëson identifikimin e ngjashmërive, ndërtimin e kategorive të mëdha të fenomeneve që studiohen dhe shpjegimin e strukturave e marrëdhënieve brenda dhe ndërmjet këtyre kategorive (Stainton Rogers, 1991; Stenner, Dancey dhe Watss, 2000).

Në procedurën e saj standarde në metodën Q pjesëmarrësit pyeten mbi një grup pohimesh që përfaqësojnë një shumësi opinionesh dhe perëektivash mbi fenomenin që po studiohet. Këto pohime shkallëzohen në një nivel dikotomik me shkallë Likert për të krijuar një Q- set me pohimet që përfaqësojnë çdo individ (Watts dhe Stenner, 2005). Çdo pohimi i përkon një numër i kodifikuar në një letër të veçantë. Pjesëmarrësit përzgjedhin pohimet sipas udhëzimeve të dhëna nga kërkuesi. Çdo shabllon i plotësuar hidhet si e dhënë. Për këtë qëllim mund të përdoret edhe programi i posaçëm statisikor sikundër PQ-Method. Shpërndarja piramidale ose Q-sort përdoret për të identifikuar një numërim të faktorëve që përfaqësojnë forma e të kuptuarit të pjesëmarrësit.

Një nga avantazhet e kësaj metode është se ajo krijon një instrument objektiv mbi përshtypjet dhe formulimet e personalitetit që kryejnë vëzhguesit. Kështu mund të vlerësohet shkalla e formimit të koncepteve të njerëzimit. Ndryshe nga metodat e tjera të vetë-raportimit që mund të mbartin aspekte subjektive dhe kështu të jenë dyshuese në vlerat e rezultateve që paraqesin. Në këtë metodologji, pjesëmarrësi jep përgjigjet e tij por vlerësimi në pikëprerje statistikore i këtyre përgjigjeve në një diferencë kohore deri në 6-muaj shton aspektet e vlerësimit objektiv të këtij instrumenti. Subjekti përshkruhet ashtu sikundër shfaqet dhe kuptohet nga vëzhguesit në kohën e

vëzhgimit. Pohimet “vendosen sipas radhës së përfaqësimit (ose domethënies) për individin, ato më karakteristiket për të kanë pikavarazhet më të larta, ndërsa ato më pak karakteristiket kanë pikavarazhe të ulëta.”¹⁰⁸ Në ndryshim nga krijimi i saj fillestar në versionin e tashëm standard të setit Q janë të përfshira nëntë kategori ku në njerën anë të kontinuumit vendosen pohimet më karakteristike të personit që po përshkruhet si më “pozitivët” për të dhe në anën tjetër vendosen “pohimet më karakteristike negative” për përshkrimin e personalitetit.

Për çdo pohim numri i vendosur në kategori regjistrohet si vlera e atij pohimi për përshkrimin e personalitetit.

Me të dhënat e hedhura, dhe të përgatitura për analizën e mëtejshme, procedura është e plotësuar. Më tej pohimet Q përzihen dhe vendosen në një procedim tjetër.

Në kushtet e një shpërndarje universale për pohimet Q nga vlerësuesit krahasimet janë të qarta dhe të mundura për t’u operuar. Në të gjitha rrethanat e Q-sortit kuptimi psikologjik i dallimeve si të subjektit si të vlerësuesit mund të jetë i analizueshem përmes përmbajtjeve të pohimeve Q. Renditja e pohimeve në mënyrë të tillë që të përshkruajë një individ është një detyrë e vështirë (Frank,1956). Informacioni i mbledhur në stadin e analizës së procesit Q varion sipas studimit të variablilit (Watts dhe Stenner,2005). Nëse pas peshimit specifik dhe rrotullimit varimax, identifikohet një faktor si lidershipi (komponent) do të thotë se lidershipi është një aftësi e vetme që do të merret në analizë. Por, nëse identifikohen dy a më shumë faktorë si personaliteti dhe lidershipi, do të thotë se të dy faktorët janë komponentë të pavarur nga njëri-tjetri (ortogonalë). Në metodologjinë Q analiza zhvillohet duke vënë në korrelacion të dhënat e mbledhura nga pikëpamjet e pjesëmarrësve një për një që marrëdhëniet ndërmjet tyre të plotësojnë panoramën e Q-sort. Pjesëmarrësit janë më pozitivë ndaj pohimeve që i përshkruajnë ata në mënyrë psikodinamike dhe më negativë për pohimet që tentojnë të tregojnë problematikat e tyre.

¹⁰⁸ Stephenson 1936, fq.357

Lidhja e korrelacioneve variabël për variabël krijon një matricë korrelacionale që mbledh të gjitha të dhënat e individëve. Kur të gjitha të dhënat reduktohen përmes analizës faktoriale, po kështu ndikohen edhe peshimi i faktorëve dhe i të dhënave statistikore përshkruese si mesatarja, mesorja dhe deviacioni standard.

Krijimi i faktorëve i nënshtrohet më tej rrotacionit varimax. Pas faktorëve me peshën më të lartë të vendosur përpara faktorët e tjerë kanë vlerë më të pakët sesa 1.00 (Watts dhe Stenner, 2005).

Vlerësimi i secilit faktor krijon pikavarazhe për secilin pohim të cilat kur bashkohen në formën e Q krijojnë një shpërndarje që finalizon një Q-sort të plotë për secilin faktor.

Ky vlerësim për secilin faktor quhet *grup faktoral* dhe është ky grup që mund të vendoset më tej për interpretime. Interpretimi në metodologjinë Q përfshin krijimin e një sërë të dhënash secila shpjeguese e pikëpamjeve të dhëna nga secili faktor. Kësisoj mund të rindërtohet pikëpamja subjektive e shprehur në grupin faktorial në përfaqësime numerike. Interpretimi mbështetet te rankimi si i tërë ose geshtalt dhe jo në pikëpamjet e veçanta të individëve.

Më pas të dhënat analizohen përmes paketave të programeve kompjuterike si PQMethod (Schmolck, 2002), PCQ (Stricklin dhe Almeida, 2001) ose SPSS.

Në studimin tonë të dhënat përshkruese janë koduar dhe analizuar me programin SPSS versioni 23 dhe të dhënat grafike piramidale me programin PQMethod sipas konsulencës teknike të prof.Schmolck.

3.2. Krijimi dhe implementimi i konkursit.

Çdo test Q fillon me ndërtimin e një konstrukti të vlerësuar sipas kushteve të Q. Në terminologjinë e Q-së ky konstrukt quhet “Konkurs”. Brown në “*Manualin Udhëzues të përdorimit të Metodologjisë Q*” (1993) e përshkruan konkursin si një “*rrjedhë të komunikimit e lidhur me cilindo argument...nga konkursi mund të merren kuptime të reja, të parashtrihen ide të reja dhe të hapen orizonte të reja*”¹⁰⁹.

Krijimi i konkursit lidhet pra në një formë vektoriale, me ndikimet që pikvështrimet e një dukurie të jetës së përditshme të një individi mban mbi një

¹⁰⁹ fq.94

çështje të caktuar si dhe të ndikimit që ky vështrim ka mbi cilësinë e të njëjtës dukuri në jetën e individit.

Është e rëndësishme që studiuesit dhe kërkuesit që aplikojnë metodologjinë Q të mos përforcojnë pozitivisht të njëjtin opinion më tepër se dy herë dhe të mos i ndikojnë subjektet me pohime dikotomike kundërthënëse (McKeown dhe Thomas, 1988). Konkursi është i krijuar në bazë të qëllimit dhe synimit të studimit të ndërmarrë. Ai mund të përfshijë komunikime të përditshme, forma të shumta të artit pamor, fotografi, abstrakte, revista intervista, video klipe, pamje të realizuara në rrjetet sociale apo çdo burim tjetër të dukurive psikosociale.

Është detyrë e studiuesve që të filtrojnë më pas nga shumësia e informacionit të mbledhur të pohimeve Q që janë më shumë të përshtatshme me qëllimin dhe tërësinë e studimit të tyre. Në fillimet e prezantimit të metodës Stephenson (1953) përdori një konkurs prej 100 pohimesh të ndërvarura.

Në mesataren e studimeve mund të përdoren rreth 40-50 pohime por varësisht nga qëllimi dhe tipologjia e studimit ky numër është i ndryshueshëm. Në metodën e vet klasike pohimet e Q pasi janë filtruar i paraqiten në format kartografik dhe pjesëmarrësit emërtohen si Modeli-P. Për shkrimin e kartave të konkursit të Q-së autorët sugjerojnë fjali të thjeshta dhe të kuptueshme nga pjesëmarrësi. Ato duhen testuar paraprakisht në një grup pilot për të kuptuar qartësinë dhe përputhshmërinë. Për këtë argument Donner¹¹⁰ ka sugjeruar se :

- Të gjitha fjalitë duhet të jenë të shkruara me të njëjtin stil gjuhësor;
- Duhet shmangur fjalitë që tregojnë ekstremite;
- Fjalitë duhet të kenë parimin e “konkurrencës së besueshme” me njëra-tjetrën;
- Duhet shmangur format mohuese të dyfishta.

Në punimin e Jan van Excel¹¹¹ është argumentuar edhe një nga çështjet më të polemizuara të metodologjisë Q, vlefshmëria dhe mundësia e saj për përgjithësime në popullatë (Thomas dhe Baas, 1991).

¹¹⁰ 2001,fq.27

¹¹¹ Q/methodology – a sneak preview, 2005,fq.6-9

Më konkretisht van Excel shkruan: “..*tipologjia më e rëndësishme e vlefshmërisë së Q është mundësia e replikimit që ajo ofron; d.m.th. të shfaqë këndvështrime të ndryshme mbi një çështje ndaj pohimeve Q të ndryshme dhe kur administrohet në individë të ndryshëm*”(fq.6). Rezultatet e metodologjisë Q nuk janë të përgjithësuara për të gjithë popullatën por për një tipologji të caktuar faktorësh a popullata specifike (Brown,1980).

Në këtë studim ne krijuam një konkurs fillestar prej 100 pohimesh në fazën prelimare të cilat u reduktuan në 77 në fazën përfundimtare të testit. Meqënëse metodologjia Q është e fokusuar te korrelacioni i përgjigjeve të individit, pohimet u ravijëzuan për të dy kategoritë e liderit “*mësues*” dhe “*drejtues i institucionit arsimor*” në një total prej 154 pohimesh. Secili test mbart pohime të konstruara për matjen e Nivelit të Personalitetit, Ndikimin e Mjedisit Shkollor dhe të Komunitetit dhe të Stilit të lidërshiptit të individit sipas funksionit respektiv.

Të dhënat e konstruktit të pohimeve u mblodhën nga shqyrtimi i literaturës mbi “*Marrëdhëniet me Objektin*” dhe “*Nivelin e Personalitetit*” studime dhe artikuj shkencore mbi praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, të dhëna burimore nga kronika të lidhura me lidërshiptin në shkollë dhe fakte të raportuara gjerësisht në media për situatën e shkollës dhe mësuesit në kontekstin Shqiptar.

U përcaktuan kështu 4 konstrukte thelbësore (faktorë) në të cilat u vendosen pohimet sipas nivelit të përfaqësimit dhe mbizotërimit psikologjik, të mjedisit a stilit të lidërshiptit që mbartnin. Grupimi dhe kategorizimi i të dhënave u krye në mënyrë të mëvetësishme për secilin qytet ndërsa renditja e pohimeve sipas kategorisë mbizotëruese është e njëjtë.

Konstrukti i pohimeve të lidhura me identifikimin e nivelit të personalitetit është ndihmuar nga profesorja udhëheqëse dhe konsulentët shkencorë në përputhje me fokusin kryesor dhe instrumentat vlerësues mbështetëse të këtij studimi.

Në vlerësimin e PDC-së në analizën e të dhënave të para-testimit në këtë studim u volën këto rezultate mbështetëse: Besueshmëria e test-ritetestit për nëntë shkallët shkon nga .77 në .89 ($p < .001$). Koeficienti alfa për shkallën është .95 që tregon një nivel të lartë të konsistencës. Korrelacioni mesatar ndërmjet shkallëve është .67.

Mesataret e shkallës individuale shkojnë nga 4.73 në 6.63. Mesatarja në shkallën

totale është 5.76 ($SD = .62$).

Në formë të përmbledhur, analiza tregoi stabilitet të lartë dhe konsistencë të brendshme. Ashpërsia e Simptomave të besueshmërisë së test-ritetit është .87 ($p < .001$) çka gjithashtu tregojnë stabilitet të lartë.

3.2.1 Instrumentat mbështetëse të metodës: tabela e organizimit të personalitetit(PDC).

Tabela Psikodiagnostike (PDC) e krijuar nga Gordon dhe Bornstein më 2012 synon të vlerësojë tërësinë e Akseve të PDM si për fëmijët/adoleshentët edhe për të rriturit. Versioni i përdorur në këtë studim është për të rritur duke mbajtur parasysh shtrirjen moshore të mësuesve dhe drejtuesve arsimorë.

Organizimi i “Tabelës Psikodiagnostike” është mbështetur në të dhënat teorike, shkencore dhe empirike të siguruara nga kërkimeve të shumta vlerësuese.

Tabela është krijuar për të qenë një metodë fleksibël, idiografike dhe e kuptueshme nga specialistët e psikologët e orjentimeve të ndryshme. Ajo u shërben rritjes së kuptimit mbi dimensionin e strukturën e personalitetit dhe integritet të PDM-së me manualët e tjera klasifikuese të simptomave si DSM dhe ICD. PDC-ja është një tabelë kategorike dhe dimensionale me një shtrirje që varion nga (1) “shumë i turbulluar” në (10) “i shëndetshëm”.

Për shembull, nëse një subjekt plotëson ndonjë nga kriteret e katër themeleve të përmendura më parë (turbullim i nivelit të personalitetit, mjedis shkollor jo stimulues dhe komunitet jo mbështetës), atëherë për të mund të vendoset një tendencë e tiparit mes 7 ose 8 pikëve ose të OP Neurotik me nivel të Tërhequr (Inhibitor).

Në këtë formë të organizimit të personalitetit individ do të ketë shfaqje sjellore si “ndjesia e frikës nga të qenurit i kritikuar e pengon në arritjen e qëllimeve dhe kështu ky individ do të jetë pasiv dhe i tërhequr”. Klinikisti ose psikologu klinik në këtë rast mund të vendosë menjëherë një diagnozë diferenciale pa e trajtuar individin si të sëmurë por si me nivel Neurotik të Organizimit të Personalitetit.

Në vazhdim të zhvillimit të versionit të dytë të PDM më 2017 autorët kanë krijuar versionin e dytë të PDC-së i azhornuar sipas recensioneve dhe formulimeve të

reja të PDM(Gordon dhe Bornstein, 2015). Në këtë studim janë përdorur të dhënat e grumbulluara sipas versionit të parë të PDC-së.

PDC përbëhet nga pesë ndarje të cilat përfshijnë:

1.*Organizimi i Personalitetit* ku përdoren shtatë aftësië e PDM-së për të vlerësuar nivelin e ashpërsisë.Në fillim psikologu klinikist rendit secilën nga shtatë aftësitë nga 1 (e ashpër) në 10 (e shëndetshme)e më pas përshkallëzohet struktura e përgjithshme e personalitetit të individit nga 1(psikotik) në 10 (i shëndetshëm).

2.*Strukturat e personalitetit* ku kryhet një shqyrtim i strukturave të personalitetit sipas përshkrimit të Aksit P dhe PCA të PDM.Psikologu klinikist kontrollon sa prej përshkruesve në këto Akse i përshtaten individit dhe përcakton strukturën ose çrregullimin e personalitetit mbizotërues. Në fund përcaktohet niveli i ashpërsisë nga 1-10.

3.*Funksionimi Mendor* ku psikologu klinikist rendit nga 1-10, nëntë përshkruesit të funksioneve kryesore mendore të individit. Më pas, përcaktohet funksionimi i përgjithshëm mendor përmes të njëjtës shkallë, me variancë nga 1 (me deficite të ashpra) në 10 (niveli optimal).

4.*Simptomat*. Psikologu klinikist krijon një listë me 4 ose më shumë simptomat a shqetësimet subjektive dhe rendit shkallën e tyre të ashpërsisë nga 1 (e ashpër) në 10 (e lehtë).

5. *Aspektet kulturore dhe kontekstuale* ku specialisti mban në konsideratë sesa faktorët kulturorë dhe kontekstuale ndikojnë në përshfaqjen e simptomave.

Për vlerësimin e vlefshmërisë dhe qendrueshmërisë së PDC autori (Gordon, 2009) kreu fillimisht pyetësorë online me 511 psikologë dhe specialistë të shëndetit mendor nga vende të ndryshme të ndryshme të botës, pjesë e të cilëve ishte edhe ekipi shqiptar i këtij studimi. Më pas,u testua vlefshmëria e PDC me 38 psikologë të cilët njihnin procedurën dhe kishin përdorur MMPI-2¹¹² me pacientët psikoterapistët,paaftësi dhe në shërbimin penitenciar. Nga testimi i besueshmërisë

¹¹² Minnesota Multiphasic Personality Inventory-2, test psikometrik i standardizuar për vlerësimin e personalitetit dhe psikopatologjisë së të rriturit. Versioni i dytë i testit është botuar më 1989 nga Butcher et al. dhe përdorimi i shkallëve të këtij instrumenti lidhet me korrelacionin shumë të fortë dhe stabilitetin në përdorimin klinik, vlefshmërinë e PDC dhe konkursin e Q të përdorur në këtë studim.

psikologët pjesëmarrës, vlefshmëria për shkallën e Organizimit të Personalitetit është .92 ($p < .001$); për Ashpërsisë dhe Çrregullimin e Personalitetit është .89 ($p < .001$); për 9 aftësitë e Funksionimit Mendor varion nga .77 në .89 ($p < .001$) dhe për Ashpërsinë e Simptomave është .87 ($p < .001$). Të gjitha konstruktet e PDC-së tregojnë korrelacione të forta me pikavarazhet e MMPI-2 (Gordon, Stoffey dhe Perkins, 2013).

Shkallët e MMPI-2 për Skizofreninë (Sc), Histerinë (Hy) dhe Fortësinë e Egos (Es) treguan një vlefshmëri të mirë për elementët kategorikë të niveleve të Organizimit të Personalitetit psikotik, kufitar dhe neurotikë. Këto elementë kategorikë u volën nga ndarja në 10 pikë e shkallës së Organizimit të Personalitetit : psikotiku (vlera 1-3, $nr = 13$), borderline (vlera 4-6, $nr = 52$) dhe neurotikë (vlera 7-10, $nr = 33$).

Për shkallën e nivelit psikotik autorët parashikuan një mesatare shumë më të lartë sesa mesataret e shkallëve Hy dhe Es të marra së bashku.

Nga analiza e të dhënave të kryqëzuara u vërtetua se Sc është shumë më e lartë sesa Es ($M = 85.77$, $SD = 19.55$ vs. 34.31 , $SD = 6.78$, $p = .001$) dhe pak më e lartë sesa Hy ($M = 85.77$, $SD = 19.55$ vs. 72.69 , $SD = 18.46$, $p = .017$).

Për vlefshmërinë e nivelit kufitar, autorët parashikuan se mesataret e shkallëve Sc dhe Hy nuk duhej të kishin dallime domethënëse por, të dyja duhej të ishin shumë më të larta sesa mesatarja e Es: Sc dhe Hy nuk janë shumë të dallueshme por Sc është shumë më e lartë sesa Es ($M = 62.21$, $SD = 12.31$, vs. 43.58 , $SD = 10.25$, $p = .001$) dhe Hy është më e lartë sesa Es (64.21 , $SD = 12.31$ vs. 43.58 , $SD = 10.25$, $p = .001$).

Për nivelin neurotik, u parashikua se shkallët Es, Sc dhe Hy kishin një shpërhapje mesatare dhe se Fortësia e Egos shkonte kah shpërndarjes mesatare.

Tab. 0.1 Përmbledhje e Korrelacioneve të Test-ritestit, Mesataret dhe Deviancat Standarde për 7 Elementët e Shkallës të Organizimit të Personalitetit të Përgjithshëm.

Elementët	<i>r</i>	<i>M</i>	<i>SD</i>
• Identiteti		.84*	5.50 1.68
• Marrëdh. Objektiv	.83*	4.85	1.75
• Toler.Afeksi	.85*	5.40	1.59
• Rreg.Afeksi	.86*	4.91	1.63
• Integr.Superegos	.80*	6.22	2.00
• Testim Realiteti	.90*	6.84	1.93
• Resiliencia Egos	.69*	5.83	1.87
• Shkalla përgjithshme	.92*	5.50	1.68

*p< .001

Tab. 0.2 Përmbledhje e Korelacioneve Test-Ritest, Mesataret, dhe Devimiet e Standardit për 9 Shkallët e Funkcionimit Mendor

Funksionimi Mendor	<i>r</i>	<i>M</i>	<i>SD</i>
• Aftësia për Vëmendje,Kujtesë ,Të mësuar dhe Inteligjencë	.89*`	6.63	1.92
• Aftësia për të krijuar Marrëdh. dhe Intimitet	.80*	4.73	1.75
• Cilësia e Përvojave të Brendshme	.84*	5.26	1.63
• Kuptim afektiv,Shprehje dhe Komunikim	.77*	5.88	1.70
• Niveli i Mbrojtjeve ose Mekanizmat Coping	.83*	5.31	1.69
• Aftësia për të Formuar Përfaqësime Ndërkmbt.	.82*	5.48	1.58
• Aft.për Diferencim dhe Integrim	.87*	6.03	1.90
• Aftësia Vetë-Vëzhguese	.89*	5.94	2.12
• Kuptimi Realist i Moralitetit	.83*	6.53	

*p<.001 Burimi: "Operacionalizimi i PDM:Një studim paraprak për Tabelën Psikodiagnostike/Operationalizing PDM:A preliminary

study of the Psychodiagnostic Chart (PDC) Gordon,R.M. dhe Stoffey,R.Ë.(2014)Buletini Menninger Clinic,78,(1).

Teksa simptomat e raportuara nga subjekti nuk përfaqësojnë ndonjë lidhje korrelacionale me kriteret e njohura diagnostike si p.sh. Depresioni Madhor (në DSM-IV-TR), funksionimi i tij/i saj mendor nuk ndikon në organizimin psikik e Personalitetit dhe kështu subjekti do të mund të trajtohet më mirë si Personalitet me tendencë Depresive (në PDP).

Ne mund të përcaktojmë në këtë linjë forcësinë e funksionimit të Egos sipas një tendence të Personalitetit përkundrejt sëmundjes. Nëse për shembull lideri me Personalitet Depresiv do të jetonte në një mjedis të izoluar social për një kohë të caktuar, ai/ajo ka më tepër gjasa të zhvillojë gamën e plotë të simptomave të Depresionit Madhor.

A. Pyetësi i besimeve patogjene (QPC)

Për të ndihmuar krijimin e konstruktin e testit Q, kategorizimin dhe interpretimin diagnostik të Akseve të PDM-së dhe Organizimin e Personalitetit (PDC) si elemente të arritjes së qëllimit të këtij studimi janë ndërtuar dhe përdorur edhe dy instrumenta mbështetës të profesorëve të Universitetit të “La Sapienza” Gazzillo dhe Lingardi (2008).

“*Pyetësi i Shqetësimeve Bërthamë*”(CPQ)¹¹³ është i përbërë nga 18 shqetësime bërthamë të përshkruar në Aksin P të PDM-së të shoqëruara me të gjitha çrregullimet e personalitetit¹¹⁴. Testuesi duhet të vlerësojë përmes shkallës Likert me pikavarazh 7 (1=jo përfaqësues; 7= shumë përfaqësues) nëse sjelljet, mendimet, emocionet dhe motivacionet e subjektit mund të pasqyrojnë shqetësimet psikologjike të përshkruara në Aksin P.

“*Pyetësi i Besimeve Patogjene* “(QCP) (Lingardi dhe Gazzillo, 2008) përbëhet nga 36 besimet patogjene të përshkruara në Aksin P të PDM, të shoqëruara me secilin tip të çrregullimeve të personalitetit. Testuesi duhet të vlerësojë përmes shkallës Likert me pikavarazh 7(1=jo përfaqësues; 7= shumë përfaqësues) nëse sjelljet, mendimet, emocionet dhe motivacionet e subjektit mund të pasqyrojnë, qoftë në mënyrë të dijshme, qoftë të pavetëdijshme besimet e ndryshme patogjene për veten dhe të tjerët.

¹¹³ Gazzillo dhe Lingardi, 2008

¹¹⁴ Informacionet mbi pyetësorët janë përdorur me leje të prof.Lingardi-Gazillo për qëllimet e studimit

Koncepti i *besimeve patogjene* rrjedh nga teoria psikanalitike-konjitive e “Zotërimit dhe Kontrollit” (CMT)¹¹⁵. Besimet patogjene luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në zhvillimin e mendjes së pavetëdijshme të individit pasi ato mund të krijojnë dhe të mbajnë të gjitha tipologjitë e psikopatologjive të së ardhmes.

Besimet patogjene, frika, ankthi, ndjenjat e turpit dhe të fajit që krijohen prej tyre janë burimi kryesor i shtypjeve, frenimeve dhe sjelljes me tendencë keqpërshtatëse që shpiten në tendenca psikopatologjike. Si një shembull i këtyre formateve patogjene mund të citojmë tipologjinë e sjelljes mazokiste (të cituar në PDC) si: “...njerëzit të kushtojnë vëmendje vetëm kur je në telashe....”.

Këta pyetësorë janë përdorur në ndihmë të konstruktit të përgjithshëm të testit Q (konkursit të përgjithëm) nga i cili janë marrë të dhëna të rëndësishme për besimet patogjene të lidërve në institucionet arsimore.

B. Pyetësi i nivelit funksionimit mendor (QFM-27)

“Pyetësi i Nivelit të Funksionimit Mendor” (QFM-27) është një shkallë e vlerësimit klinik e bashkëngjitur këtij studimi për të vlerësuar subjektin sipas Aksit M të PDM dhe për të krijuar hipoteza klinike mbi nivelin dominues të organizimit të personalitetit të individit. Kjo shkallë e vlerësimit është krijuar nga Albasi, Lasorsa dhe Porcellini më 2007. Instrumenti përbëhet nga 27 pohime dhe është krijuar për të vlerësuar subjektin-pacient. Sikundër është trajtuar më parë në këtë punim, Aksi M në PDM përfshin aftësinë për rregullim, vëmendje dhe për të mësuar, aftësinë për të krijuar intimitet dhe marrëdhënie, cilësinë e përjetimit të përvojave të brendshme, aftësinë për të krijuar përvoja afektive, shprehi dhe komunikim, aftësitë mbrojtëse, aftësinë e përfaqësimeve të brendshme, aftësinë për diferencim dhe integrim, aftësitë vetë-vëzhguese dhe aftësinë për të ndërtuar standardet dhe idealet e brendshme. Këtu gjithashtu përfshihen edhe vlerësimet e tre niveleve të Organizimit

¹¹⁵ Teoria e” Zotërimit dhe Kontrollit/Control Mastery Theory”është një teori integrative e psikanalizës dhe psikoterapisë me orjentim konjitiv bihejvoral,e krijuar fillimisht nga studiues Joseph Weiss(1924-2004) për mënyrën sesi operon mendja.Ajo bazohet në dy parime kryesore:njerëzit mund të kontrollojnë përmbajtjen e tyre mendore dhe individët që vijnë në terapi janë të motivuar për të marrë në kontroll jetën e tyre. Caron, Mark D., "Development and validation of the Pathogenic Beliefs Questionnaire." (2014).

të Personalitetit të Aksit P (elementi i parë,i faktorit 1 në këtë studim) Personaliteti i Shëndetshëm, Niveli i Personalitetit Neurotik dhe Niveli i Personalitetit Kufitar (Borderline).

C. Inventari i marrëdhënieve me objektin (ORI)

Instrument vlerësues i krijuar më 1970 nga Sidney Blatt dhe kolegët e tij. Inventari i Marrëdhënieve me Objektin (ORI) është një metodë vlerësuese e pastrukturuar, e mbështetur në performancën e zhvillimit të marrëdhënies me të tjerët e rëndësishëm (objektet). Instrumenti është i lehtë për tu administruar dhe për tu kuptuar nga subjektet pjesëmarrës. Ai jep të dhëna të rëndësishme mbi dimensionet e pavetëdijshme të kuptimeve të tjetrit të rëndësishëm në jetën e individit.

ORI është një instrument me pyetje të hapura që i kërkon pjesëmarrësve të përshkruajnë sipas rëndësisë figurat e rëndësishme në jetën e tyre: nënën, babain,tjetër të rëndësishëm, kafshë shtëpiake veten dhe terapistin (nëse individi ndodhet në marrëdhënie terapeutike) (Blatt, Auersbach dhe Aryan, 1998).

Pas përshkrimit të “objektit në marrëdhënie”për rreth 5 minuta, subjektit i kërkohet të vlerësojë në një shkallë Likert lidhjen dhe qendrueshmërinë me këtë objekt. Studiuesit krijuan një tablo me 12 attribute dhe cilësi që përfshijnë: *afektin, ambicien, dashamirësinë,ngrohtësinë, cilësinë dhe angazhimin në marrëdhënie, dobinë intelektuale, prirjen ndaj kritikës, idealin pozitiv dhe negativ, cilësinë e përkujdesjes, suksesi dhe burimet e brendshme*. Edhe pse ORI mund të përdoret si instrument klinik për të vënë në dritë ndryshimet në botën objektuale të individit,sikundër tregojnë studimet e kryera për vlefshmërinë e ORI (Gruen dhe Blatt, 1990; Blatt et al., 1996; Blatt dhe Auerbach, 1996, 1997, 2001, 2002; Blatt et al.,1998; Arvidsson, Sikstrom dhe Werbart, 2011).

Blatt et al.(1996) krijuan edhe tre shkallë për vlerësimin sasior të protokollove ORI: shkallët AOR,D-R dhe ASD. Për të vlerësuar ORI, Diamond,Blatt,Stayner dhe Kasloë krijuan më 1991 një Shkallë për Diferencimin e Marrëdhënies që përshkruan dhjetë nivele të ndryshme të përfaqësimit të vetes dhe të tjetrit. Natyra e këtyre përfaqësimeve lidhet me stade të caktuara të zhvillimit dhe psikopatologjisë.

Quidant,Blatt, Chevron dhe Qein (1992) ndërmorrën një studim mbi vlefshmërinë e shkallëve mbështetëse, 12 cilësitë dhe ORI dhe të dhënat raportuan vlefshmërinë Pearson $r=0.88$ për tablonë e përgjithshme. Të dhënat e këtyre studimeve mbështesin gjithashtu edhe kontekstin hulumtues e këtij studimi mbi marrëdhëniet me objektet dhe pohimet e përdorura në testin Q.

D. Vlerësimi funksional i egos (EFA)

Bellac dhe Hurvich (1973) studiuuan funksionet e përshtatjes, kontrollit dhe integritetit të egos të hartuara më parë nga Hartman më 1956 në dymbëdhjetë kategori. Përcaktimi i tyre për funksionet e egos lidhej me konstruktet teorike të marra nga vëzhgimet e sjelljes dhe përvojat e subjektit.

Këto kategori përfshijnë:*Testimin e Realitetit;Gjykimin;Kuptimin e Realitetit të botës dhe vetes;Rregullimi dhe Kontrolli i impulseve, afekteve dhe instikteve;Objekti dhe Marrëdhëniet ndërpersonale;Proceset e të Menduarit;Regresioni Përshtatës në vendin e egos;Funksionet Mbrojtëse;Barrierat e Stimulit;Funksionimi Autonom;Funksionimi Sintetik-Integrativ dhe Aftësia Zotëruese.*

Autorët Sharp dhe Bellak (1978) e paraqitën pyetësin EFA si një metodë sasiore e vlerësimit në psikanalizë. Në këtë studim ky pyetësor është përdorur për të evidentuar dhe interpretuar cilësisht fortësinë e egos në tendencën e sjelljes keqpërshtatëse të subjekteve.

3.3. Kampionimi dhe P-set

Në metodologjinë klasike Q pjesëmarrësit janë zakonisht më të pakët në numër sesa pohimet Q (Brower,1999). Përforcohet kështu përsëri argumenti se në Q e rëndësishme është që grupi i caktuar i faktorëve të mund të jetë i besueshëm dhe analizueshëm në individë të ndryshëm.

Përzgjedhja e kampionit në Q nuk i përmbahet kriterit rastësor por të caktuar, pasi ai lidhet me qëllimin dhe pohimet e parashtruara në Q (McKeown dhe Thomas, 1988, fq.37). Secili pjesëmarrës në Modelin-P mbart një përvojë personale a pikëvështrim të lidhur me konkursin (Brown,1980) andaj Q-ja është ravijëzuar specifikisht për secilin individ. Modeli P për këtë studim përbëhet nga kampioni i “mësuesve “dhe “drejtuesve të institucioneve arsimore.

Janë marrë gjithsej në studim 200 subjekte në fazën e testimit të ndarë specifikisht në:

- 175 mësues

- 25 drejtues të institucioneve arsimore

Përzgjedhja e pjesëmarrësve u krye sipas të dhënave për shpërndarjen gjeografike dhe të popullatës shkollare nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) në bashkëpunim me Drejtoritë e Shkollave dhe vetë stafin pedagogjik. Pjesëmarrësit u kontaktuan fillimisht në Mars të vitit 2014 dhe pas fazës paraprake atyre iu paraqit mundësia e pjesëmarrjes në fazën e testimit të plotë në vitin 2015.

Ne u kujdesëm që sfondi moshor, gjinor, demografik, i përvojës në arsim, i pjesëmarrësve të ishte sa më shumë përfaqësues dhe i ndryshëm edhe brenda shkollave të të njëjtin qytet. Aspektet e metodologjisë-q të përdorura për analizën e këtij studimi janë fokusuar në tiparet e veçanta të personalitetit të liderit shkollor si kategori prototipi dhe jo në dallimet moshore, gjinore o kulturore të cilat natyrisht janë shumë të rëndësishme në krijimin e një kuadri shterrues interpretimi por nuk janë në fokus të këtij studimi. Po kështu vetë metodologjia Q është e fokusuar në lidhjen e korrelacioneve ndërmjet subjekteve dhe pohimeve ndryshore dhe jo në specifikat e brendshme të ndikimeve ndërmjet subjekteve. Për këtë arsye zgjedhja e kampionit të lidervë mësues dhe drejtues nuk ka ndjekur kuptimin e përzgjedhjes së vecantive të funksionit të kampionit por vetëm të kampionit si tërësi. Të dhënat demografike të mbledhura në këtë studim kanë paraqitur vetëm tablonë e shumësisë dhe heterogjenitetit të të dhënave Për trajtesat kulturore, Aksi-S i manualit psikodinamik parashton se kultura është pjesë integrale e përvojave subjektive të individit dhe nuk e trajton këtë si limit të kërkimit ndryshe nga DSM-ja.

Në zhvillimin e këtij studimi, përmes të dhënave të grumbulluara, ne mundëm të depistojmë një sërë tipologjish të aspekteve të organizimit të personalitetit, tendencës së sjelljes keqpërshtatëse, reagimeve emocionale –sjellore, të lidhjes në marrëdhëniet me tjetrin, nivelin e afektit dhe rregullimit afektiv, përfaqësimin konjitiv dhe mendor, ndikimet e mundshme mjedisore dhe komunitare dhe stilin e liderit për liderin mësues dhe drejtues të sistemit arsimor.

3.3.1 Çështje të Etikës.

- Për realizimin e këtij studimi është marrë një leje e posaçme nga Bordet e Drejtorive Arsimore në të gjitha qytetet ku është shtrirë ky studim. Të gjithë pjesëmarrësve në këtë studimor iu prezantua Miratimi i Informuar dhe Informimi në lidhje me qëllimin e studimit dhe zhvillimin e procesit të tij ;
- Pjesëmarrësit u informuan mbi tipologjinë metodologjinë-Q, procedurën dhe administrimin e të dhënave të mbledhura nga përgjigjet e tyre vetëm për qëllimet e këtij studimi;
- Pjesëmarrësit u informuan për ruajtjen e plotë të konfidencialitetit të të dhënave të tyre dhe mbrojtjen e këtyre të dhënave sipas Rregullores së Mbrojtjes së të Dhënave Personale (Data Privacy Act). Çdo subjekt i këtij studimi dhe materialet sensitive nga përgjigjet e mbledhura në të janë proceduar sipas Data Privacy Act dhe ruhen në databazën e studios së konsulencës së Data Privacy në shtetin Italian sipas kërkesave të BE për kërkimin shkencor. Asnjë prej këtyre të dhënave nuk mund të shpërndahej a trajtohet për motive të ndryshme nga ato të parashikuara nga ky studim dhe pa lejen e miratuar të respondentëve.
- Asnjë nga subjektet e përfshira drejtpërdrejtë a tërthorazi në këtë studim nuk është dëmtuar psikologjikisht a nga ndonjë formë tjetër e dëmtimit gjatë procesit të administrimit të testimit. Nuk është fabrikuar, krijuar apo stimuluar ndonjë e dhënë apo përgjigje e ndonjë subjekti pjesëmarrës për qëllime të tjera përpos atyre të parashtruara në këtë studim.
- Autorët nuk kanë konflikte të interesit me palët e përfshira drejtpërdrejtë ose tërthorazi në studim dhe as marrëdhënie të njohjes paraprake me pjesëmarrësit e këtij studimi.

3.4. Zhvillimi dhe skicimi i kërkit .

3.4.1. Përcaktimi i variableve ortogonale.

Sikundër paracaktohet në *“Fjalorin e termave të Testimit, Vlerësimit dhe Trajtimin Psikologjik”*(2007) analiza e faktorëve ortogonale mund të kuptohet si “ analizë ku

çdo faktor që pas llogaritjes nuk merr një variancë të caktuar dhe është i pavaruar nga të tjerët”.

Në metodologjinë Q, ndryshorët studimorë marrin vlera të pavaruara nga njëri-tjetri pasi ato analizohen veç e veç si elementë dhe përcaktorë të analizës faktoriale.

Krijimi i ndryshorëve ortogonalë i lejon studiuesit në metodologjinë-Q që të lehtësojnë analizën e faktorëve dhe elementët në interes të studimit. Ndryshe nga metodologjitë e tjera cilësore, metodologjia Q mbështetet në parimin holistik dhe ajo studion të gjithë ndryshorët ortogonalë si tërësi variablash pas analizës së tyre specifike. Të dhënat përfundimtare janë rezultante e pikëprerjeve statistikore të çdo ndryshori të marrë veçmas.

Në studimin tonë kemi kategorizuar disa ndryshorë ortogonalë sipas fokusit të vlerësimit dhe të matjes në testin Q-sort të krijuar për mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve arsimore.

Këta ndryshorë përfshijnë:¹¹⁶

- Pikvështrimet e mësuesve mbi Personalitetin ;
- Pikvështrimet e drejtuesve të institucioneve arsimore mbi Personalitetin;
- Pikvështrimet e mësuesve mbi Tendencën e sjelljes keqpërshtatëse;
- Pikvështrimet e drejtuesve të institucioneve arsimore mbi Tendencën e sjelljes keqpërshtatëse;
- Besimet e mësuesve mbi Stilin e tyre të Lidershit;
- Besimet e drejtuesve të institucioneve arsimore mbi Stilin e tyre të Lidershit;
- Pikvështrimet e mësuesve mbi Personalitetin e drejtuesit;
- Pikvështrimet e drejtuesve mbi Personalitetin e mësuesit;
- Besimet e mësuesve mbi Stilin e Lidershit të drejtuesit;
- Besimet e drejtuesve mbi Stilin e Lidershit të mësuesit;
- Pikvështrimet e mësuesve mbi Tendencën e Sjelljes keqpërshtatëse të drejtuesit;
- Pikvështrimet e drejtuesve mbi Tendencën e Sjelljes keqpërshtatëse të mësuesit.

¹¹⁶ fq.113,Ian Stuart Hamilton-2nd ed,2007 (Jessica Kingsley publishers)

3.4.2. Faza e shpërndarjes dhe administrimit së Q-SORT

Si një metodë hipsative dhe dikotomike, metodologjia Q kërkon një qartësim dhe kuptim të mirë të përdorimit të saj përpara procedimit. Pas implementimit në studimin pilot dhe krijimit të konstruktit me 77 pohime nga konkursi për të dy tipologjitë e liderëve në shkollë, ne filluam fazën e administrimit të testit. Gjatë muajit Shtator të vitit 2015 u shpërndanë testet e para dhe gjatë muajit Prill të 2016, pjesëmarrësit u testuan përsëri.

Sikundër kërkon procesi Q-sort, të dhënat e mbledhura duhen marrë në dy faza në hapësirë të paktën gjashtë muaj nga njëra-tjetra për të parë përputhshmërinë e tyre mes individit apo ndryshime të mundshme.

Pasi morëm lejen nga Drejtoritë Arsimore të qyteteve ku u përcaktua zhvillimi i studimit ne krijuam një listë me shkollat përfaqësuese. Pas përpilimit të listës ne morëm takim me drejtoritë e shkollave ku shpjguam qëllimin, procesin, risitë dhe paramatretat kryesore të kërkimit. U caktua një takim me stafin pedagogjik ku u shpjguua projekti dhe rëndësinë që mbarte ai për mësuesin dhe drejtuesit si liderë në sistemin arsimor. U shpjguua gjithashtu edhe rëndësia për një vlerësim të përgjithshëm të situatës psikosociale dhe klinike përmes të dhënave të personalitetit, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe minimizimin e faktorit konsumues në shkollë si dhe për përfaqësimin të një stili lidërshipi sa më efikas dhe eficient. Pjesëmarrësit nuk u kushtëzuan në marrjen pjesë në studim por u motivuan për të reflektuar mbi përfitimet psikosociale dhe në rritjen e efijencës së tyre si lider .

Pasi morëm aprovimin e stafit të mësuesve që do të dëshironte të ishte pjesëmarrës, ne u kërkuam atyre një takim të dytë jashtë orarit zyrtar të mësimit për të administruar testin. Administrimi u krye 7 ditë pas takimit të parë në një kohë të administrimit prej '80 minutash. Takimi dytë u krye pas gjashtë muajsh me të njëjtët pjesëmarrës dhe në të njëjtat kushte. Administrimi i testit u krye nga ekipi studiues dhe konsulentët ndërkombëtarë të metodologjisë Q.

Pas grumbullimit, të dhënat u koduan në programin SPSS version 23 për të dhënat përshkruese dhe të korrelacioneve Pearson dhe më pas në P-set method për të vlerësuar të dhënat matrikulare, të shpërndarjes piramidale dhe faktorizimit.

3.5. Implementimi i studimit

3.5.1. Përzgjedhja e shkollave

Pas testimit të vlefshmërisë të rezultateve paraprake dhe miratimit të tyre nga Dr.Malaj,konsulent shkencor i aëektit statistikor në të gjithë linjën e këtij studimi,u kalua në stadin e implementimit të plotë të *konkursit* të Q-sort në kampion.

Institucionet arsimore të përzgjedhura në këtë studim iu referuan synimit dhe metodologjisë bazë të përdorur në të. Sikundër është trajtuar më parë, metodologjia Q nuk kërkon një përzgjedhje rastësore të pjesëmarrësve porse të cilësuar sipas parametrave të studimit. Shkollat e përzgjedhura në këtë studim iu referuan kritereve të përgjithshme të shpërndarjes së popullatës në moshë shkollore parauniversitare në Shqipëri sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT) në vitin 2014-2016 dhe të dhënave të institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA) në vitet 2015-2017.

Përzgjedhja e tyre gjithashtu plotësoi edhe karakteristikën thelbësore të kërkuar nga metodologjia Q dhe Tabela Psikodiagnostike:shumësinë e pikvështrimeve dhe faktorëve të ndryshëm. Shpërndarja gjeografike e tyre ka synuar plotësimin e këtyre kritereve dhe një mbulim gjeografik përfaqësues në Republikën e Shqipërisë.

Sipas këtyre të dhënave qytetet me mbizotërimin më të lartë shkollor ku është kryer ky studim janë:

Tab.0.3 Tabelë përmbledhëse e shkollave pjesëmarrëse në studim sipas ndarjes zonale

Qyteti Tiranë	<i>Shkolla 9-vjeçare “Edith Durham”</i> <i>Shkolla 9-vjeçare “Emin Duraku”</i> <i>Gjimnazi “Sami Frashëri”</i> <i>Gjimnazi “Ismail Qemali”</i> <i>Gjimnazi “Arben Broci”</i>
Qyteti Elbasan	<i>Shkolla 9-vjeçare “Bardhyl Popa”</i> <i>Shkolla 9 -vjeçare “Haxhire Myzyri”</i> <i>Shkolla 9-vjeçare “Qamil Guranjaku”</i> <i>Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Pedagogjike”</i> <i>Gjimnazi i Përgjithshëm “Ahmet Dakli”</i>
Qyteti Shkodër	<i>Shkolla 9 vjecare “Skënderbej”</i> <i>Shkolla 9 vjecare “Xheladin Fishta”</i> <i>Shkolla 9 vjecare “Azem Hajdari”</i> <i>Shkolla e mesme e muzikës “Kolë Idromeno”</i> <i>Shkolla e mesme e përgjithshme “28 Nëntori”</i>
Qyteti Berat	<i>Shkolla 9 vjecare e muzikës “Ajet Xhindole”</i>

Qyteti Korçë	Shkolla 9 vjecare “28 Nëntori”
	Shkolla 9 vjecare “1 Maji”
	Shkolla e mesme e përgjithshme “Babë Dudë Karbunara”
	Gjimnazi i përgjithshëm “Kristaq Capo”
	Shkolla 9 vjecare “Tefi Tasho Koço”
	Shkolla 9 vjecare “Naum Veqilharxhi”
Qyteti Vlorë	Shkolla 9 vjecare “Naim Frashëri”
	Shkolla e mesme e përgjithshme “Ymer Dishnica”
	Shkolla e mesme e përgjithshme “Raqi Qirinxhi”
	Shkolla 9 vjecare “Ali Demi”
	Shkolla 9 vjecare “Halim Xhelo”
	Shkolla 9 vjecare “Perla dhe Zenel Murra”
	Shkolla e mesme Tregtare profesionale
	Shkolla e mesme e përgjithshme “Qemal Atatürk”

3.5.2. Organizimi i testit pilot (pre-testi).

Faza e parë e këtij studimi kishte për qëllim vlerësimin paraprak të metodës Q dhe përputhshmërinë e saj në kontekst me 50 subjekte pjesëmarrëse. Të dhënat e vlefshmërisë alfa ($n=50$; $r=.835$) na treguan një lidhje të fortë ndërmjet vlerësimit të pikëpamjeve për personalitetin dhe për lidhshpirtin në metodën e përdorur Q. Analiza midis variableve Pearson na raportuan një korrelacion pozitiv mes variableve (mësues dhe drejtues) pohimeve të lidhura me personalitetin dhe stilin e lidhshpirtit (P.2 , P.5, P. 24). Analiza faktoriale për të 50-të subjektet raportoi krijimin e 17 faktorëve nga të cilët 4 ishin të qendrueshëm me nivel 0.75 -0.85. Këta faktorë u konsideruan si domethënëse (sinjifikativë) dhe mund të krijonin shpërndarjen piramidale të Q në distribucion. Në të dyja ekstremet e shpërndarjes u pozicionuan pohimet më karakteristike (djathtas) dhe më pak karakteristike (majtas). Këto të dhëna mbi qendrueshmërinë dhe sinjifikancën në pre-test na ndihmuan për të krijuar konkursin e përfunduar Q (testin-Q) në dy versione për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave me një numër të fundit pohimesh 77.

Të dhënat e grumbulluara janë hedhur fillimisht në datasetin e Q të ndara veçmas për secilën njesi. Më pas, përmes programit Q janë krijuar variablet ortogonale dhe matricat ndërmjet subjekteve.

Le të shohim më poshtë përmbledhjen tabelore dhe grafike për të dhënat e fazës pilot:

Tab.0.4. Të dhënat tabelare për Variablet e fazës paraprake të Q

Renditja Matrikulare	(-5,-4,-3,-2,-1,0,1,2,3,4,5)
Shpërndarja e Q	0
Korrelacioni Pearson për pohimet Q paraprake	0,63
Nr.Sinjifikancës për Q paraprake	0,87




Fig 0.1.Grafiku i shpërndarjes së Q për fazën paraprake të studimit



Fig.0.2. Grafiku i Rrotullimit Varimax në Q.për dy faktorët e parë sinjifikantë në pretest

Sikundër mund të vërhet nga tabela matrikulare e të dhënave paraprake, të dhënat e sinjifikancës për 50 Q-sort paraprak është Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=.87$ çka do të thotë se mes niveleve të përgjigjeve të testit Q dhe pohimeve të konkursit ka një lidhje të fortë dhe pozitive. Pasi vlera e sinjifikancës është më e lartë sesa vlera e p , statistikisht kjo marrëdhënie është e qendrueshme dhe mund të vlerësohet për analizën e mëpasshme faktoriale. Në rrotullimin faktorial për elementët përfshirës dy faktorët me peshë më të lartë specifike janë faktorët 1 dhe 2 (Niveli i Organizimit të Personalitetit dhe Liderhipi).

Shpërndarja e pohimeve ruan linjën e distribucionit linear dhe vendosja e faktorëve në rrjetin koordinativ grafik të Q-sort është në pozicionim të drejtë me njëri-tjetrin. Faktori i parë shfaqet me një peshë specifike më të lartë sesa faktori i dytë parë kjo edhe nga grafiku i vendosjes. Kjo do të thotë që edhe në testimin fillestar faktori i personalitetit është tipari më specifik në analizën e ndryshorëve. Të dhënat përshkruese statistikore të sinjifikancës alfa, analiza faktoriale dhe reagimet pozitive të pjesëmarrësve shërbyen për të hartuar një konkurs më përfshirës për testin e mirëfilltë q-sort.

KREU IV

ANALIZA, REZULTATET DHE INTERPRETIMI I TË DHËNAVE

4.1. Përshkrimi i pjesëmarrësve

Pjesëmarrësve të këtij studimi iu kërkua të plotësonin një formular me të dhënat e tyre demografike që përfshinin: *Gjininë, Qytetin, Shkollën, Nr. e viteve në arsim, Klasën(at) ku jepnin mësim, Gradën shkencore, Formën e lidërshiptit që ofronin gjatë mësimit dhe veprimtaritë e tjera të shkollës*. Secilit pjesëmarrës iu caktua një kod personal identifikues sipas shkollës që përfaqësonte (001-175 për mësuesit dhe 175-200 për drejtuesit e institucioneve arsimore). Këto të dhëna të kodifikuara mbrohen nga Ligji për të Mbrojtjen e të dhënave Personale në databazën e studios konsulente së shtetit Italian për mbrojtjen e të dhënave të Kërkimit Shkencor (Data Research Privacy) të BE.

Tabela e mëposhtme tregon një përmbledhje të këtyre të dhënave të vjela. Përzgjedhja e pjesëtarëve të këtij studimi është ndarë në dy faza sipas procedurës së implementimit.

Në fazën e studimit pilot (pre-testit), subjekte përfaqësuese u zgjodhën 50 ndërsa në fazën e testimit përfundimtar numri i pjesëmarrësve u përcaktua 200 nga të cilët 175 mësues dhe 35 drejtues të institucioneve arsimore.

Tab.0.1. Tabela e të dhënave demografike për kampionin (P-set)

Femra	Meshkuj	Qyteti	Mesatarja e viteve në arsim	Grada Shkencore a.BA b.MA/Msc c.Dr.	Klasat ku japin mësim
a.Mësues 109 ose 62%	a.Mësues 66 ose 38%	Tirana 35 mësues dhe drejtues	20 vjet	BA-14 MA-24	7-9
b.Drejtues të Institucionit Arsimor 25 ose 71,4%	b.Drejtues të Institucionit Arsimor 10 ose 28%	Elbasani 35 mësues dhe drejtues	20 vjet	BA-20 MA-18	7-9
		Berati 35 mësues dhe drejtues	12 vjet	BA-20 MA/Msc-18	7-9
		Shkodër 35 mësues dhe	20 vjet		7-9
		Korcë 14 mësues dhe drejtues	15 vjet	BA-18 MA/Msc-20	7-9
		Vlorë 20 mësues dhe drejtues		BA-20 MA/Msc-18	7-9
				BA-18 MA/Msc-20	

4.2. Analiza dhe rezultatet e fazës së parë dhe të dytë

Tab.0.2 Analiza e vlefshmërisë dhe Peshë e variableve ortogonale në Rrotacion Varimax për të dhënat totale të studimit.

Analiza e Vlefshmërisë	
Cronbach Alfa	Pohime
0,819	77

Nr . Pohimi	Pesha e Faktorit të rotacionit 1	Pesha e Faktorëve të rotacionit 1	Variabël Ortogonal
1		1,65	
2		1,51	
3	0,59		
4	0,23		

Siç shihet në të dhënat e mësipërme, elementët e ndryshorit (pohimit) të parë dhe dytë mbajnë një peshë faktoriale të fortë dhe kufijtë ndërmjet tyre nuk janë më tepër se 0,4 çka i lejon ato për një analizë të plotë në Rrotacion Varimax, $\lambda > 1$.

Matrica e transformimit për elementët kryesorë në Rrotacion Varimax është me normalizim Kaiser.

Matrica e elementëve kryesore të rrotulluar është konvergjente në 3 ndërveprime.

Në analizën faktoriale të gjithë elementët *nuk janë poshtë kufirit 0,4*, andaj të gjithë elementët i plotësojnë kushtet e nënshtrimit ndaj analizës së mëtejshme.

Tabela 4.2 paraqet një përmbledhje të shpërndarjes së komponentëve të Q-sort për mësuesit dhe tabela 4.3 paraqet një përmbledhje të shpërndarjes së komponentëve të Q-sort për drejtuesit e institucioneve arsimore të marrë në studim.

Tab.0.3. Tabelë përmbledhëse për shpërndarjen e pohimeve Q sipas elementëve përbërës për mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve arsimore.

<i>Faktori i Parë "Personaliteti"</i>	<i>Nr.Pohimeve për Mësuesit</i>
<i>Elementi:Tendenca e Sjelljes Keqpërshtatëse</i>	1 3 13 16 21 43 52 60 64 76 77
<i>Elementi:"Organizimi i Personalitetit të Shëndetshëm"</i>	2 8 11 13 17 46 61
<i>Elementi:"Organizimi i Personalitetit Neurotik"</i>	5 9 10 51 53 65 70 75
<i>Elementi:"Organizimi i Personalitetit Borderline"</i>	6 12 15 19 20 48 50
<i>Elementi:"Organizimi i Personalitetit Psikotik"</i>	14 18 20 63 66
<i>Faktori i Parë: Elementi "Lidershipi në klasë"</i>	26 27 28 29 30 58 72
<i>Faktori i Parë:Elementi "Mjedisi shkollor dhe komuniteti"</i>	32 33 37 39 40 41 69
<i>Faktori i Parë:Elementi "Stili i Lidershipit"</i>	4 22 23 24 31 34 35 36 38 42 45 47 49 54 56 57 59 62 67 68 69 71 73

Tab.0.4. Tabelë përmbledhëse për shpërndarjen e pohimeve Q sipas elementëve përbërës për drejtuesit e institucioneve arsimore.

<i>Faktori i Parë "Personaliteti"</i>	<i>Nr.Pohimeve për Drejtuesit e Institucioneve Arsimore</i>
<i>Elementi:Tendenca e Sjelljes Keqpërshtatëse</i>	1 3 13 16 21 43 52 60 64 76 77
<i>Elementi:"Organizimi i Personalitetit të Shëndetshëm"</i>	2 8 11 17 46
<i>Elementi:"Organizimi i Personalitetit Neurotik"</i>	5 9 10 51 53 65 70 75
<i>Elementi:"Organizimi i Personalitetit Borderline"</i>	6 12 15 19 20 48 50
<i>Elementi:"Organizimi i Personalitetit Psikotik"</i>	14 18 20 61 63 66
<i>Faktori i Parë: Elementi "Lidershipi në klasë"</i>	26 27 28 29 30 58 72
<i>Faktori i Parë:Elementi "Mjedisi shkollor dhe komuniteti"</i>	32 33 37 39 40 41 69
<i>Faktori i Parë:Elementi "Stili i Lidershipit"</i>	4 22 23 24 31 34 35 36 38 42 45 47 49 54 56 57 59 62 67 68 69 71 73

4.3.Përgjigja ndaj analizës faktoriale

Ndarja faktoriale e ndryshorëve.

Pas grumbullimit cilësor të të dhënave përmes **metodologjisë- Q** realizuam procedurën e peshimit faktorial në vijim të së cilës u krijuan dy faktorë sipas peshës specifike të itemave mbi nivelin 0.4 dhe me rëndësi më të lartë statistikore e interes studimi.:

Faktori 1 : Niveli i Organizimit të Personalitetit të Liderit shkollor ;

Faktori 2: Stili i lidërshiptit të Lidërve shkollorë .

Të dhënat e vlefshmërisë dhe fortësisë të lidhjes së të gjithë ndryshorëve nga tabela 4.2. për faktorin e parë dhe dytë kanë një peshë faktoriale të fortë dhe kufijtë ndërmjet tyre më të ulët se 0,4 na lejuan ti analizojmë ato në metodologji Q me Rrotacion Varimax dhe normalizim Kaiser.

Pas kësaj ndarje faktoriale,në programin SPSS u realizuan :

- a) analiza statistikore e korrelacioneve për Faktorin 1 (Organizim Personaliteti) në Lidhje me Stilin e Lidërshiptit;
- b) analiza statistikore e korrelacioneve për Faktorin 2 (Stil i Lidërshiptit) në Lidhje me Nivelin e Organizimit të Personalitetit ;


Qëllimi i realizimit të këtyre analizave përshkruese është të jipet një kuadër mbështetës specifikisht për Pyetjen Kërkimore nr.1,3,5 dhe 7.

➤ **ANALIZA FAKTORIALE PËR REZULTATET E QYTETIT TIRANË**

Tab. 0.5. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Tiranë

Nr	Variablet	Peshimi për variablet e rotulluar
1	<u>Elementi “Tendencë e Sjelljes Keqpërshtatëse”</u>	
	Pohimi 1	0,762
	Pohimi 3	0,763
	Pohimi 17	0,778
	Pohimi 22	0,420
	Pohimi 24	0,435
	Pohimi 77	0,662
2	<u>Elementi “OP të Shëndetshëm”</u>	
	Pohimi 11	0,742
	Pohimi 46	0,743
3	<u>Elementi “OP Neurotik”</u>	
		0,760
	Pohimi 5	0,452
	Pohimi 9	0,725
	Pohimi 51	0,651
	Pohimi 53	
4	<u>Elementi “OP Borderline”</u>	
	Pohimi 6	0,811
	Pohimi 10	0,765
	Pohimi 65	0,695
5	<u>Elementi “OP Psikotik”</u>	
	Pohimi 18	0,525
	Pohimi 63	0,535
6	<u>Elementi “Lidershipi në Klasë”</u>	
	Pohimi 26	0,701
	Pohimi 28	0,588
	Pohimi 29	0,528
	Pohimi 30	0,708
7	<u>Elementi “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”</u>	
	Pohimi 32	0,549


	Pohimi 33 Pohimi 41	0,713 0,738
8	<u>Elementi "Stili i lidershipit"</u> Pohimi 35 Pohimi 36 Pohimi 56	0,568 0,415 0,494 0,427




Grafiku 0-1. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Tiranë.




Grafiku 0-2. Grafiku i OP të Shëndetshëm Tiranë




Grafiku 0-3. Grafiku i OP Neurotik Tiranë




Grafiku 0-4. Grafiku i OP Borderline Tiranë




Grafiku 0-5. Grafiku i OP Psikotik Tiranë




Grafiku 0-6. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë”Tiranë



Grafiku 0-7. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”Tiranë



Grafiku 0-8. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit”Tiranë



Grafiku 0-9. Shpërndarja Piramidale e Q-sortit për Qytetin e Tiranës

Siç mund të vërehet nga të dhënat tabelore dhe grafike e mësipërme në peshimin faktorial për faktorët 1 dhe 2 për Qytetin e Tiranës (Organizimi i personalitetit dhe Lidershipi), vlera më e lartë e lidhjeve në korrelacionale është arritur për pohimet nr.21 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .990$), pohimin nr.48 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .846$) në faktorin e 1 Organizim i Personalitetit dhe pohimin nr.35 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .566$) për faktorin 2 Lidershipi.¹¹⁷ Kjo do të thotë se ekziston një lidhje e fuqishme dhe pozitive ndërmjet anti-konformizmit dhe liderëve shkollorë në qytetin e Tiranës. Subjektet liderë shkollorë në këtë qytet po kështu shfaqen me lidhje pozitive të fortë me Drejtuesin e institucionit Arsimor si Lider Demokratik por jo të vetë mësuesit si aspirantë lider.


¹¹⁷ Për një shtjellim më të detajuar të pohimeve Q referojuni Shtojcës 1 dhe 2 ndërsa për të dhënat e korrelacioneve ndërmjet pohimeve prototip dhe subjekteve nga qytetet pjesëmarrëse referojuni Shtojcës 4 bashkëngjitur këtij punimi.

➤ ANALIZA FAKTORIALE PËR REZULTATET E QYTETIT ELBASAN


Tab.0.6. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Elbasan

Nr	Variablet	Peshimi për variablet e rrotulluar
1	<u>Elementi “Tendencë e Sjelljes Keqpërshtatëse”</u>	
	Pohimi 3	0,513
	Pohimi 23	0,686
	Pohimi 25	0,701
	Pohimi 64	0,466
2	<u>Elementi “OP të Shëndetshëm”</u>	
	Pohimi 2	0,433
	Pohimi 11	0,480
	Pohimi 13	0,617
	Pohimi 46	0,644
3	<u>Elementi “OP Neurotik</u>	
	Pohimi 5	0,580
	Pohimi 17	0,560
	Pohimi 66	0,576
	Pohimi 67	0,435
	Pohimi 75	0,452
4	<u>Elementi “OP Borderline”</u>	
	Pohimi 6	0,483
	Pohimi 12	0,522
	Pohimi 65	0,617
5	<u>Elementi “OP Psikotik”</u>	
	Pohimi 18	0,532
	Pohimi 20	0,509
	Pohimi 63	0,661
6	<u>Elementi “Lidershipi në Klasë”</u>	
	Pohimi 29	0,543
	Pohimi 30	0,428
	Pohimi 72	0,542
7	<u>Elementi “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”</u>	
	Pohimi 32	0,623
	Pohimi 37	0,620

	Pohimi 39	0,640
	Pohimi 40	0,656
8	<u>Elementi "Stili i lidershipit"</u>	
	Pohimi 4	0,419
	Pohimi 34	0,649
	Pohimi 35	0,673
	Pohimi 47	0,499
	Pohimi 71	0,489




Grafiku 0-10. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Elbasan




teacher or principal


Grafiku 0-11. Grafiku i OP të Shëndetshëm Elbasan




Grafiku 0-12. Grafiku i OP Neurotik Elbasan




Grafiku 0-13. Grafiku i OP Borderline Elbasan




Grafiku 0-14. Grafiku i OP Psikotik Elbasan




Grafiku 0-15. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë” Elbasan



Grafiku 0-16. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti” Elbasan



Grafiku 0-17. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit” Elbasan



Grafiku 0-18. Shpërndarja piramidale Q-sort për Qytetin e Elbasanit


Siç mund të vërehet nga të dhënat tabelore dhe grafike e mësipërme në peshimin faktorial për faktorët 1 dhe 2 për Qytetin e Elbasanit (Organizimi i personalitetit dhe Lidershipi), vlera më e lartë e lidhjeve në korrelacionale është arritur për pohimet nr.21 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=984$.) në faktorin e 1 Organizim i Personalitetit dhe pohimin nr.44 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=,726$) për faktorin 2 Lidershipi. Siç mund të kuptohet, qoftë liderët shkollorë në Elbasan, qoftë në Tiranë kanë një lidhje të fortë e pozitive me “të qenurit anti-konformist” si subjekte individë por, liderët shkollorë Elbasanas kanë një lidhje më të fortë me politikën në arsimim dhe kanë pritshmëri më të larta prej tyre.

➤ ANALIZA FAKTORIALE PËR REZULTATET E QYTETIT BERAT.


Tab 0.7. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Berat

Nr	Variablet	Peshimi për variablet e rrotulluar
1	<u>Elementi “Tendencë e Sjelljes Keqpërshtatëse”</u>	
	Pohimi 3	0,513
	Pohimi 23	0,686
	Pohimi 25	0,701
	Pohimi 64	0,466
	<u>Elementi “OP të Shëndetshëm”</u>	


2	Pohimi 2 Pohimi 11 Pohimi 13 Pohimi 46	0,433 0,480 0,617 0,644
3	<u>Elementi “OP Neurotik</u> Pohimi 5 Pohimi 17 Pohimi 66 Pohimi 67 Pohimi 75	 0,580 0,560 0,576 0,435 0,452
4	<u>Elementi “OP Borderline”</u> Pohimi 6 Pohimi 12 Pohimi 65	 0,483 0,522 0,617
5	<u>Elementi “OP Psikotik”</u> Pohimi 18 Pohimi 20 Pohimi 63	 0,532 0,509 0,661
6	<u>Elementi “Lidershipi në Klasë”</u> Pohimi 29 Pohimi 30 Pohimi 72	 0,543 0,428 0,542
7	<u>Elementi “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”</u> Pohimi 32 Pohimi 37 Pohimi 39 Pohimi 40	 0,623 0,620 0,640 0,656
8	<u>Elementi “Stili i lidershipit”</u> Pohimi 4 Pohimi 34 Pohimi 35 Pohimi 47 Pohimi 71	 0,419 0,649 0,673 0,499 0,489




Grafiku 0-19. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Berat




Grafiku 0-20. Grafiku i OP të Shëndetshëm Berat




Grafiku 0-21. Grafiku i OP Neurotik Berat




Grafiku 0-22. Grafiku i OP Borderline Berat




Grafiku 0-23. Grafiku i OP Psikotik Berat




Grafiku 0-24. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë”Berat



Grafiku 0-25. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”Berat



Grafiku 0-26. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit” Berat



Grafiku 0-27. Shpërndarja piramidale Q-sort për qytetin e Beratit

Siç mund të vërehet nga të dhënat tabelore dhe grafike e mësipërme në peshimin faktorial për faktorët 1 dhe 2 për Qytetin e Beratit (Organizimi i personalitetit dhe Lidershipi), vlera më e lartë e lidhjeve në korrelacionale është arritur për pohimet nr. 60 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .718$), pohimin nr. 9 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .669$) në faktorin e 1 Organizim i Personalitetit dhe pohimin nr. 42 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .769$) për faktorin 2 Lidershipi. Kjo do të thotë se Liderët shkollorë në qytetin e Beratit kanë një vetë-besim të lartë kur marrin përsipër një punë por ata njëkohësisht mund të ndjehen të frustuar shpejt dhe në stres. Prania e shtuar e faktorëve stresantë natyrisht që ndikon në ndryshimin e niveleve të organizimit të personalitetit në tendencë të sjelljes keqpërshtatëse nëse marrëdhënia e këtyre individëve do të ishte e përqëndruar te vetja por, korrelacioni i fortë me pohimin nr. 42 tregon se pavarësisht tendencës për frustacion, liderët shkollorë në qytetin e Beratit


janë të prirur për një stil lidershpi bashkëpunues dhe demokratik!

➤ ANALIZA FAKTORIALE PËR REZULTATET E QYTETIT SHKODËR


Tab.0.8. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Shkodër

Nr	Variablet	Peshimi për variablet e rrotulluar
1	<u>Elementi “Tendencë e Sjelljes Keqpërshtatëse”</u>	
	Pohimi 21	0,549
	Pohimi 43	0,679
	Pohimi 45	0,606
	Pohimi 77	0,622
2	<u>Elementi “OP të Shëndetshëm”</u>	
	Pohimi 7	0,650
	Pohimi 46	0,702
3	<u>Elementi “OP Neurotik</u>	
	Pohimi 12	0,511
	Pohimi 67	0,703
	Pohimi 70	0,481
4	<u>Elementi “OP Borderline”</u>	
	Pohimi 8	0,568
	Pohimi 15	0,591
5	<u>Elementi “OP Psikotik”</u>	
	Pohimi 18	0,598
	Pohimi 20	0,457
6	<u>Elementi “Lidershipi në Klasë”</u>	
	Pohimi 27	0,623
	Pohimi 28	0,448
	Pohimi 29	0,691
7	<u>Elementi “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”</u>	
	Pohimi 33	0,445
	Pohimi 40	0,563
	Pohimi 41	0,511

8	<u>Elementi "Stili i lidershipit"</u> Pohimi 44 Pohimi 57 Pohimi 73	0,449 0,553 0,419



Grafiku 0-28. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Shkodër




Grafiku 0-29. Grafiku i OP të Shëndetshëm Shkodër




Grafiku 0-30. Grafiku i OP Neurotik Shkodër




Grafiku 0-31. Grafiku i OP Borderline Shkodër




Grafiku 0-32. Grafiku i OP Psikotik Shkodër




Grafiku 0-33. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë” Shkodër



Grafiku 0-34. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti” Shkodër



Grafiku 0-35. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit” Shkodër



Grafiku 0-36. Shpërndarja piramidale e Q-sort për Qytetin e Shkodrës

Siç mund të vërehet nga të dhënat tabelore dhe grafike e mësipërme në peshimin faktorial për faktorët 1 dhe 2 për Qytetin e Shkodrës (Organizimi i personalitetit dhe Lidershipi), vlera më e lartë e lidhjeve në korrelacionale është arritur për pohimet nr. 67 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .833$) në faktorin e 1 Organizim i Personalitetit dhe pohimin nr.39 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .766$) për faktorin 2 Lidershipi. Liderët shkollorë në Shkodër janë sa të hapur në marrëdhëniet me të tjerët po kaq edhe ndjekës së politikave të mira të stilit të lidershipit . Lidhja e këtyre faktorëve me subjektivitetin e liderit shkollor në metodologjinë mbështeten edhe nga vendosja në piramidë e pohimit nr.39 në boshtin qendror (0) çka nënkupton që për liderët


shkollorë në Shkodër drejtuesit janë demokratikë dhe kjo është një normë këndvështrimi për ta.

➤ ANALIZA FAKTORIALE PËR REZULTATET E QYTETIT KORÇË


Tab.0.9. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Korçë

Nr	Variablet	Peshimi për variablet e rrotulluar
1	<u>Elementi “Tendencë e Sjelljes Keqpërshtatëse”</u>	
	Pohimi 1	0.482
	Pohimi 25	0.475
	Pohimi 64	0.604
	Pohimi 77	0.661
2	<u>Elementi “OP të Shëndetshëm”</u>	
	Pohimi 2	0.666
	Pohimi 46	0.624
3	<u>Elementi “OP Neurotik</u>	
	Pohimi 9	0.439
	Pohimi 12	0.582
	Pohimi 53	0.652
	Pohimi 67	0.551
	Pohimi 70	0.634
	Pohimi 75	0.605
4	<u>Elementi “OP Borderline”</u>	
	Pohimi 9	0.658
	Pohimi 19	0.579
	Pohimi 48	0.675
5	<u>Elementi “OP Psikotik”</u>	
	Pohimi 14	0.625
	Pohimi 20	0.535
6	<u>Elementi “Lidershipi në Klasë”</u>	
	Pohimi 27	0.602
	Pohimi 28	0.415
7	<u>Elementi “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”</u>	
	Pohimi 32	0.490
	Pohimi 37	0.687


8	<u>Elementi “Stili i lidërshtipit”</u>	
	Pohimi 36	0.582
	Pohimi 38	0.627
	Pohimi 47	0.425




Grafiku 0-37. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Korçë




Grafiku 0-38. Grafiku i OP të Shëndetshëm Korçë




Grafiku 0-39. Grafiku i OP Neurotik Korçë




Grafiku 0-40. Grafiku i OP Borderline Korçë




Grafiku 0-41. Grafiku i OP Psikotik Korçë




Grafiku 0-42. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë” Korçë



Grafiku 0-43. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti”Korçë



Grafiku 0-44. Grafiku për elementin “Stili i Lidërshiptit” Korçë



Grafiku 0-45. Shpërndarja piramidale Q-sort për qytetin e Korçës


Siç mund të vërehet nga të dhënat tabelore dhe grafike e mësipërme në peshimin faktorial për faktorët 1 dhe 2 për Qytetin e Korçës (Organizimi i personalitetit dhe Lidershipi), vlera më e lartë e lidhjeve në korrelacionale është arritur për pohimet nr. 10 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .812$) në faktorin e 1 Organizim i Personalitetit dhe pohimin nr. 47 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .542$) për faktorin 2 Lidershipi. Liderët shkollorë në Korçë janë të disiplinuar dhe me një sens të fortë vetë-kontrolli. Lidhja e fortë pozitive me pohimin nr.10 nuk tregon se këta liderë janë vete dashës më shumë se të tjerët porse dialogjet e tyre të brendshme me veten janë stimuluese dhe motivuese në një pjesë të madhe të pjesëmarrësve. Ky argument mbështetet edhe në analizën e grafikut Q më lart ku pohimi nr.10 është në peshën specifike më të lartë si karakteristike (jo e lartë) e këtyre liderëve shkollorë.

➤ ANALIZA FAKTORIALE PËR REZULTATET E QYTETIT VLORE


Tab. 0.10. Analiza faktoriale dhe peshimi i faktorëve për Qytetin Vlorë

Nr	Variablet	Peshimi për variablet e rrotulluar
1	<u>Elementi “Tendencë e Sjelljes Keqpërshtatëse”</u>	
	Pohimi 14	0,425
	Pohimi 35	0,701
	Pohimi 53	0,609
	Pohimi 73	0,545
2	<u>Elementi “OP të Shëndetshëm”</u>	
	Pohimi 2	0,606
	Pohimi 7	0,619
3	<u>Elementi “OP Neurotik”</u>	
	Pohimi 9	0.562
	Pohimi 44	0.626
4	<u>Elementi “OP Borderline”</u>	
	Pohimi 60	0,525
	Pohimi 65	0,655
5	<u>Elementi “OP Psikotik”</u>	
	Pohimi 16	0,523
	Pohimi 61	0,624

6	<u>Elementi "Lidershipi në Klasë"</u> Pohimi 55 Pohimi 77	0. 653 0,582
7	<u>Elementi "Mjedisi shkollor dhe Komuniteti"</u> Pohimi 23 Pohimi 29 Pohimi 31	0,593 0,687 0,677
8	<u>Elementi "Stili i lidershipit"</u> Pohimi 24 Pohimi 25 Pohimi 37 Pohimi 71	0, 460 0,616 0,625 0,598




Grafiku 0-46. Grafiku i Tendencës së Sjelljes Keqpërshtatëse Vlorë



Grafiku 0-47. Grafiku i OP të Shëndetshëm Vlorë




Grafiku 0-48. Grafiku i OP Neurotik Vlorë




Grafiku 0-49. Grafiku i OP Borderline Vlorë




Grafiku 0-50. Grafiku i OP Psikotik Vlorë




Grafiku 0-51. Grafiku për elementin “Lidershipi në Klasë” Vlorë



Grafiku 0-52. Grafiku për elementin “Mjedisi shkollor dhe Komuniteti” Vlorë



Grafiku 0-53. Grafiku për elementin “Stili i Lidershipit” Vlorë



Grafiku 0-54. Shpërndarja piramidale Q-sort për qytetin e Vlorë

Në të dhënat tabelore dhe grafike e mësipërme në peshimin faktorial për faktorët 1 dhe 2 për Qytetin e Vlorës (Organizimi i personalitetit dhe Lidershipi), vlera më e lartë e lidhjeve në korrelacionale është arritur për pohimin nr. 61 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .832$) në faktorin e 1 Organizim i Personalitetit dhe pohimin nr. 55 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .682$) për faktorin 2 Lidershipi. Po kështu është interesant fakti se lidhja korreccionale e liderëve në Vlorë me pohimin nr.21 është 0. Këto të dhëna na sugjerojnë se në të vërtetë liderët shkollorë në Vlorë motivohen nga miratimi i të

tjerëve (lidhje pozitive me pohimin nr.61) por ata gjithashtu janë të gatshëm për t'i ndihmuar ata në situatat që i mendojnë si konflikтуale. Fakti që me pohimin nr.21 subjektet pjesëmarrëse në Vlorë nuk kanë asnjë marrëdhënie korrelacionale tregon se ata nuk e shikojnë rolin e tyre si lider si pjesë e të qenurit konformist o anti-konformistë por si pjesë e natyrshme e sjelljes së tyre.

KREU V

DISKUTIME DHE PËRMBLEDHJE

Ky kapitull do të shqyrtojë të gjitha gjetjet e marra nga të dhënat sasiore dhe cilësore të këtij studimi krahasuar me lëmin e të dhënave mbështetëse të literaturës dhe kërkimeve të thelluara ende në vazhdimësi. Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë situatën e nivelit të Organizimit të Personalitetit dhe tendencës së sjelljes së Mësuesve dhe Drejtuesve të Institucioneve Arsimore përmes Stilit të tyre të Lidershipit. Në synimet e këtij studimi është përfshirë edhe roli i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në Prototipin e një sjelljeje të shëndetshme. Ky studim i ka dhënë një hapësirë të mjaftueshme analizave përshkruese mbi incidencën sociale të sjelljeve me tendencë patogjene dhe të zhvillimit të nivelit të organizimit të personalitetit të liderët në shkolla të ndryshme të Shqipërisë. Janë të pakta ose thuajse mungesore studime të mëparshme në kontekstin Shqiptar që kanë synuar të studiojnë mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve nëpërmjet niveleve të organizimit të personalitetit. Ndërkohë, studimet kontekstuale të lidhura me stilet e lidershipit dhe politikat e drejtimit të Arsimit në Shqipëri nuk janë mungesore (Pendavijni et al.2009). Ato fokusohen më së shumti në një panoramë mbi format e lidershipit, faktorët ndikues në rritjen e eficiencës dhe marrëdhënien në shkollë por mbeten për tu plotësuar në lidhjen e liderit me veten si subjekt psikologjik dhe marrëdhënien me të tjerët. Një aspekt po kaq me rëndësi sa edhe strukturat psikodinamike të personalitetit, në studimet mbi liderët shkollorë është edhe bashkëlidhja konjitive-emocionale e individit me vetë problemin e tij dhe burimet e brendshme që ai përdor për ta përballuar atë.

Proceset konjitive të vlerësimit të gjendjes subjektive të mirëqenies personale ose të vetë burimeve përshtatëse konsiderohen mekanizma qendrore në përshtatjen e individit në marrëdhëniet individ-mjedis- stresor (sëmundje).

Në fushën e psikodinamizmit përvoja e problematikës psikologjike apo e sëmundjes dhe mënyra sesi e përballon individi shihen si pasoja të tipareve të personalitetit të atij pacienti, në nivel konjitiv, afektiv dhe të burimeve sjellore të

brendshme. Sjellja e lidërve fokusohet në kontekstin social të tyre, pritshmëritë nga roli që marrin, hierarkia dhe autoriteti si elementë të strukturës, nga normat dhe faktorë të tjerë individualë në gjithë performancën. Në përpjekjen për të krijuar një profilizim psikologjik të liderit shkollor, ky punim ka ndërthurur një gamë të gjerë të studimeve të literaturës me kërkimin e implementimin metodologjik në terren. Autorët dhe studiuesit amerikanë të Shoqatës të Psikologjisë Amerikane (APA) kanë parashtruar fillimisht projektin e krijimit të një Prototipi Psikodinamik dhe Nivelit të Personalitetit në vitin 2008 pas publikimit të “Manualit Diagnostik Psikodinamik” (PDM) për sjelljen me tendencë keqpërshtatëse apo të çrregulluar.

Si një manual diagnostikues i ri, PDM është një taksonomi që vë në qendër strukturën e personalitetit dhe aftësive të individit dhe jo vetëm trajtimin e thjeshtë të simptomave.

Në perspektivën psikodinamike të psikologjisë arritja e një kuptimi stabël e pozitiv të vetes si dhe vendosja e një marrëdhënieje reciprokisht të kënaqshme dhe jetëgjatë me të tjerët janë dy detyrat thelbësore të zhvillimit të individit. Studiues dhe klinikistë nga e gjithë bota dhanë kontributet e tyre në mbledhjen e të dhënave të mjaftueshme për vlefshmërinë e manualit PDM si një formë e re e trajtesës së psikopatologjisë nga perspektiva psikodinamike dhe të instrumentave bashkëshoqërues të saj si Tabela Psikodinamike Diagnostike (PDC-2) dhe Tabela e Organizimit të Personalitetit (Gordon, 2013-2015). Pas përfshirjes sonë si ekipi Shqiptar në veprimtarinë e kërkimit ndërkombëtar për vlefshmërinë e PDC-së, ne kërkuam të studiojmë më thellësisht lidhjen mes Tabelës Psikodiagnostike dhe Manualin Psikodinamik për t’i ofruar ato si forma alternative të depistimit në grupet e popullatave që kanë marrëdhënie të drejtëpërdrejtë me mjedisin dhe të tjerët. Përzgjedhja e mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore si liderë në punën e tyre lidhet para së gjithash me veçantinë e kësaj popullate të ekspozuar ndaj ndryshorëve psikologjikë dhe mjedisorë që ndikojnë drejtpërdrejtë në mënyrën e vetë-perceptimit dhe vetë-vlerësimit, formën e të menduarit realist ose jo, formimit të besimit patogjen dhe sjelljen e përgjithshme të shfaqur.

Ndikohe në këtë linjë edhe stili i lidershipit nga formimi i strukturave psikodinamike të personalitetit, të menduarit endopsikik dhe nxitja e shfaqjes së sjelljes së jashtme. Monitorimi i këtyre parametrave të sjelljes dhe personalitetit është natyrisht një burim i jashtëzakonshëm për depistimin klinik dhe parandalimin e situatave ku sjellja keqpërshtatëse krijon probleme të mëdha dhe të qëndrueshme shoqërore si dhuna, përndjekja dhe abuzimi, probleme këto që mund të kthehen në mbizotëruese dhe me pasoja shumë të vështira për tu trajtuar në të ardhmen e individit . Sa më tepër të mund të parashikohet një sjellje aq më shumë mund ta parandalosh atë. Njëkohësisht një lider shkollor që njeh nivelet e organizimit të personalitetit të veta ka shumë më mundësi që të përdorë potencialet e veta për zhvillimin më të mirë psikologjik dhe social. Që në shkrimet e hershme të Frojdit sjellja keqpërshtatëse mbarte një vëmendje të vecantë pasi ajo është prelud për “të gjitha paudhësitë” (Frojd, 1929).

Në fazën e parë të këtij studimi u krye një punë voluminoze studimore në spektrin metanalitik, empirik dhe situacional me burime bibliografike që variojnë nga vitet 1917 e deri më 2020 në fushën e psikanalizës por edhe të lidershipit. Më pas u rikonstruktua lajmotivi i studimit dhe u paracaktua kampioni i mësuesve dhe i drejtuesve si aktorë të lidhur drejtpërdrejtë me lidershipin. Pas administrimit të testit paraprak Q, të dhënat e e sinjifikancës për 50 Q-sort paraprakë është Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .87$ çka do të thotë se mes niveleve të përgjigjeve të testit Q dhe pohimeve të konkursit ka një lidhje të fortë dhe pozitive. Pasi vlera e sinjifikancës është më e lartë sesa vlera e p , statistikisht kjo marrëdhënie është e qëndrueshme dhe mund të vlerësohet për analizën e mëpasshme faktoriale.

Në rrotullimin faktorial për elementët e përfshirë dy faktorët me peshë më të lartë specifike që janë faktorët 1 dhe 2 (Niveli i Organizimit të Personalitetit dhe Lidershipi).

U përcaktuan në vazhdimësi ndryshorët që do të ishin pjesë e analizës së thelluar të këtij studimi në studimin e këtyre faktorëve.

- a. Besimet patogjene;
- b. Marrëdhënia me veten dhe me Tjetrin e rëndësishëm;

- c. Sjellja e liderit në klasë;
- d. Sjellja e liderit në komunitet;
- e. Impakti i mjedisit të liderit në shkollë.

Pas përcaktimit të ndryshorëve të studimit ne krijuam një kategorizim të tyre secili ortogonal dhe i mëvetësishëm nga njëri-tjetri por me impakt në të tërën.

U përcaktua metodologjia e përzier e studimit, Metodologjia Q dhe u vendosën instrumentat mbështetës vlerësues. U përcaktua edhe veprimtaria e implementimit të metodës në secilin qytet pas miratimit nga konsulenti i statistikave, Dr. Malaj. Përcaktimi i ndryshorëve krijoi njëkohësisht edhe procesin e konkursit sipas të cilit u përcaktuan pohimet e rëndësishme për secilin variabël dhe bashkësinë e tyre në bashkësi më të mëdha.

U përcaktuan *katër bashkësi* të mëdha që përfshinin:

1. Organizimi i Personalitetit dhe Tendencia e sjelljes keqpërshtatëse;
2. Liderhipi në Klasë;
3. Mjedi shkollor dhe komuniteti;
4. Stili i liderhipit.

U administruan, analizuan dhe interpretuan të dhënat e atashuara me pyetjet kërkimore për secilën bashkësi. U krijuan faktorët e rëndësishëm me vlerë më lartë se 0,4 pas peshimit, u analizuan elementët përmes Pqmethod dhe u krye analiza e vendosjes për çdo faktor në rrotacionin Varimax.

U vërejt një konsensus i plotë në vendosjen e faktorëve. Interpretimi i të dhënave është kryer sipas rezultate të të dhënave përshkruese nga SPSS dhe pikavarazheve të krijuara nga programi Pqm. Interpretimi i pikavarazheve është kryer nga më i larti të më i ulëti përfshirë renditjen e tyre sipas peshës së secilit faktor, sikundër kërkohet në metodologjinë Q.

Për të vlerësuar orjentimin e sjelljes dhe nivelin e organizimit të Personalitetit të Liderit në Shqipëri, jemi mbështetur në nxitjen e parë të këtij studimi lidhur me nivelin e organizimit të personalitetit.

Bashkësia e pohimeve Q për vlerësimin e “ Tendencës së Sjelljes Kepërshtatëse” përfshin pohimet: 1, 3, 5, 16, 21, 22, 23, 28, 43, 45, 49, 52, 54, 60, 64,

76 dhe 77.

Pohimet e lidhura me këtë element zënë një vend dukshëm mbizotërues mbi pohimet e tjera pasi ato mbajnë peshën kryesore të qëllimit të këtij studimi. Të dhënat treguan se ekziston një marrëdhënie e fortë pozitive mes përgjigjeve të liderëve në qytetin e Shkodrës për pohimin nr.67 “*Kur të tjerët më shikojnë në,unë skuqem dhe mendoj*” me Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .883$ çka do të thotë se ekziston një lidhje e qendrueshme, e fortë dhe pozitive mes liderëve në qytetin e Shkodrës me ndikimin nga të tjerët. Po kështu për të njëjtin pohim, Shkodra ka arritur nivelin më të lartë në renditjen e pikavarazheve $z_{me} = 1,819$. Kjo do të thotë se në këtë qytet liderët mund të ndikohen nga qendrimet e tjerëve dhe vlerësojnë sjelljen e tyre si pasojë e këtyre marrëdhënieve. Ndryshe nga sa mund të mendohet nga mendësia e përgjithshme, liderët shkollorë në Shkodër nuk kanë një lidhje të fortë e pozitive. Korrelanca e pohimit nr. 21 “*Jam anti konformist*” është: Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = -.249$ pra, lidhja mes këtij pohimi dhe liderëve Shkodranë është negative dhe e dobët. Edhe në pikavarazhin z , qyteti i Shkodrës rezulton me pikavarazhin më të ulët $= 0,3$.

Siç mund të shihet asnjë nga përgjigjet e dhëna në qytetet Shqiptare nuk vërtetojnë atë pjesë të mendësisë së përgjithshme që “Shkodranët janë kundër-rregullave” dhe “Vlonjatët e thonë gjithmonë drejtpërdrejtë atë që ndjejnë”. Nëse korrelacioni në një vend të caktuar është 0, sikundër në rastin e pohimit nr.21 në Vlorë, kjo do të thotë që nuk ekziston asnjë marrëdhënie ndërmjet subjekteve dhe ndryshoreve (pohimeve) andaj, qëndrimi i tyre ortogonal është në normë. Pra, liderët në Vlorë nuk janë antikonformistë por edhe nuk konformohen!

Kjo e dhënë mund të mbështetet nga fakti se liderët shkollorë në Elbasan janë më të ndikuar nga protokollet e politikave ndërsa në Tiranë janë më të prirur për argumentimin e tyre. Një pjesë relativisht e vogël e pjeëmarrësve në këto qytete (14 %), shprehën një qëndrim asnjënjës në karakterizimin e sjelljes (vlerësim me 0 në tabelën e Q-sortit) ndërsa pjesa më e madhe e tyre referuan dallime domethënëse në tendencë pozitive. Peshimi i faktorëve në matricë dhe vendosja e faktorëve në rrotacion u zhvillua për secilin qytet sipas vlerësimit paraprak të pragut të pranuar 0.4 (shih Kapitullin IV).

Në vlerësimin e pyetjes së dytë kërkimore u kërkua një kohëzgjatje dhe vëmendje më e lartë ndaj detajeve. Pohimet e lidhura në këtë bashkësi janë një përbashkim i profilizimit të Inventarit të Personalitetit të Minnessotas (MMPI-2) dhe karakteristikave të individit në akset e PDM (McWilliams, Gazillo, Lingardi, Gordon dhe Bornstein, 2013). Konkursi i plotë me 77 pohimet e Q-sort u krijua si rrjedhojë e këtyre pohimeve dhe nga pritshmëritë e grumbulluara nga liderët shkollorë në vlerësimin paraprak të metodologjisë Q.

Pohimet prototip të konkursit të Q u kthyen në pohime statistikisht të qendrueshme (*itema*). Në instrumentin Q, prototipet pohime nuk janë të përdorura si faktorë të Prototipeve Psikodinamike të Personalitetit por vetëm si komponentë vlerësues të instrumentit Q (Shedler, et al., 2014; Westen, et al., 2003; 2005; 2012). Andaj, me krijimin e konkursit të Q-sort, vlerësimi kategorik do të kryhet sipas analizës faktoriale dhe të dhënave korrelative (Fortunato dhe Speranza, 2018).

Pohimet përbërëse të kësaj bashkësie faktoriale përfshijnë:

- i. Për personalitetin e shëndetshëm: 2, 8, 11, 17, 23, 46, 61
- ii. Për organizimin e personalitetit neurotik: 5, 9, 12, 24, 51, 53, 65, 67, 70, 75
- iii. Për organizimin e personalitetit kufitar: 6, 10, 15, 19, 20, 48, 50
- iv. Për organizimin e personalitetit psikotik: 14, 18, 30, 63, 66

Për secilën nga këto nëndarje janë vlerësuar karakteristikat përbërëse për çdo Organizim Personaliteti. Kështu për shembull, "*Kam frikë të rri vetëm*" është një pohim për OP kufitar pasi në këtë prototip të personalitetit ndjenjat e fajit dhe të turpit të mbrujtura në fëmijërinë e hershme nga objekti i rëndësishëm (Tjetri) shoqërohen më vonë me ankthin e vetmisë dhe frikën e mirëfilltë nga vetmia.

Niveli i personalitetit kufitar si faktor në OP shfaq përgjithësisht një korrelancë të lartë me Çrregullimin Kufitar qoftë me manifestim të Çrregulluar qoftë me manifestim Narcistik-Pasiv\Agresiv (Berenbaum, et al., 2003; Cicchetti, et al., 1995; Cole, et al., 1994; 2009; Gross dhe Muñoz, 1995; Kring dhe Werner, 2004) dhe antisocial edhe sipas të dhënave të literaturës (Moffitt, 2018; Wertz, et al., 2018; Caye, et al., 2016; Calkins dhe Keane, 2009; Bleiberg, 2001; Campbell,

1995; Pettit, et al., 1993).

Tendenca e një personaliteti të tillë mund të jetë padyshim sporadike dhe jo drejtpërdrejtë ndikuese në cilësinë e jetës dhe marrëdhënieve të individit por, nëse ajo mbivendoset në karakteristikë me pohimin nr 9. "*Ndjej mungesë të kuptimit të jetës*" dhe pohimin nr.18 "*Kam shpesh fantazi personale dhe ëndërroj*" situata vendoset në një kënd krejt të ndryshëm. Individidi ka krijuar një Besim të vetin Patogjen i cili karakterizon ndryshimin e strukturës së personalitetit nga "*në potencial psikopatologjik*" në "*rrezik psikopatologjik*".

Për pohim nr.17 "*Kur jam në stres keqpërshtatem*", vihet re nga grafikët e piramidës Q një pozicionim i lartë për qytetin e Beratit (77%) dhe Korçës (25%) ndërsa pozicionimi më i ulët është në Tiranë (12%). Të dhënat e korrelacioneve për këto qytete tregojnë po kështu një lidhje të fortë pozitive për Beratin (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=,956$), lidhje mesatarisht pozitive për Korçën (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=,496$) dhe të dobët për Tiranën (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=,261$) në pohimin nr.17 . Një pjesë e madhe e respondentëve të këtij studimi (56 %) reflektojnë një mbivendosje të niveleve të organizimit të personalitetit Neurotik, Kufitar dhe të Shëndetshëm. Përvoja subjektive e individëve si në rastin e pohimit nr.9 rrit tolerancën ndaj tendencës për sjellje deviante të së ardhmes. Andaj, nëse janë kuruar pikvështimet për veten është kuruar marrëdhënia! Mbivendosja e këtyre elementëve të organizimit të personalitetit është një trumbetë alarmi për ndjekjen hap pas hapi dhe parandalimin e kthimit të tyre në cikël të vërtetë patogjen shumë të rrezikshëm për të ardhmen.

Një nga synimet kryesore të këtij punimi është të paraqesë metodologjinë Q si formë të vlerësimit e vetë perceptimit të liderit në institucionet arsimore. Vetëvlerësimi është një instrument sa objektiv aq dhe i fuqishëm i psikës së njeriut. Matja e këndvështrimeve të individit është më e rëndësishme sesa thjesht matja e korrelacioneve së shifrave për të (Brown,1991). Metodologjia Q rezultoi një metodë e dobishme jo vetëm sepse ofron një akses të administrimit dhe analizës së të dhënave sasiore dhe cilësore brenda të njëjtës metodë por edhe sepse lidh drejtpërdrejtë individin me "gjykatësin" objektiv dhe subjektiv të vetes dhe të tjetrit. Të dhënat mbështetëse për përdorimin e metodologjisë Q u vërejtën që në fazën pilot të këtij

studimi $\partial = 0,81$. Pas aprovimit nga konsulenti teknik i statistikave, Dr. Malaj për implementimin e mëtejshëm të saj, Q-sort shërbeu si instrumenti bazë psikodiagnostik i këtij studimi.

Metodologjia-Q u zhvillua në disa hapa :

1) zhvillimi i pohimeve statistikisht të qendrueshme (konkurs) të zhvilluara në dy stadi a. Testimi paraprak dhe b. Testimi Q-sort;

2) reduktimi në një numër pohimesh përfaqësuese (P-set ose Kampioni-Q).

Në këtë studim pjesëmarrësit u përzgjedhën në kategorinë e mësuesve dhe drejtuesve të institucionet arsimore me të dhënat e shpërndarjeve demografike të shkollave nga IZHA, INSTAT dhe MAS. Për shkak se metodologjia Q nuk studion lidhjet ndërmjet karakteristikave të veçanta të subjekteve si për shembull korrelacionet e pohimeve në lidhje me gjininë a grupmoshën ose liderin mësues nga lideri drejtues, ato nuk merren në kritere vlerësuese në këtë studim. Q-sort interesohet vetëm në depistimin e dukurisë që ka interes psikologjik për kohën e vlerësimit të dhënë. Po kështu, studiuesit e metodologjisë Q nuk i përzgjedhin kampionin e tyre nga popullata e përgjithshme në mënyrë rastësore. Ata janë të interesuar për të studiuar modelet psikologjike të veçanta në kampione të së njëjtës popullatë nëpërmjet konkursit të krijuar për të pasqyruar ta modeli i caktuar i Q-sortit për secilin individ ndeshet në popullatën e përgjithshme (Stephenson, fq.5).

Vlefshmëria e përdorimit të Metodës Q kërkon gjithnjë një fazë testimi pilot (Watts dhe Steiner, 2005; Brown, 2004). Feedback i pjesëmarrësve marrë nga testimi pilot u reflektua në pohimet e fundme të konkursit të Q.

Ngase vetë metodologjia Q është e fokusuar në vlerësimin e subjekteve, qendrimeve dhe niveleve të tyre të shëndetit mendor, numri i kampionit është përfaqësues vetëm brenda së njëjtës popullatë (Lee, S. Buyung, 2017).

U përzgjedhën kështu 175 mësues dhe 25 drejtues të institucioneve arsimore në pesë qytete kryesore të Shqipërisë: Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë, Berat. Si mësuesit dhe drejtuesit mund të quhen liderë në shkollë pasi së bashku koordinojnë përpjekjet për vendimarrjen në shkollë dhe politikën e mësimdhënies (Lieberman dhe Miller, 2005). Përdorimi i metodologjisë Q për lidhshërinë e mësuesve dhe të liderëve gjen

mbështetje të gjerë edhe në literaturë (Riel dhe Becker, 2008; Helterbran, 2010; Dauksas dhe White, 2010; Silva, Gimbert dhe Nolan 2006). Ky instrument ka treguar një vlefshmëri të mirë të konstruktit dhe kriterit dhe faktorët e krijuar Q-kanë një koerencë të brendshme të lartë ndërmjet tyre në të gjitha qytetet ku u testua. Pasja e një instrumenti të vlerësimit të personalitetit përmes faktorëve Q dhe krijimi i një linje vlerësimi sipas niveleve të organizimit të personalitetit jep mbështetje në një nga synimet e këtij vlerësimi për vlerësimi i kategorive klinike jo vetëm si patologji.

Metodologjia Q, pra, është një metodë e lehtë, e qartë dhe pa kosto shtesë për mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave në Psikologjinë Klinike e më gjerë.

Nëse vlerësimi statistikor jep mbështetje për të dhënat studimore në fokus të këtij studimi po kaq rëndësi mbart edhe vlerësimi i strukturave përbërëse psikodinamike të personalitetit të liderit.

Funksionaliteti Mendor dhe Fortësia e Egos janë dy ndryshore mjaft të rëndësishme për vlerësimin e këtyre strukturave psikodinamike. Përdorimi i instrumentave QFM-27 dhe EFA ishin një burim mjaft i rëndësishëm dhe interesant për interpretimin e vlerave të integritetit të Egos (PDM task force 2006; Bellak dhe Hurvich 1973). Vallaint (2003) dhe Ali Besharat (2017) argumentojnë se një Ego e Fuqishme mund të krijojë një Mendje të Fuqishme por një Mendje e Fuqishme jo gjithmonë mbart një Ego të Fortë! Prandaj është tejet e rëndësishme “*mësimi i personalitetit tonë personal*” krijimi i një harte për të njohur veten, kontrolluar impulsin e pavetëdijshëm dhe zhvilluar marrëdhënien me tjetrin. Pohimet e lidhura me sjelljen keqpërshtatëse janë një tregues shumë i mirë i mekanizmave funksionale dhe disfunksionale të Egos dhe Mendjes. Pohimi nr.22 në këtë studim “*Kërkoj shumë nga vetja*” dhe pohimi nr.51 “*Sa i mirë që jam*” janë dy shembuj të integritetit të Egos për testimin dhe kontrollin e realitetit. Në pohimin nr.22 të dhënat korrelacionale treguan një sinjifikancë Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .626$ një lidhje pozitive mes niveleve të Organizimit të Personalitetit dhe Stilit të Lidershipit Autoritar për qytetin e Vlorës dhe lidhje të dobët mes niveleve dhe të Organizimit të Personalitetit dhe Stilit të Lidershipit Autoritar në qytetin e Tiranës Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .230$.

Po kështu renditja në pikavarazh z për këtë pohim në qytetin e Vlorës është $z = 1.54$

dhe $z=0,234$ në qytetin e Tiranës. Kjo do të thotë se tendenca për të ndryshuar stilin e lidërshiptit në autoritar në qytetin e Vlorës ndikohet nga rritja e kërkesës dhe përgjegjësi të brendshme dhe mënyrat e besimit “mendoj si të jem më mirë”.

Për këtë arsye ky pohim do të vlerësohet si domethënës pozitiv në metodologjinë Q. Nëse ky besim i përgjithshëm i liderit do të shoqërohet nga një stresor i vazhdueshëm si p.sh. “mendoj si të jem më mirë por të gjithë më sulmojnë” me shumë gjasa ky besim do të kthehet në patogjen për subjektin në fjalë. Egoja e mirë-strukturuar me “dëshirat dhe mundësitë reale të individit” do ta sublimojë besimin patogjen në nxitje për arritje ndërsa një Ego me nivele Antilibidinale do të vazhdojë të përforcojë besimin patogjen dhe do të ulë “rezistencat e individit” për vetë-efikasitet.

Një individ i mirë integruar do të duhej të kishte vlera neutrale (0) për pohimet në fjalë, ndërsa interesant është fakti që të dhënat sugjerojnë se në qytetet shqiptare një zë i rëndësishëm i lidërve në shkollë kanë vlerësuar si ‘shumë karakteristike’ (5) pohimin nr.51 “*Sa i mirë që jam*”! (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=,980$ në të dhëna totale). Nuk kemi të bëjmë natyrisht me një tendencë patogjenie por, me një fortësi ndoshta ende të pamaturuar të Egos sipas arsyetimit të Fairbairn (2011).

Vetë besimet patogjene mund të ndikojnë fortësinë e Egos në mënyrë shumë të rëndësishme. Lidhjet mes këtyre dy kategorive janë të mbështetura edhe në literaturë (Alessandro, Eisenberg, Vecchione dhe Caprara, 2016; Spinrad dhe Widaman, 2013; Eisenberg et al. 2009).

Faktorë si rolet sociale dhe ngjarjet stresante ndikojnë në strukturat tona Ego-Mbrojtëse duke ulur imunitetin e Egos si parim realiteti dhe duke nxitur shfaqjen e distorcioneve konjitive të mendimit patogjen që kur bashkohet me vlerat, kthehen në besime patogjene. Andaj, si rrjedhojë individit sillet sikur të ketë marrëdhënie të shpërndara dhe është konfuz me realitetin. Realiteti i tij mund të ndryshojë, nëse një pjesë e këtyre besimeve shkëputen dhe Egoja rikthehet në Ego-Real. Aftësia e Egos për Reziliencë (rehabilitim) është treguar se ndikohet nga përvojat e hershme të fëmijërisë, forma e strukturave endopsikike, energjia libidinale dhe temperamentit. Ajo gjithashtu ndikon në aspektet e përqendrimit, emocionet dhe sjelljen (Eisenberg et al. 2010, 2004; Martel et al. 2007; Taylor, Eisenberg, Spinrad dhe Widaman, 2013). Teoria

e zotërimit dhe kontrollit të Egos parashtrohet se “*Besimi patogjen është shtrembërimi i një impulsi Thanatos dhe jo keqformim i Erosit*” (Weiss, 1993). Përfaqsimet e gabuara mendore, perceptimet dhe pikëvështrimet e shtrembëruara janë elementët aktive të një Besimi Patogjen. Elementët pasivë lidhen me faktorët e brendshëm ose të jashtëm që e mbajnë të gjallë dhe në jetë Besimin.

Krijimi i të dhënave korrelacionale sipas metodës Q mbështetet më së pari në zërin e pohimeve dhe pikavarazhe z për secilin element. Të dhënat e korrelacioneve tregojnë një lidhje të fortë pozitive mes “Tendencës për sjellje Keqpërshtatëse” dhe qytetit të Shkodrës Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .940$; e moderuar për qytetin e Korçës Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .436$ dhe e ulët për qytetet e Beratit Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .264$ dhe Elbasanit Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r = .132$). Kjo do të thotë se ndryshimet në një nga elementët e organizimit të personalitetit ose të marrëdhënieve do të ndryshojnë nivelin e sjelljes e liderve në tendencë keqpërshtatëse. Në të gjitha situatat e marrëdhënies njerëzore, Besimi është “*një gur i pathyeshëm*”. Edhe në psikën tonë ai mbetet i tillë nëse ushqehet me mendësinë dhe mekanizmat mbrojtëse të “identifikimit projektiv”, “frenimit” dhe “mohimit”. Drejtuesit e institucioneve arsimore shfaqin një tendencë të lartë të të qenurit “lider i vetëm” (ego mbrojtje sublimim) “gatishmërisë për ndërhyrje në konflikt” (përgjegjësisë së egos) dhe “vlerave konservatore në shumë fusha të jetës” si pohimi nr.3, pohimi nr.55 dhe pohimi nr.72 (kontroll i egos ndaj mendjes”). Ndeshemi këtu me Besimin Patogjen të ‘veprimit për impuls’ që nënkupton sjelljen Tendencë keqpërshtatëse Neurotike.

Në zhvillimin e një Lideri të përshtatshëm, fleksibël dhe të qartë në sensin e tij të të qenurit, elementët e Identitetit dhe Autenticitetit janë dy elementë bazë të krijimit të Prototipit të individit. Modeli i dy polaritetit të Blatt (2008) na tregon se vendosja në kontinuum duhet të përqasë si Identitetin dhe Autenticitetin e individit. Në rastin e shkëputjes ose të “përçarjes” së njërit prej këtyre elementëve, peshorja ndryshon kah nga ai që mbetet. Autenticiteti i qenies është jashtëzakonisht i vlefshëm për maturitetin e individit dhe përshtatshmërisë së tij në rrethanat e ndryshme jetësore. Lideri autentik është patjetër një lider me identitet. Kontrolli i autenticitetit të liderit shkollor vërehet në marrëdhëniet e tij në klasë dhe në komunitet.

Të dhënat na treguan prezencën e një mesoreje normale por deviacion standard të lartë ndërmjet këtyre dy karakteristikave. Kjo do të thotë se karakteristikat e identitetit dhe autenticitetit janë larg normës së shpërndarjes së mesatares pra, repondentët e këtij testi shfaqin dallime të mëdha ndërmjet grupit për perceptimet e tyre mbi këto dy elementë (mesatarja =9,7; mesorja=10, sd=2,54). Vihet re një korrelacion i fuqishëm pozitiv ndërmjet pohimeve që lidhen me “dialogun e brendshëm të vetes” si pohimi nr.43 *“Kur krahasohem me të tjerët, jam i ndërgjegjshëm për dallimet që kam”* me pohimin nr.13 *“Jam i ndërgjegjshëm për përshtypjen që krijoj te të tjerët”*.

Qyteti i Elbasanit raporton korrelacionin më të fortë në këtë marrëdhënie (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=0,963$). Marrëdhënia me veten siç është shtjelluar gjerësisht në këtë studim dhe mbështetur në modelet teorike të Kernberg dhe autorëve të PDM-së¹¹⁸ është një vijë lineare për krijimin e marrëdhënies me tjetrin dhe më pas me tërësinë.

Një vete e përçarë si në rastin e një individi me OP psikotik, pohimi nr.20 *“Jam vetë ndëshkues”* do të krijojë marrëdhënie *“të pa angazhuara” dhe egocentrike*. Në të dhënat e këtij studimi asnjë nga të dhënat e grumbulluara nuk ka kaluar vlerën e pragut 0,4 andaj të dhënat e këtij niveli të organizimit të personalitetit nuk janë marrë në shqyrtim për analizë statistikore. Të dhënat e lidhura me këtë nivel të OP mund të jenë të ndikuara edhe nga konteksti kulturor o faktorë të tjerë socialë dhe kërkojnë një vëmendje më specifike psikodiagnostike në studime të mëtejshme. Sa më e hapët të jetë marrëdhënia me veten, aq më e hapët do të jetë marrëdhënia e individit me të tjerët dhe me tërësinë e jetës psikosociale që zhvillon.

Në fund,interesi ynë në të gjithë këtë studim lidhet edhe me vlerësimin e vetë lidërve shkollorë për stilin e tyre të lidershipit. Nga analiza faktoriale,Lidershipi është faktori i 2-të që përfshin tre elementë të marrëdhënies së liderit, klasën, komunitetin dhe stilin e lidershipit.

a.Për lidershipin në klasë pohimet përfaqësuese përfshijnë : 26, 27, 28, 29, 30, 58, 72

¹¹⁸ Kernberg ,Otto 1983;PDM Task Force ,2008

b.Për kategorinë e mjedisit shkollor dhe komunitetit shërbejnë pohimet:32, 33, 37, 38, 39, 40, 41, 69

c. Për stilin tërësor të lidërshiptit shërbejnë pohimet: 4, 31, 34, 35, 36, 42, 47, 56, 57, 59, 62, 68, 69, 71 dhe 73.. Nga të dhënat në të gjitha qytetet e testuara mbizotëron stili i lidërshiptit “demokratik”(75%).

Të dhënat tabelore dhe grafike në peshimin faktorial për faktorët 1 dhe 2 për Qytetin e Tiranës (Organizimi i personalitetit dhe Lidërshipti)tregojnë vlera më e lartë e lidhjeve në korrelacionale është arritur për pohimet nr.21 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=.990$), pohimin nr.48 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=.846$) në faktorin e 1 Organizim i Personalitetit dhe pohimin nr.35 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=.566$) për faktorin 2 Lidërshipti. Kjo do të thotë se ekziston një lidhje e fuqishme dhe pozitive ndërmjet anti-konformizmit dhe liderëve shkollorë në qytetin e Tiranës. Liderët shkollorë në këtë qytet po kështu shfaqen me lidhje pozitive të fortë me Drejtuesin e institucionit Arsimor si Lider Demokratik por jo të vetë mësuesit si aspirantë për lider.

Të dhënat tabelore dhe grafike në peshimin faktorial për faktorët 1 dhe 2 për Qytetin e Elbasanit (Organizimi i personalitetit dhe Lidërshipti)tregojnë se vlera më e lartë e lidhjeve në korrelacionale është arritur për pohimet nr.21 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=.984$.) në faktorin e 1 Organizim i Personalitetit dhe pohimin nr.44 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=.726$) për faktorin 2 Lidërshipti. Siç mund të kuptohet,qoftë liderët shkollorë në Elbasan,qoftë në Tiranë kanë një lidhje të fortë e pozitive me “të qenurit anti-konformist ”si subjekte individë por,liderët shkollorë Elbasanas kanë një lidhje më të fortë me politikën në arsimim dhe kanë pritshmëri më të larta prej tyre.

Të dhënat tabelore dhe grafike në peshimin faktorial për faktorët 1 dhe 2 për Qytetin e Beratit (Organizimi i personalitetit dhe Lidërshipti)tregojnë se vlera më e lartë e lidhjeve korrelacionale është arritur për pohimet nr. 60 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=.718$),pohimin nr. 9 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r=.669$) në faktorin e 1 Organizim i Personalitetit dhe pohimin nr.42 (Sig2. $p = 0.01 < 0.05$, $r =.769$) për faktorin 2 Lidërshipti. Kjo do të thotë se Liderët shkollorë në qytetin e Beratit kanë një vetë-besim të lartë kur marrin përsipër një punë por ata njëkohësisht mund të ndjehen të frustuar shpejt dhe në stres. Prania e shtuar e faktorëve stresantë natyrisht që ndikon

